





S4J

Aftësi për Punë / Skills for Jobs



## Hoteleri & Turizmi

Edi dhe Bora janë në vitin e parë të shkollës profesionale në drejtimin e Hoteleri & Turizmit. Bora sapo ka përfunduar praktikën si asistente në një hotel të madh buzë detit. Ajo i tregon Edit se si e ka ndihmuar recepsionisten gjatë asaj kohe. Ajo e ka kuptuar se sa e rëndësishme është të flasësh gjuhë të huaja pasi në hotel vinin kryesisht turistë nga jashtë. Asaj i pëlqeu kontakti i shpeshtë me të tjerët, nga klientët apo punonjësit e tjerë. Edi pati të njëjtën përvojë. Ai e kreu praktikën në një restorant si asistent shërbimi. Atje, i thotë Borës, ishte shumë e rendësishme që të njihje menunë me saktësi dhe të komunikoje me mirësjellje edhe nëse restoranti ishte i mbipopulluar dhe nëse presioni i kohës ishte i lartë. Të dy e kanë mësuar këtë gjatë praktikës në kuzhinë. Iu kujtohej se si gjatë drekës apo në mbrëmje në fundjavë nuk mbaronin porositë e klientëve. Megjithatë, edhe pse ata ishin thjesht ndihmës për stafin e kuzhinës, e ndjenin se sa e rëndësishme ishte puna në ekip, madje, edhe pse toni i zërit ashpërsohej ndonjëherë, ata shijonin ndjenjën e arritjes së një qëllimi së bashku. Tani mezi po presin që të lidhin përvojat e tyre praktike me njohuritë që fitojnë në shkollë dhe me praktikën e tyre të ardhshme.

## Elektro-teknikë dhe Elektronikë

Nora dhe Floriani janë në vitin e parë të shkollës profesionale në drejtimin e Elektro-teknikës dhe Elektronikës. Javën e kaluar, Nora mori pjesë në një praktikë profesionale në një dyqan të specializuar për paisje elektrike dhe elektronike dhe tani ndan përvojat e saj me Florianin. Ajo i thotë atij se ai pati mundësinë të ndihmonte një nga elektricistët për të kryer punë të ndryshme në shërbim dhe mirëmbajtje. Ai duhej të riparonte mjete dhe pajisje të ndryshme elektronike që i sillnin klientët në dyqan. Nora i shpjegon Florianit, se, përveç njohurive teknike, ishte shumë e rëndësishme që problemi të analizohej me shumë kujdes përpara fillimit të punës. Ndërsa Floriani e kreu praktikën e tij profesionale në një kompani elektrike që bën instalime të ndryshme në familje dhe industri. Ai i tregon Norës se pati mundësinë të ndihmojë një ekip me elektricistë të cilët duhej të riparonin sistemin e furnizimit me energji të një ndërtese biznesi. Floriani i thotë Norës se u habit shumë kur pa që elektricistët përdorën të njëjtat llogaritje aritmetike, të cilat ata i kishin studiuar në shkollën profesionale, për të zgjidhur formulat elektrike për të riparuar defektin elektrik. Përveç kësaj, ata i kërkuan Florianit që të kërkojë në internet për më shumë informacion. Floriani vuri re që pronari i ndërtesës së biznesit i pyeti disa herë nëse kishin mbaruar punë sepse ishte nën presion të madh kohor. Elektricistëve iu desh që të punonin shpejt, por përsëri me shumë përqendrim. Ai i tregon Norës se sa e rëndësishme ishte të dallonin ngjyrat e kabllove elektrike, sepse një gabim i vetëm do të kishte pasoja të rënda. Pas riparimit të defektit, Floriani e ndihmoi mbikëqyrësin e tij për të përgatitur të gjithë dokumentacionin ku pasqyruan të gjitha veprimet dhe procedurat që kishin kryer. Fakti që patën mundësi të vinin në praktikë njohuritë e marra në shkollë ishte me të vërtetë motivues për ta.


**Një projekt i Agjencisë Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim SDC**

Schweizerische Eidgenossenschaft
Confédération suisse
Confederazione Svizzera
Confederaziun svizra

Agjencia Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim SDC

**Në partneritet me:**

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E FINANCAVE DHE EKONOMISË

**Zbatuar nga:**

swisscontact

## Teknologji Informacioni dhe Komunikimi

Lori dhe Valoni janë në vitin e parë të shkollës profesionale në drejtimin e Teknologjisë së Informacionit dhe Komunikimeve - TIK. Lori sapo ka mbaruar një praktikë profesionale si asistente në një ndërmarrje të vogël TIK dhe Valoni e pyet për përvojën e saj. Ajo i tregon se atje ajo pati mundësinë që të ndihmojë zhvilluesin e uebit dhe specialistin për mbështetjen e përdoruesve të zyrës. Ajo u befasua nga mënyra se si zhvilluesi i uebit duhej të unifikonte pritshmëritë e konsumatorit, se si duhet të funksionojnë e të duken aplikacionet për përdoruesit dhe për sfondin teknik të kërkuar në zgjidhjet e zgjuara. Ajo i tregon Valonit se i pëlqente shumë të menduarit logjik dhe abstrakt që nevojitet për këtë detyrë. Kur ka punuar me mbështetjen për përdoruesit e TIK, asaj i ka pëlqyer shumë kontakti me klientët. Ajo habitej dhe në të njëjtën kohë mrekullohej me faktin se sa i qetë tregohej mbikqyrësi i saj, edhe kur telefonin klientë tejet të inatosur. Valoni përjetoi të njëjtën gjë si edhe Lori gjatë praktikës në departamentin e TIK-ut në një bankë. Përveç gjërave që përfitoi Lori, ai krijoi një ide edhe për programimin dhe rrjetin e të dhënave në terren. Ai i tregon Lorit se sa i lumtur ishte që kishte parë aq shumë video mësimore në gjuhën angleze, pasi ishte gjuha kryesore e programuesve. Ata duhej të komunikonin shumë me zyrën e nënkontraktuar të TIK-ut në Zvicër, kështu që ai nuk do të kishte asnjë mundësi për të komunikuar me ta në gjuhën shqipe. Të dy tani mezi po presin që t'iu jepet mundësia për të fituar më shumë njohuri teorike në shkollë të cilat pastaj mund të transferohen në praktikë në praktikat e tyre të ardhshme profesionale.

## Ekonomi dhe Biznes i Përgjithshëm

Riselda dhe Aris janë në vitin e parë të shkollës profesionale në drejtimin Ekonomi-Biznes. Gjatë një pushimi ata bisedojnë me njëri-tjetrin dhe ndajnë përvojat e tyre të deritanishme gjatë praktikave profesionale. Javën e kaluar, Riselda pati mundësinë të punonte në një supermarket në sektorin e tregtisë. Mbikëqyrësi i saj e caktoi që të shërbente tek arka dhe që të ndihmonte klientët. Riselda i tregon Aris se si iu desh të merrej me klientë të ndryshëm, se si ajo i duhej t'iu shpjegonte produktet, se si i orientonte në rast se kërkonin produkte të veçanta dhe se si iu shpjegonte çmimet. Një nga detyrat më të vështira sipas mendimit të Riseldës ishte kur i duhej të shpjegonte ofertat dhe zbritjet e ndryshme. Për fat të mirë, mbikëqyrësi i saj ishte shumë i gjindshëm dhe i dha asaj mbështetjen e nevojshme. Aris e pyet Riseldën se çfarë i kishte pëlqyer më së shumti dhe ajo i përgjigjet se ajo që i pëlqeu më shumë ishte pikërisht kontakti i shpeshtë me të gjitha llojet e klientëve. Aris pajtohet me këtë dhe fillon t'i tregojë Riseldës në lidhje me praktikën e tij profesionale në sektorin e shërbimeve bankare. Ai pati mundësinë të ndihmonte mbikëqyrësen e tij për të organizuar një aktivitet të madh në një ambient jashtë. Ata kontaktuan personin përgjegjës për këtë ambient dhe e informuan me e-mail për numrin e klientëve të ftuar. Pas kësaj, mbikëqyrësja e Aris e caktoi atë për të përkthyer ftesën nga shqipja në anglisht. Kur mbaroi, ajo e kontrolloi ftesën dhe i dha disa mendime të dobishme. Tani, Riselda dhe Aris do të studiojnë në shkollën profesionale për disa javë para se të marrin pjesë në praktika të tjera profesionale.

## Mekanikë

Endri dhe Sara janë në vitin e parë të shkollës profesionale në drejtimin e mekanikës. Endri sapo ka përfunduar praktikën e tij të parë si asistent në një kompani që përpunon aluminin. Ai i tregon Sarës, se si ka ndihmuar një metal prerës i cili duhej të prodhonte dritare alumini. Endri e ndihmoi duke marrë masat e dritares së re dhe duke marrë shënime ndërsa mbikëqyrësi i tij diskutonte me klientin në lidhje me tipologjinë dhe ngjyrën e dritareve. Ai i tregon Sarës, se ishte befasuar se sa shumë punë mund të planifikontë mbikqyrësi i tij në kompjuter më pas. Megjithatë, ajo që i pëlqente ishte që jo gjithmonë i duhej të punonte në zyrë, por më tepër në repartin e punës. Atje shpesh ishte ambient i zhurmshëm dhe i vështirë, por gjithsesi, secili punonjës punonte shumë i përqendruar pasi punonin me sharra të rënda dhe makineri të tjera të mëdha. Sara e pyet nëse arriti të punonte me makinerinë CNC. Kjo është shkurtesa për Kontrollin Numerik të Kompjuterizuar dhe nënkupton një proces prodhimi në të cilin një program kompjuterik i para-programuar dikton lëvizjen e veglave dhe makinerive të fabrikës. Gjatë praktikës së saj në një kompani të ngjashme, Sara e kishte ndihmuar mbikqyrësin e saj ndërkohë që e programonte këtë makineri.

## Shërbime Mjetesh Transporti

Iva dhe Ferdinandi janë në vitin e parë të shkollës profesionale në drejtimin Shërbime Mjetesh Transporti. Përveç përvojave të tyre të deritanishme mësimore në shkollë, Iva pati mundësinë që të zhvillonte praktikën profesionale në një ofiçinë ku kryhen shërbime të ndryshme për makinat. Gjatë pushimit midis orëve të mësimit në shkollë, Iva i tregon Ferdinandit për përvojën e saj praktike. Gjatë praktikës së saj profesionale ajo pati mundësinë të ndihmonte një teknik. Detyrat e tij gjithmonë fillonin me ardhjen e makinave me defekt në ofiçinë dhe me bisedën me shoferin. Detyra e Ivës ishte të mbante shënime. Më pas, mbikëqyrësi i saj i shpjegon Ivës se, sipas përshtypjes së tij të parë dhe përshkrimit të klientit, ai dyshon se motori i makinës është i dëmtuar. Prandaj, ai fillon të testojë dyshimin e tij me pajisje specifike diagnostikuese. Ai i shpjegoi Ivës se si t'i interpretonte rezultatet dhe i tregoi asaj se diagnoza e tij e parë ishte e saktë. Si një hap tjetër ai i shpjegon asaj mënyrën se si mund ta rregullojë problemin dhe se ekzistojnë dy zgjidhje të mundshme: ose të zëvendësonin të gjithë motorin ose të porosisnin pjesë të veçanta këmbimi nga Japonia. Për të dyja zgjidhjet ata llogarisin shpenzimet për klientin dhe kohën e përafërt të shërbimit. Meqenëse kishin një motor të ri gjendje në ofiçinë, zëvendësimi total do të ishte shumë më i shpejtë. Kur tekniku e informoi klientin për të dy zgjidhjet me telefon, Iva mund ta lexonte në fytyrën e tij se klientit nuk i pëlqente shumë kjo gjë. Ajo e vuri re që, pavarësisht gjithçkaje tekniku mbeti shumë objektiv dhe miqësor dhe i shpjegoi klientit me kujdes koston e shërbimit. Pasi ranë dakord për zgjidhjen e parë, Iva pati mundësinë që ta ndihmonte teknikun gjatë zëvendësimit të motorit. Ferdinandi e dëgjon me shumë interes historinë e Ivës dhe pret me padurim të marrë pjesë në praktikën e ardhshme profesionale.



# Recepsion

Aftësi për Punë / Skills for Jobs



Gloria mezi po pret të fillojë punën sot ku me siguri do të ketë shumë për të bërë përsëri. Këtë mëngjes, përveç detyrave të saj të zakonshme, ajo do të jetë përgjegjëse edhe për një nxënës praktikant nga shkolla profesionale që studion në drejtimin "Hoteleri-Turizëm". Së pari, ata kontrollojnë numrin e klientëve që do të vijnë sot në hotel si edhe numrin e klientëve që do të largohen. Ata e bëjnë këtë lloj përgatitje për t'u siguruar që procesi i regjistrimit dhe çregjistrimit në hotel të përfundojë sa më shpejt.

Gloria e ndërpret këtë punë disa herë për shkak të telefonatave të shumta që merr apo klientëve që i drejtohen për çfarëdo lloj shqetësimi.

Së pari merr një telefonatë nga një klient i rregullt nga Roma. Ai flet anglisht me një theks të fortë Italian. Dëshiron të rezervojë një dhomë. Gloria e pyet nëse dëshiron një dhomë biznesi si zakonisht dhe e bën rezervimin në kompjuter si edhe i dërgon një konfirmim me e-mail.

Pastaj vjen një grup klientësh amerikanë. Ata duan të dinë se ku shërbehet mëngjesi. Gloria iu tregon se si të shkojnë në sallën ku shërbehet mëngjesi në gjuhën angleze, i pyet nëse kanë fjetur mirë dhe me shumë mirësjellje iu uron një ditë të këndshme.

Më pas disa klientë duan të çregjistrohen në të njëjtën kohë. E pra, ishte e përgatitur për këtë, prandaj të gjithë klientët e kryejnë këtë formalitet në një kohë shumë të shkurtër. Ajo iu uron të gjithëve rrugë të mbarë dhe i siguron që janë të mirëpritur në hotel sa herë të vijnë dhe shpreson t'i shohë sa më shpejt.

Një klient arrin shumë më herët sesa pritej. Fillimisht, ai shprehet i pakënaqur që nuk mund të sistemohet menjëherë në dhomën e tij. Gloria me mirësjellje i shpjegon se do të kujdeset që pastrimi i dhomës të bëhet sa më shpejt që të jetë e mundur. Ndërkohë ai mund të ulet në holl dhe ajo i ofron një kafe.

Pasi mbaroi çregjistrimi i të gjithë klientëve, recepsioni ra paksa në qetësi. Gloria shfrytëzoi rastin për t'i treguar nxënësit praktikant punën që kryejnë punonjësit e pastrimit nëpër dhoma. Ajo i shpjegon se sa e rëndësishme është të jesh i sjellshëm dhe miqësor me klientët e pakënaqur dhe, natyrisht, të gjesh një zgjidhje. Ankesat dokumentohen dhe përdoren për të përmirësuar cilësinë. Ajo iu jep përgjigje pyetjeve të bëra nga nxënësi praktikant në mënyrë të vazhdueshme. Në një moment i afrohet një klient në korridor. Ai pyet për orën e çregjistrimit dhe dëshiron të dijë nëse mund t'i lërë diku bagazhet përkohësisht. Gloria i tregon orën e çregjistrimit dhe i shpjegon se ku dhe për sa kohë mund ta lërë bagazhin në ruajtje.

Mbasdite Gloria ulet në zyrën e recepsionit dhe shikon statistikat e muajit të kaluar. Ajo do të takohet me përgjegjësen e saj më vonë dhe duhet t'i japë asaj informacion në lidhje me përqindjen e shfrytëzimit të dhomave këtë muaj, krahasuar me të njëjtin muaj gjatë vitit të shkuar. Përveç kësaj, ajo përgatit në kompjuter listën e klientëve që pritet të vijnë javën e ardhshme. Pas diskutimit të rezultateve të dala nga analiza e saj në lidhje me performancën e hotelit, ajo duhet të përgatisë edhe faturat e klientëve që do të largohen gjatë ditës së nesërme. Pergjegjësja është shumë e kënaqur me punën e pavarur të Glorias dhe e falënderon atë.

**Një projekt i Agjencisë Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim SDC**

Schweizerische Eidgenossenschaft
Confédération suisse
Confederazione Svizzera
Confederaziun svizra

**Agjencia Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim SDC**

**Në partneritet me:**

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E FINANCAVE DHE EKONOMISË

**Zbatuar nga:**

swisscontact

# Recepsion

## Kërkesat e shkollës

| **Kërkesa** | **e ulët ◂ RËNDËSI ▸ e lartë** | **Komente** |
|---|---|---|
| Matematikë: Puna me numra, forma gjeometrike dhe algjebër. | | Llogaritja e saktë në kohë të shkurtër; njohja e monedhave të huaja. |
| Gjuhë e shkruar (shqip): Përdorimi i gjuhës së shkruar si mjet komunikimi në aktivitetet profesionale. | | Komunikimi me e-mail për rezervime dhe konferenca. |
| Gjuhë e folur (shqip): Përdorimi i gjuhës së folur si mjet komunikimi në aktivitetet profesionale. | | Komunikimi i qartë dhe korrekt me kolegët dhe stafin. |
| Gjuhë e huaj e shkruar: Përdorimi i gjuhës së huaj të shkruar si mjet komunikimi në aktivitetet profesionale. | | Komunikimi me e-mail, prenotimi, dhënia e përgjigjeve ndaj pyetjeve të klientëve. |
| Gjuhë e huaj e folur: Përdorimi i gjuhës së huaj të folur si mjet komunikimi në aktivitetet profesionale. | | Të kuptuarit dhe komunikimi efikas me klientët e huaj. |
| Shkencat Natyrore: Aftësitë dhe njohuritë shkencore të nevojshme për të hetuar, zgjidhur problemet, për të marrë vendime, për të mësuar gjatë gjithë jetës, për të drejtuar pyetje dhe për të shuar kuriozitetin e tyre. | | Aftësitë për zgjidhjen e problemeve; aftësia për të bërë pyetjet e duhura |
| Shoqëria dhe Mjedisi: Kuptimi i proceseve ligjore, politike, ekonomike, sociale, historike, kulturore dhe i çështjeve të ndërlidhura me to. | | |
| Arte: Mësimi, komunikimi, interpretimi dhe zhvillimi i aftësive të tyre artistike për të shprehur veten dhe për të asistuar në ndryshimin artistik dhe kulturore të vetvetes dhe të tjerëve. | | |
| Teknologjia & TIK: Përdorimi i TIK-ut për të kërkuar dhe marrë informacion nga burimet on-line; menaxhimi i projekteve në grupe pune; diskutimi dhe ndarja me të tjerët e gjetjeve të tyre gjatë kërkimit. | | Njohja e programit të recepsionit. Njohja e platformës online dhe MS office. |



# Recepsion

# Kërkesat fizike

| Kërkesa | e ulët ◂ RËNDËSI ▸ e lartë | Komente |
|---|---|---|
| Aftësitë e forta motorike: Përdorimi në shkallë të gjerë dhe të koordinuar i duarve dhe krahëve. | | |
| Aftësitë e buta motorike: Kryerja në masë të vogël e lëvizjeve të koordinuara dhe të kontrolluara të duarve dhe gishtërinjve. | | |
| Forca: Përdorimi i fuqisë muskulore, si afatshkurtër dhe impulsive (p.sh. për ngritjen e një arke të rëndë) ose afatgjatë dhe e vazhdueshme (p.sh. puna me trapan në një sipërfaqe mbi kokë). Përdorimi i zgjatur i fuqisë së muskujve gjatë ngritjes së objekteve, përdorimi i mjeteve/veglave ose ecja, vrapimi. | | |
| Aftësi normale për dallimin e ngjyrave: Aftësia për të dalluar të gjitha ngjyrat saktë | | |
| Shqisa e shijes, aromës: Nuhatja dhe/ ose shijimi, p.sh. kur gatuhet, prodhohen aroma; njohja e rreziqeve (p.sh. rrjedhje gazi, ushqime të prishura). | | |
| Asnjë lloj alergjie / intolerance: Nuk ka alergji / intolerancë ndaj substancave, si ushqime, pëlhura, etj. | | |
| Puna në temperatura dhe kushte të ndryshme atmosferike: Puna në ambiente jashtë, pavarësisht nga kushtet e motit dhe temperatura. | | |



# Recepsion

# Kompetencat personale dhe sociale

| Kërkesa | e ulët ◂ RËNDËSI ▸ e lartë | Komente |
|---|---|---|
| Qëndrueshmëria emocionale: Menaxhimi i situatave stresuese dhe marrja e masave për të reduktuar stresin në përgjegjësinë e vet. Veprimi i koordinuar dhe i synuar edhe nën presion kohor. |  | Ruajtja e qetësisë dhe e etikës profesionale për të siguruar kënaqësinë e klientit në çdo rast, trajtimi i ankesave të klientëve, krijimi i klimës pozitive. |
| Ritmi i shpejtë ose i pandikueshëm i punës: Puna (ritmi) mund të ndryshojë nga një çast në tjetrin, për shkak të kërkesës spontane dhe urgjente të klientit ose për shkak të ndryshimit dinamik të kushteve të punës. |  | |
| Përqendrim dhe qëndresë e lartë: Përqendrim i lartë në një detyrë që kërkon rezistencë të lartë ndaj shpërqendrimit për një periudhë të zgjatur kohore. |  | Ruajtja e përqendrimit edhe gjatë komunikimit me shumë njerëz në të njëjtën kohë. Vendosja e prioriteteve. |
| Aftësi të forta krijuese dhe aftësi për zgjidhjen e problemeve: Të menduarit për arritjet me qëllim transferimin e një faze aktuale në një fazë të synuar pavarësisht rezistencës e kundërshtive. |  | Zgjidhja e situatave të vështira me klientët. Gjetja e zgjidhjeve të shpejta për kërkesat e klientëve, situatat e padukshme, mbirezervimet. |
| Fleksibiliteti në lidhje me vendndodhjen e punës: Aftësia për t'u përshtatur shpejt në vende të ndryshme pune në ambiente brenda ose jashtë. |  | |
| Fleksibiliteti në lidhje me orarin e punës: Aftësia për t'u përshtatur me orare të ndryshme pune, të cilat mund të ndryshojnë nga orët standarde të punës, si puna gjatë natës ose herët në mëngjes. |  | Kërkesa për të punuar me tre turne dhe në fundjavë. |
| Qasje e hapur ndaj personave të tjerë me të cilët kontakton shpesh: Vendosja dhe ruajtja e marrëdhënieve formale, ruajtja e formave të kontaktimit me autoritetet, klientët, partnerët e biznesit, etj. |  | Mbikëqyrja e të gjithë klientëve edhe kur ka fluks të madh për t'i bërë të ndjehen të mirëpritur. |
| Kënaqësi nga kontakti i vazhdueshëm, ndjeshmëri, empati: Qasja empatike tek njerëzit e tjerë me qëllim krijimin dhe ruajtjen e marrëdhënieve. Kjo kërkesë është e rëndësishme në shumë shërbime ku kërkohet kontakt i vazhdueshëm me klientët, si shitja, kujdesi estetik, konsultimi, terapia. |  | |
| Aftësi e spikatur për të punuar në ekip për shkak të bashkëpunimit të ngushtë: Bashkëpunimi brenda ekipit, përkatësisht koordinimi ndërmjet anëtarëve të ekipit, supozimi i besueshëm i nëndetyrave, përgjegjësi e përbashkët për arritjen e qëllimeve. |  | |
| Kompetencat ndërkulturore: Aftësitë njohëse, emocionale dhe të sjelljes që çojnë në komunikim efektiv dhe të përshtatshëm me njerëzit e kulturave të tjera. Ato përfshijnë sjelljet që i përshtaten pritshmërive të një kulture të caktuar, karakteristikat e situatës dhe nivelin e marrëdhënieve midis palëve të përfshira në këtë situatë. Ato gjithashtu marrin parasysh normat e veta kulturore dhe kompromisin më të përshtatshëm dhe më të qetë ndërmjet normave të ndryshme kulturore. |  | Njohja e kulturave të ndryshme të klientëve. |
| Integritet i lartë: Aftësia për të qenë të ndershëm dhe për të patur parime të forta morale, ose ndershmëri morale. Është një zgjedhje personale për të ruajtur standarde të qëndrueshme në sjelljen personale. Në etikë, integriteti konsiderohet si ndershmëria dhe vërtetësia ose saktësia e veprimeve të dikujt. |  | Recepsioni është pika e parë e kontaktit të klientit me biznesin. Ruajtja e shërbimit cilësor (korrekt) është thelbësore. Trajtimi me ndërgjegje i informacionit personal, informimi dhe njohja e dispozitave për mbrojtjen e të dhënave. |


PRAKTIKANT
SHKOLLA TREGT

# Shërbim në Bar-Restorant

S4J
Aftësi për Punë / Skills for Jobs




Sot Niku ka turnin e dyte dhe e fillon punën në restorant në orën 10:00. Tek programi i ditës ai sheh që i kanë caktuar të shërbejë tek tavolinat pranë dritares. Para se të përgatisë tavolinat, ai sigurohet që çdo gjë të jetë e pastër duke i fshirë edhe njëherë gotat, lugët, pirunjtë dhe pjatat. Ai i palos edhe pecetat bukur. Tani mund të shtrojë tavolinat dhe t'i zbukurojë me lule dhe materiale dekorative. Meqenëse restoranti funksionon edhe si bar, Nikut i duhet të ndërpresë punën e tij sa herë që mbërrijnë klientë të rinj ndërkohë që banakieri është i zënë. Ai merr porosinë dhe përgatit pijet. Gjatë orëve të mëngjesit, shpesh i duhet të përgatisë edhe kafetë. Ai ka mësuar nga banakieri se si të hedhë qumështin në kafe për të vizatuar zemra e mjelma. Ai ka parë edhe disa video në youtube për të ashtuquajturin 'arti i qumështit' dhe gëzohet kur sheh se po përmirësohet nga dita në ditë.

Gjatë takimit të ekipit të shërbimit me eprorin, ai dëgjon me kujdes që të dijë se çfarë ushqimesh dhe pijesh të rekomandojë gjatë ditës së sotme. Nëse nuk e di diçka, bën pyetje dhe mban shënime. Meqenëse Niku në shkollë ka punuar me verëra shqiptare, ai mund të shkëmbejë njohuritë edhe me kolegët e tij në punë. Më pas, ai përgatit gjithçka që duhet për shërbimin e drekës. Ai përgatit menutë dhe pijet, pret bukën dhe përgatit gjalpin. Ai mbush edhe një kovë me akull për shërbimin e verës së bardhë.

Në orën 12.00 Niku mirëpret klientët e parë, Z. dhe Znj. Krasniqi, dhe i shoqëron tek tavolina. Ai prezantohet dhe iu rekomandon një aperitiv. Ndërsa po përgatit pijet, në restorant hyjnë disa klientë të tjerë - është një çift nga Anglia. Ai e ndërpret punën dhe i drejton klientët tek tavolina e tyre. Ai i pyet në gjuhën angleze si iu shkoi udhëtimi dhe nëse do të donin të fillonin me një aperitiv. Niku merr porosinë për dy pije dhe iu shërben të dy grupeve të klientëve.

Ndërkohë që klientët janë duke pirë aperitivin, Niku u rekomandon specialitetet e ditës në gjuhët përkatëse. Niku njihet me pjatat e preferuara të klientëve të tij duke i pyetur saktësisht se çfarë duan. Meqë znj. Krasniqi është intolerante ndaj produkteve të qumështit, ai shkon në kuzhinë dhe e pyet kuzhinierin se cilat gatime përmbajnë produkte qumështi. Ai e informon Znj. Krasniqi dhe pastaj merr porositë.

Gjatë drekës, Niku tregohet i vëmendshëm ndaj klientëve të tij. Ai iu rimbush gotat me pije, iu shërben pjatat dhe pyet nëse janë të kënaqur. Gjithashtu ai iu përgjigjet edhe pyetjeve në lidhje me përgatitjen dhe origjinën e pijeve dhe ushqimit. Ai i informon klientët nga Anglia edhe për disa pika turistike në rajon. Në fund Niku merr pagesën, i shoqëron klientët tek dera dhe iu uron ditën e mirë. Para se të bëjë një pushim të shkurtër, ai i pastron tavolinat dhe heq edhe pjatat e pastra.

**Një projekt i Agjencisë Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim SDC**

Schweizerische Eidgenossenschaft
Confédération suisse
Confederazione Svizzera
Confederaziun svizra

**Agjencia Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim SDC**

**Në partneritet me:**

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E FINANCAVE DHE EKONOMISË

**Zbatuar nga:**

swisscontact

# Shërbim në Bar & Restorant

# Kërkesat e shkollës

| Kërkesa | e ulët ◂ RËNDËSI ▸ e lartë | Komente |
|---|---|---|
| Matematikë: Puna me numra, forma gjeometrike dhe algjebër. | | Llogaritja e shpenzimeve të klientit. |
| Gjuhë e shkruar (shqip): Përdorimi i gjuhës së shkruar si mjet komunikimi në aktivitetet profesionale. | | Komunikimi i brendshëm, komunikimi me klientët. |
| Gjuhë e folur (shqip): Përdorimi i gjuhës së folur si mjet komunikimi në aktivitetet profesionale. | | Mjeti kryesor i komunikimit. |
| Gjuhë e huaj e shkruar: Përdorimi i gjuhës së huaj të shkruar si mjet komunikimi në aktivitetet profesionale. | | Komunikimi me klientët. |
| Gjuhë e huaj e folur: Përdorimi i gjuhës së huaj të folur si mjet komunikimi në aktivitetet profesionale. | | Komunikimi me klientët. |
| Shkencat Natyrore: Aftësitë dhe njohuritë shkencore të nevojshme për të hetuar, zgjidhur problemet, për të marrë vendime, për të mësuar gjatë gjithë jetës, për të drejtuar pyetje dhe për të shuar kuriozitetin e tyre. | | Njohuritë e mëparshme p.sh. për higjienën, çështjet mjedisore. |
| Shoqëria dhe Mjedisi: Kuptimi i proceseve ligjore, politike, ekonomike, sociale, historike, kulturore dhe i çështjeve të ndërlidhura me to. | | |
| Arte: Mësimi, komunikimi, interpretimi dhe zhvillimi i aftësive të tyre artistike për të shprehur veten dhe për të asistuar në ndryshimin artistik dhe kulturore të vetvetes dhe të tjerëve. | | |
| Teknologjia & TIK: Përdorimi i TIK-ut për të kërkuar dhe marrë informacion nga burimet on-line; menaxhimi i projekteve në grupe pune; diskutimi dhe ndarja me të tjerët e gjetjeve të tyre gjatë kërkimit. | | Përdorimi i mjeteve elektronike dhe TI. |



# Shërbim në Bar & Restorant

# Kërkesat fizike

| Kërkesa | e ulët ◂ RËNDËSI ▸ e lartë | Komente |
|---|---|---|
| Aftësitë e forta motorike: Përdorimi në shkallë të gjerë dhe të koordinuar i duarve dhe krahëve. | | Lëvizja e tavolinave, shërbimi. |
| Aftësitë e buta motorike: Kryerja në masë të vogël e lëvizjeve të koordinuara dhe të kontrolluara të duarve dhe gishtërinjve. | | P.sh. përgatitja e peshkut për klientin. |
| Forca: Përdorimi i fuqisë muskulore, si afatshkurtër dhe impulsive (p.sh. për ngritjen e një arke të rëndë) ose afatgjatë dhe e vazhdueshme (p.sh. puna me trapan në një sipërfaqe mbi kokë). Përdorimi i zgjatur i fuqisë së muskujve gjatë ngritjes së objekteve, përdorimi i mjeteve/veglave ose ecja, vrapimi. | | P.sh. mbajtja e një pjate plot gjatë shërbimit. |
| Aftësi normale për dallimin e ngjyrave: Aftësia për të dalluar të gjitha ngjyrat saktë | | Ndihmon gjatë përgatitjes së pijeve. |
| Shqisa e shijes, aromës: Nuhatja dhe/ ose shijimi, p.sh. kur gatuhet, prodhohen aroma; njohja e rreziqeve (p.sh. rrjedhje gazi, ushqime të prishura). | | Provon të gatuajë receta të reja. |
| Asnjë lloj alergjie / intolerance: Nuk ka alergji / intolerancë ndaj substancave, si ushqime, pëlhura, etj. | | Alergjitë (nga lulet ose solucionet e pastrimit). |
| Puna në temperatura dhe kushte të ndryshme atmosferike: Puna në ambiente jashtë, pavarësisht nga kushtet e motit dhe temperatura. | | Stafi i shërbimit përshtatet me mjedisin e punës pavarësisht kushteve të tij. |



# Shërbim në Bar & Restorant

# Kompetencat personale dhe sociale

| Kërkesa | e ulët ◂ RËNDËSI ▸ e lartë | Komente |
|---|---|---|
| Qëndrueshmëria emocionale: Menaxhimi i situatave stresuese dhe marrja e masave për të reduktuar stresin në përgjegjësinë e vet. Veprimi i koordinuar dhe i synuar edhe nën presion kohor. | | Ruajtja e qetësisë me klientët edhe në situata të vështira. |
| Ritmi i shpejtë ose i pandikueshëm i punës: Puna (ritmi) mund të ndryshojë nga një çast në tjetrin, për shkak të kërkesës spontane dhe urgjente të klientit ose për shkak të ndryshimit dinamik të kushteve të punës. | | Ngarkesa e e paparashikueshme e punës. Përshtatet me flukset e ndryshme të klientëve. |
| Përqendrim dhe qëndresë e lartë: Përqendrim i lartë në një detyrë që kërkon rezistencë të lartë ndaj shpërqendrimit për një periudhë të zgjatur kohore . | | Vëmendje për të kryer detyrat në rendin e duhur. |
| Aftësi të forta krijuese dhe aftësi për zgjidhjen e problemeve: Të menduarit për arritjet me qëllim transferimin e një faze aktuale në një fazë të synuar pavarësisht rezistencës e kundërshtive. | | Aftësi për të menaxhuar/ normalizuar situatat dhe për t'i kthyer ato në favorin tuaj. |
| Fleksibiliteti në lidhje me vendndodhjen e punës: Aftësia për t'u përshtatur shpejt në vende të ndryshme pune në ambiente brenda ose jashtë. | | |
| Fleksibiliteti në lidhje me orarin e punës: Aftësia për t'u përshtatur me orare të ndryshme pune, të cilat mund të ndryshojnë nga orët standarde të punës, si puna gjatë natës ose herët në mëngjes. | | Shërbimi ndaj klientit, duke iu përshtatur orareve të klientit. |
| Qasje e hapur ndaj personave të tjerë me të cilët kontakton shpesh: Vendosja dhe ruajtja e marrëdhënieve formale, ruajtja e formave të kontaktimit me autoritetet, klientët, partnerët e biznesit, etj. | | Mban lidhje, ka kontakt me klientin. Kujdesi ndaj klientit. |
| Kënaqësi nga kontakti i vazhdueshëm, ndjeshmëri, empati: Qasja empatike tek njerëzit e tjerë me qëllim krijimin dhe ruajtjen e marrëdhënieve. Kjo kërkesë është e rëndësishme në shumë shërbime ku kërkohet kontakt i vazhdueshëm me klientët, si shitja, kujdesi estetik, konsultimi, terapia. | | Mban lidhje, ka kontakt me klientin. Kujdesi ndaj klientit. |
| Aftësi e spikatur për të punuar në ekip për shkak të bashkëpunimit të ngushtë: Bashkëpunimi brenda ekipit, përkatësisht koordinimi ndërmjet anëtarëve të ekipit, supozimi i besueshëm i nëndetyrave, përgjegjësi e përbashkët për arritjen e qëllimeve. | | Marrja e përgjegjësive në ekip për arritjen e cilësisë së lartë të shërbimit. |
| Kompetencat ndërkulturore: Aftësitë njohëse, emocionale dhe të sjelljes që çojnë në komunikim efektiv dhe të përshtatshëm me njerëzit e kulturave të tjera. Ato përfshijnë sjelljet që i përshtaten pritshmërive të një kulture të caktuar, karakteristikat e situatës dhe nivelin e marrëdhënieve midis palëve të përfshira në këtë situatë. Ato gjithashtu marrin parasysh normat e veta kulturore dhe kompromisin më të përshtatshëm dhe më të qetë ndërmjet normave të ndryshme kulturore. | | Të kuptuarit e klientëve nga vendet e tjera. |
| Integritet i lartë: Aftësia për të qenë të ndershëm dhe për të patur parime të forta morale, ose ndershmëri morale. Është një zgjedhje personale për të ruajtur standarde të qëndrueshme në sjelljen personale. Në etikë, integriteti konsiderohet si ndershmëria dhe vërtetësia ose saktësia e veprimeve të dikujt. | | Ndershmëria, korrektësia, komunikimi me etikë profesionale, saktësia në llogaritje. |


PRAKTIKANT
KOLLA "KRISTO ISAK"

# Guidë turistike

Aftësi për Punë / Skills for Jobs



Para se të shkojë në punë, Egla kontrollon parashikimin e motit për ditën e sotme, pasi ajo do të jetë jashtë mbasdite vonë për një shëtitje në qytet me disa klientë biznesi që kanë ardhur të marrin pjesë në një konferencë. Do të jetë kohë me diell gjatë gjithë ditës, kështu që merr me vete një kapele dhe syze dielli. Kur arrin në zyrën turistike, mbikqyrësja e thërret në zyrën e saj. Ndërsa përgjegjësja e saj duhet të largohet për një shëtitje "mëngjes në qytet" të rezervuar në minutë të fundit, Egla do të jetë përgjegjëse për zyrën dhe duhet të informojë klientët që shkojnë e vijnë. Meqenëse nuk ka asnjë klient në zyrë, ajo mund të fillojë të përgatitet për shëtitjen nëpër qytet mbasdite. Prandaj, mbikqyrësja e saj i jep edhe informacione të tjera për klientët. Ata janë të gjithë mjekë dhe pjesëmarrës të një konference ndërkombëtare mjekësore që po organizohet në qytet. Qëllimi i turneut është që t'u tregojë atyre disa ndërtesa historike, por edhe t'i ndihmojë për të menduar qartë dhe për të lëvizur pas një dite të gjatë ulur dhe vetëm duke dëgjuar të tjerët. Përveç kësaj, mbikqyrësja e Eglës i thotë se do t'i duhet të shoqërojë edhe një klasë me nxënës të shkollës nëpër qytet, pasi javën tjetër do të organizojnë javën e mesjetës. Pas takimit me mbikqyrësen e saj, Egla ulet në kompjuter në zyrën e pritjes dhe fillon të përgatitet për të dy shëtitjet. Për shëtitjen e ditës së sotme ajo vendos që të të shëtisin së pari përgjatë lumit për t'u çlodhur në gjelbërimin e qytetit, dhe më pas t'i tregojë mjekëve spitalin historik pasi ndodhet në afërsi të një lagjeje shumë të pëlqyer me shumë bare dhe restorante luksoze. Egla planifikon që ta mbyllë shëtitjen pikërisht atje, në mënyrë që pjesëmarrësit të kenë mundësinë të ulen e të pijnë diçka para darkës. Ajo mban disa shënime rreth historisë së spitalit, vlerave të tij kulturore dhe për fushat e specializuara të tij në ditët e sotme dhe disa fakte e shifra të tjera të rëndësishme. Meqenëse pjesëmarrësit vijnë nga e gjithë bota, Egla do ta organizojë dhe realizojë shëtitjen në gjuhën angleze.

Ndërsa për shëtitjen me klasën e nxënësve gjatë javës së ardhshme, ajo informohet në lidhje me ngjarjet e rëndësishme të periudhës së mesjetës në qytet dhe sheh edhe oraret e hapjes së ndërtesave historike mesjetare në qytet. Ndëkohë që po studion dhe kërkon informacion, në zyrë hyn një çift të cilët kërkojnë një hartë të qytetit. Egla e ndërpret punën e saj dhe i jep çiftit një hartë dhe i pyet nëse dëshirojnë që t'iu tregojë ndonjë gjë specifike në hartë. Zonja kërkon një këshillë për një restorant të mirë për të ngrënë drekë në qendër të qytetit. Egla i jep asaj një përzgjedhje të restoranteve të ndryshme, i përshkruan ato shpejt dhe u tregon edhe se cili është i preferuari i saj. I përshëndet dhe i përcjell me mirësjellje dhe i kthehet punës së saj.

Mbasdite, në fillim të shëtitjes me mjekët Egla bën një prezantim të shpejtë të vetes dhe iu uron pjesëmarrësve mirëseardhjen. Ajo e kupton që grupit i pëlqeu shumë shëtitja përgjatë lumit dhe se ata ishin të gjithë shumë të interesuar për shumëllojshmërinë e luleve që gjenden atje. Ajo i shpjegon se bashkia ka zbatuar disa vite më parë një projekt për të mbrojtur dhe mbështetur biodiversitetin dhe kjo është edhe arsyeja përse ata kishin krijuar zona të gjelbra me barëra, lule dhe pemë të vendit në të gjithë qytetin. Ajo vendos në moment që të zgjasë shëtitjen përgjatë lumit dhe të shkurtojë pjesën e spitalit historik, pasi e vuri re që pjesëmarrësit ishin lodhur duke dëgjuar informacion mjekësor për shkak të konferencës voluminoze. Kur arritën në zonën e bareve, Egla vuri re se do të ishte mirë që ta mbyllte shëtitjen pikërisht aty. Të gjithë pjesëmarrësit ishin të interesuar për jetën shoqërore të qytetit dhe shkuan të gjithë së bashku për të pirë diçka. Egla ishte e kënaqur, pasi shëtitja shkoi mirë. Para se të shkonte në shtëpi, iu desh të kthehej në zyrë për të lënë materialet e saj dhe për të informuar mbikqyrësen e saj në lidhje me ecurinë e punës.


**Një projekt i Agjencisë Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim SDC**

Schweizerische Eidgenossenschaft
Confédération suisse
Confederazione Svizzera
Confederaziun svizra

Agjencia Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim SDC

**Në partneritet me:**

Republika e Shqipërisë
Ministria e Financave dhe Ekonomisë

**Zbatuar nga:**

swisscontact

# Guidë turistike

# Kërkesat e shkollës

| Kërkesa | e ulët ◂ RËNDËSI ▸ e lartë | Komente |
|---|---|---|
| Matematikë: Puna me numra, forma gjeometrike dhe algjebër. | | Llogaritja e itinerareve. |
| Gjuhë e shkruar (shqip): Përdorimi i gjuhës së shkruar si mjet komunikimi në aktivitetet profesionale. | | Shkrimi/përgatitja e paketave turistike. |
| Gjuhë e folur (shqip): Përdorimi i gjuhës së folur si mjet komunikimi në aktivitetet profesionale. | | Kontaktimi i organizatave partnere dhe klientëve. |
| Gjuhë e huaj e shkruar: Përdorimi i gjuhës së huaj të shkruar si mjet komunikimi në aktivitetet profesionale. | | Komunikimi me e-mail, rezervimi i tureve,dhënia e përgjigjeve të pyetjeve të klientëve nga jashtë vendit. |
| Gjuhë e huaj e folur: Përdorimi i gjuhës së huaj të folur si mjet komunikimi në aktivitetet profesionale. | | Udhëtimet me të huajt. |
| Shkencat Natyrore: Aftësitë dhe njohuritë shkencore të nevojshme për të hetuar, zgjidhur problemet, për të marrë vendime, për të mësuar gjatë gjithë jetës, për të drejtuar pyetje dhe për të shuar kuriozitetin e tyre. | | Promovimi i trashëgimisë natyrore të vendit, florës dhe faunës. |
| Shoqëria dhe Mjedisi: Kuptimi i proceseve ligjore, politike, ekonomike, sociale, historike, kulturore dhe i çështjeve të ndërlidhura me to. | | Promovimi i trashëgimisë kulturore të vendit. |
| Arte: Mësimi, komunikimi, interpretimi dhe zhvillimi i aftësive të tyre artistike për të shprehur veten dhe për të asistuar në ndryshimin artistik dhe kulturore të vetvetes dhe të tjerëve. | | Promovimi i artit dhe arkitekturës së vendit. |
| Teknologjia & TIK: Përdorimi i TIK-ut për të kërkuar dhe marrë informacion nga burimet on-line; menaxhimi i projekteve në grupe pune; diskutimi dhe ndarja me të tjerët e gjetjeve të tyre gjatë kërkimit. | | Përdorimi i kompjuterit, intranetit dhe internetit. |



# Guidë turistike

# Kërkesat fizike

| Kërkesa | e ulët ◂ RËNDËSI ▸ e lartë | Komente |
|---|---|---|
| Aftësitë e forta motorike: Përdorimi në shkallë të gjerë dhe të koordinuar i duarve dhe krahëve. | | |
| Aftësitë e buta motorike: Kryerja në masë të vogël e lëvizjeve të koordinuara dhe të kontrolluara të duarve dhe gishtërinjve. | | |
| Forca: Përdorimi i fuqisë muskulore, si afatshkurtër dhe impulsive (p.sh. për ngritjen e një arke të rëndë) ose afatgjatë dhe e vazhdueshme (p.sh. puna me trapan në një sipërfaqe mbi kokë). Përdorimi i zgjatur i fuqisë së muskujve gjatë ngritjes së objekteve, përdorimi i mjeteve/veglave ose ecja, vrapimi. | | Ecja në vendin që vizitohet. |
| Aftësi normale për dallimin e ngjyrave: Aftësia për të dalluar të gjitha ngjyrat saktë | | Tregon duke iu referuar objekteve me ngjyra. |
| Shqisa e shijes, aromës: Nuhatja dhe/ ose shijimi, p.sh. kur gatuhet, prodhohen aroma; njohja e rreziqeve (p.sh. rrjedhje gazi, ushqime të prishura). | | |
| Asnjë lloj alergjie / intolerance: Nuk ka alergji / intolerancë ndaj substancave, si ushqime, pëlhura, etj. | | |
| Puna në temperatura dhe kushte të ndryshme atmosferike: Puna në ambiente jashtë, pavarësisht nga kushtet e motit dhe temperatura. | | Shoqëron grupet në të gjitha stinët dhe të gjitha llojet e kushteve atmosferike. |



# Guidë turistike

# Kompetencat personale dhe sociale

| Kërkesa | e ulët ◂ RËNDËSI ▸ e lartë | Komente |
|---|---|---|
| Qëndrueshmëria emocionale: Menaxhimi i situatave stresuese dhe marrja e masave për të reduktuar stresin në përgjegjësinë e vet. Veprimi i koordinuar dhe i synuar edhe nën presion kohor. | | Menaxhon situatat e vështira. |
| Ritmi i shpejtë ose i pandikueshëm i punës: Puna (ritmi) mund të ndryshojë nga një çast në tjetrin, për shkak të kërkesës spontane dhe urgjente të klientit ose për shkak të ndryshimit dinamik të kushteve të punës. | | Përshtat kohën e punës sipas nevojave të klientit. |
| Përqendrim dhe qëndresë e lartë: Përqendrim i lartë në një detyrë që kërkon rezistencë të lartë ndaj shpërqendrimit për një periudhë të zgjatur kohore . | | |
| Aftësi të forta krijuese dhe aftësi për zgjidhjen e problemeve: Të menduarit për arritjet me qëllim transferimin e një faze aktuale në një fazë të synuar pavarësisht rezistencës e kundërshtive. | | Planifikon ture interesante të përshtatura për nevojat e klientëve. |
| Fleksibiliteti në lidhje me vendndodhjen e punës: Aftësia për t'u përshtatur shpejt në vende të ndryshme pune në ambiente brenda ose jashtë. | | |
| Fleksibiliteti në lidhje me orarin e punës: Aftësia për t'u përshtatur me orare të ndryshme pune, të cilat mund të ndryshojnë nga orët standarde të punës, si puna gjatë natës ose herët në mëngjes. | | Punon shpesh jashtë orarit / me orë të gjata pune. |
| Qasje e hapur ndaj personave të tjerë me të cilët kontakton shpesh: Vendosja dhe ruajtja e marrëdhënieve formale, ruajtja e formave të kontaktimit me autoritetet, klientët, partnerët e biznesit, etj. | | Komunikimi me gjuhën e trupit (gjestet, duart, sytë). |
| Kënaqësi nga kontakti i vazhdueshëm, ndjeshmëri, empati: Qasja empatike tek njerëzit e tjerë me qëllim krijimin dhe ruajtjen e marrëdhënieve. Kjo kërkesë është e rëndësishme në shumë shërbime ku kërkohet kontakt i vazhdueshëm me klientët, si shitja, kujdesi estetik, konsultimi, terapia. | | |
| Aftësi e spikatur për të punuar në ekip për shkak të bashkëpunimit të ngushtë: Bashkëpunimi brenda ekipit, përkatësisht koordinimi ndërmjet anëtarëve të ekipit, supozimi i besueshëm i nëndetyrave, përgjegjësi e përbashkët për arritjen e qëllimeve. | | Punon gjithmonë në ekip. |
| Kompetencat ndërkulturore: Aftësitë njohëse, emocionale dhe të sjelljes që çojnë në komunikim efektiv dhe të përshtatshëm me njerëzit e kulturave të tjera. Ato përfshijnë sjelljet që i përshtaten pritshmërive të një kulture të caktuar, karakteristikat e situatës dhe nivelin e marrëdhënieve midis palëve të përfshira në këtë situatë. Ato gjithashtu marrin parasysh normat e veta kulturore dhe kompromisin më të përshtatshëm dhe më të qetë ndërmjet normave të ndryshme kulturore. | | Udhërrëfyesi/ guida është promovues i vlerave historike dhe kulturore. |
| Integritet i lartë: Aftësia për të qenë të ndershëm dhe për të patur parime të forta morale, ose ndershmëri morale. Është një zgjedhje personale për të ruajtur standarde të qëndrueshme në sjelljen personale. Në etikë, integriteti konsiderohet si ndershmëria dhe vërtetësia ose saktësia e veprimeve të dikujt. | | Ndershmëria dhe integriteti ndaj klientëve. |


MADRID
SUN
HONG KONG
MUNICH
SINGAPORE
NEW YORK
AMSTERDAM
DELHI
LONDON
MARS
BANGKOK
Phnom Penh

# Kuzhinë



Sot Laerti po përgatit një recetë të re për rizoto. Së pari, ai e lexon recetën që i është dhënë nga shefi i kuzhinës dhe bën shënime shtesë në fletën e recetës. Meqenëse receta është e përgatitur vetëm për 4 persona, ai duhet të llogarisë masat e ndryshme sipas numrit të racioneve që duhen përgatitur. Ai kërkon ndihmën e kuzhinierit për të kuptuar disa terma teknike të pa njohura për të. Laerti dëgjon me vëmendje dhe mban shënime. Gjithashtu, Laerti udhëzohet nga shefi për të kërkuar informacion të mëtejshëm në lidhje me varietetet e ndryshme të orizit në një libër të specializuar për shkencën ushqimore. Ai duhet të zgjedhë për recetën një lloj orizi të vjetër që e ka origjinën pikërisht në rajonin ku ndodhet restoranti. Ai habitet kur shikon se sa lloje të ndryshme orizi ekzistojnë. Për llojin e orizit të kërkuar ai mban shënim karakteristikat sa i takon shijes, të cilat duhet t'ia tregojë më vonë përsonave që shërbejnë në restorant, në mënyrë që ata të jenë të aftë që t'i shpjegojnë të njëjtën gjë klientëve të interesuar. Për ekipin e kuzhinës ai shënon specifikimet sa i takon gatimit të këtij lloj orizi të veçantë. Ai mban mend nga mësimet në shkollë, që është e rëndësishme që orizi që përdoret për rizoto të çlirojë një sasi të mjaftueshme niseshteje dhe që ka nevojë për më shumë ujë sesa orizi normal, dhe për t'i lehtësuar të dyja proceset, përzierja është thelbësore. Para se të fillojë gatimin ai duhet të mbledhë dhe të përgatisë të gjithë përbërësit e tjerë të nevojshëm dhe enët e kuzhinës. Ai e lexon përsëri të gjithë recetën dhe shikon të gjithë përbërësit që mund të përgatiten paraprakisht. Meqenëse rizotoja do të jetë pjesë e menusë së ditës e cila porositet më shumë se të tjerat, Laertit i duhet të presë imët disa kilogramë me qepë më anën e një thike të mprehtë. Përgjegjësi kontrollon madhësinë e copave dhe i thotë që duhen prerë më imët. Laerti duhet të jetë shumë i përqendruar, pasi i duhet të presë shpejt duke përdorur një thikë shumë të mprehtë. Kur mbaron me qepët, fillon të grijë majdanozin. Gjatë gjithë kohës, ai lexon pjesë të veçanta të recetës për t'u siguruar që nuk do të harrojë as edhe një përbërës pa përgatitur.

Kur mbaron së përgatituri gjithçka, e pastron vendin e punës dhe e pyet përgjegjësin se çfarë duhet të bëjë më tej. Vetë përgjegjësi ka shumë pak kohë në dispozicion, pasi është duke biseduar me punonjësit e tjerë dhe i jep udhëzime të shkurtra nga ana tjetër e kuzhinës, të cilat Laerti i përthith menjëherë. Për kuzhinierin është shumë e rëndësishme që çdo gjë të jetë e organizuar dhe në vend para se të filloi fluksi i lartë i punës gjatë drekës. Tani Laerti mund të fillojë të përgatisë rizoton, për të cilin i duhet të përdorë një tenxhere të madhe dhe të rëndë. Përsëri, ai e shikon recetën dhe ndjek hapat e ndryshëm me përpikmëri. Që kur ka filluar praktikën profesionale, Laerti e ka vënë re që ka filluar të bëjë muskuj. Ndërkohë që përzien fort rizoton e trashë në tenxheren e stërmadhe ai ndjen sforcimin në krah, dhe e kupton arsyen.

Tani pjata është pothuajse gati. Nuk i mbetet gjë tjetër veçse ta zbukurojë dhe shërbejë. Shefi i thotë shkurt e saktë: "Buza e pjatës duhet të jetë e pastër!" Laerti pohon me kokë dhe përgatit pjatën. Tani është koha që Laerti së bashku me përgjegjësin e tij të provojnë rizoton. Së pari, Laerti dëgjon me vëmendje mendimin e shefit në lidhje me pjatën e rizotos të përgatitur nga ai. Ai mendon se çfarë mund të bëjë ndryshe herën tjetër dhe rezultatin që do të kishte. Laerti i tregon mbikqyrësit të tij gjetjet dhe shënimet e tij, të cilat i ka mbajtur gjatë përgatitjes dhe bazuar në mendimet e shefit.

Pas diskutimit me shefin në lidhje me pjatën, Laerti ndryshon recetën në bazë të gjetjeve. Ai e lexon përsëri dhe e ruan në programin e recetave.

**Një projekt i Agjencisë Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim SDC**

Schweizerische Eidgenossenschaft
Confédération suisse
Confederazione Svizzera
Confederaziun svizra

Agjencia Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim SDC

**Në partneritet me:**

Republika e Shqipërisë
Ministria e Financave dhe Ekonomisë

**Zbatuar nga:**

swisscontact

# Kuzhinë

# Kërkesat e shkollës

| Kërkesa | e ulët ◂ RËNDËSI ▸ e lartë | Komente |
|---|---|---|
| Matematikë: Puna me numra, forma gjeometrike dhe algjebër. | | Mat, llogarit sasitë, përdor njësi të ndryshme. Lexon receta, analizon. |
| Gjuhë e shkruar (shqip): Përdorimi i gjuhës së shkruar si mjet komunikimi në aktivitetet profesionale. | | Komunikimi me anëtarët e ekipit, udhëzimet e shpejta duhet të kuptohen dhe zbatohen në mënyrë aktive. |
| Gjuhë e folur (shqip): Përdorimi i gjuhës së folur si mjet komunikimi në aktivitetet profesionale. | | |
| Gjuhë e huaj e shkruar: Përdorimi i gjuhës së huaj të shkruar si mjet komunikimi në aktivitetet profesionale. | | |
| Gjuhë e huaj e folur: Përdorimi i gjuhës së huaj të folur si mjet komunikimi në aktivitetet profesionale. | | |
| Shkencat Natyrore: Aftësitë dhe njohuritë shkencore të nevojshme për të hetuar, zgjidhur problemet, për të marrë vendime, për të mësuar gjatë gjithë jetës, për të drejtuar pyetje dhe për të shuar kuriozitetin e tyre. | | |
| Shoqëria dhe Mjedisi: Kuptimi i proceseve ligjore, politike, ekonomike, sociale, historike, kulturore dhe i çështjeve të ndërlidhura me to. | | |
| Arte: Mësimi, komunikimi, interpretimi dhe zhvillimi i aftësive të tyre artistike për të shprehur veten dhe për të asistuar në ndryshimin artistik dhe kulturore të vetvetes dhe të tjerëve. | | |
| Teknologjia & TIK: Përdorimi i TIK-ut për të kërkuar dhe marrë informacion nga burimet on-line; menaxhimi i projekteve në grupe pune; diskutimi dhe ndarja me të tjerët e gjetjeve të tyre gjatë kërkimit. | | |



# Kuzhinë

# Kërkesat fizike

| Kërkesa | e ulët ◂ RËNDËSI ▸ e lartë | Komente |
|---|---|---|
| Aftësitë e forta motorike: Përdorimi në shkallë të gjerë dhe të koordinuar i duarve dhe krahëve. | | Mban tenxhere. |
| Aftësitë e buta motorike: Kryerja në masë të vogël e lëvizjeve të koordinuara dhe të kontrolluara të duarve dhe gishtërinjve. | | Punon me thika të mprehta, përgatit pjatat, punë e kujdesshme, pret, qëron, lan. |
| Forca: Përdorimi i fuqisë muskulore, si afatshkurtër dhe impulsive (p.sh. për ngritjen e një arke të rëndë) ose afatgjatë dhe e vazhdueshme (p.sh. puna me trapan në një sipërfaqe mbi kokë). Përdorimi i zgjatur i fuqisë së muskujve gjatë ngritjes së objekteve, përdorimi i mjeteve/veglave ose ecja, vrapimi. | | Mban pesha të rënda. Energji, qëndron në këmbë gjatë gjithë ditës. |
| Aftësi normale për dallimin e ngjyrave: Aftësia për të dalluar të gjitha ngjyrat saktë | | Estetika, njeriu ha edhe me sy. |
| Shqisa e shijes, aromës: Nuhatja dhe/ ose shijimi, p.sh. kur gatuhet, prodhohen aroma; njohja e rreziqeve (p.sh. rrjedhje gazi, ushqime të prishura). | | Degustimi dhe shijimi i pjatave të përgatitura. Shija është thelbësore, është art, shije, risi, kreativitet. |
| Asnjë lloj alergjie / intolerance: Nuk ka alergji / intolerancë ndaj substancave, si ushqime, pëlhura, etj. | | Alergjitë (nga lule ose solucione pastrimi). |
| Puna në temperatura dhe kushte të ndryshme atmosferike: Puna në ambiente jashtë, pavarësisht nga kushtet e motit dhe temperatura. | | Nxehtësia në kuzhinë. |



# Kuzhinë

# Kompetencat personale dhe sociale

| **Kërkesa** | **e ulët ◂ RËNDËSI ▸ e lartë** | **Komente** |
|---|---|---|
| Qëndrueshmëria emocionale: Menaxhimi i situatave stresuese dhe marrja e masave për të reduktuar stresin në përgjegjësinë e vet. Veprimi i koordinuar dhe i synuar edhe nën presion kohor. |  | Të qenit i stresuar shkakton aksidente. |
| Ritmi i shpejtë ose i pandikueshëm i punës: Puna (ritmi) mund të ndryshojë nga një çast në tjetrin, për shkak të kërkesës spontane dhe urgjente të klientit ose për shkak të ndryshimit dinamik të kushteve të punës. |  | |
| Përqendrim dhe qëndresë e lartë: Përqendrim i lartë në një detyrë që kërkon rezistencë të lartë ndaj shpërqendrimit për një periudhë të zgjatur kohore . |  | |
| Aftësi të forta krijuese dhe aftësi për zgjidhjen e problemeve: Të menduarit për arritjet me qëllim transferimin e një faze aktuale në një fazë të synuar pavarësisht rezistencës e kundërshtive. |  | |
| Fleksibiliteti në lidhje me vendndodhjen e punës: Aftësia për t'u përshtatur shpejt në vende të ndryshme pune në ambiente brenda ose jashtë. |  | |
| Fleksibiliteti në lidhje me orarin e punës: Aftësia për t'u përshtatur me orare të ndryshme pune, të cilat mund të ndryshojnë nga orët standarde të punës, si puna gjatë natës ose herët në mëngjes. |  | |
| Qasje e hapur ndaj personave të tjerë me të cilët kontakton shpesh: Vendosja dhe ruajtja e marrëdhënieve formale, ruajtja e formave të kontaktimit me autoritetet, klientët, partnerët e biznesit, etj. |  | Marrëdhëniet korrekte me mbikëqyrësit dhe kolegët. |
| Kënaqësi nga kontakti i vazhdueshëm, ndjeshmëri, empati: Qasja empatike tek njerëzit e tjerë me qëllim krijimin dhe ruajtjen e marrëdhënieve. Kjo kërkesë është e rëndësishme në shumë shërbime ku kërkohet kontakt i vazhdueshëm me klientët, si shitja, kujdesi estetik, konsultimi, terapia. |  | |
| Aftësi e spikatur për të punuar në ekip për shkak të bashkëpunimit të ngushtë: Bashkëpunimi brenda ekipit, përkatësisht koordinimi ndërmjet anëtarëve të ekipit, supozimi i besueshëm i nëndetyrave, përgjegjësi e përbashkët për arritjen e qëllimeve. |  | Shkëmbimi i ideve brenda ekipit sjell zhvillim. |
| Kompetencat ndërkulturore: Aftësitë njohëse, emocionale dhe të sjelljes që çojnë në komunikim efektiv dhe të përshtatshëm me njerëzit e kulturave të tjera. Ato përfshijnë sjelljet që i përshtaten pritshmërive të një kulture të caktuar, karakteristikat e situatës dhe nivelin e marrëdhënieve midis palëve të përfshira në këtë situatë. Ato gjithashtu marrin parasysh normat e veta kulturore dhe kompromisin më të përshtatshëm dhe më të qetë ndërmjet normave të ndryshme kulturore. |  | |
| Integritet i lartë: Aftësia për të qenë të ndershëm dhe për të patur parime të forta morale, ose ndershmëri morale. Është një zgjedhje personale për të ruajtur standarde të qëndrueshme në sjelljen personale. Në etikë, integriteti konsiderohet si ndershmëria dhe vërtetësia ose saktësia e veprimeve të dikujt. |  | Ndershmëria. |



# Mbështetje për përdoruesit e Teknologjisë së Informacioni dhe Komunikimi

S4J
Aftësi për Punë / Skills for Jobs




Sot Fationi do ta fillojë ditën e punës jo në zyrë, por jashtë, në zyrën e një klienti. Një përkthyes ka blerë një kompjuter të ri i cili duhet të vihet në punë. Dje ai i ka instaluar programin e blerë. Natyrisht, përkthyesi ka nevojë për një program për të shkruar, por ka nevojë edhe për një program të thjeshtë për faturimin e shërbimeve të tij, për të cilat ai kishte nevojë për këshillat e Fationit. Fationi ka zgjedhur një program të thjeshtë me rekomandime shumë të mira. Sot ai duhet t'ia shpjegojë programin klientit dhe e sjell kompjuterin në zyrën e klientit në kohën e dakordësuar. Atje, ai bën lidhjen me internetin e cila është shumë e rëndësishme për përkthyesin pasi ai përdor metodat e përkthimit online.

Ruajtja e të dhënave të klientit është shumë e rëndësishme. Fationi kujdeset edhe për këtë. Tani ai i shpjegon me kujdes klientit se si të fillojë dhe të përdorë kompjuterin dhe programet. Ai i kujton atij se tani merr mbështetje falas për një muaj, prandaj, ai i instalon edhe programin "Team viewer". Në këtë mënyrë ai mund të hyjë në kompjuterin e klientit nga zyra e tij. Fationi i sugjeron klientit të testojë dhe të provojë programin sa më shumë që të jetë e mundur gjatë muajit të ardhshëm dhe thjesht t'i telefonojë ose t'i dërgojë një e-mail nëse ka ndonjë pyetje.

Kur kthehet në zyrë, Fationi dokumenton me kujdes proceset e konfigurimit në kompjuterin e përkthyesit. Kjo është e rëndësishme nëse përkthyesi do të ketë nevojë për mbështetje në të ardhmen.

Më vonë merr një telefonatë nga një klient i mërzitur. Fationi e ngre telefonin pasi mbikqyrësi i tij është është i zënë për momentin. Klienti ka problem me gjetjen e të dhënave të tij. Fationi lidhet me kompjuterin e tij nëpërmjet TeamViewer dhe dyshon se klienti ka probleme me hard diskun i cili mund të jetë i dëmtuar.

Ai i telefonon mbikqyrësit të tij dhe i shpjegon problemin e klientit dhe punën që ka bërë. Mbikqyrësi është i të njëjtit mendim si edhe Fationi sa i takon hard diskut të dëmtuar, dhe e dërgon tek klienti për ta zëvendësuar atë. Fationi është krenar për besimin e mbikqyrësit të tij dhe që ai e lejoi që të punojë në mënyrë të pavarur. Për fat të mirë, klienti i ruan të dhënat në mënyrë të vazhdueshme në një disk të jashtëm. Pasi Fationi arrin në zyrën e klientit, ai merr të gjitha programet dhe të dhënat nga ky disk dhe më pas sigurohet që çdo gjë të funksionojë përsëri siç duhet. Klienti e falenderon Fationin për zgjidhjen e shpejtë dhe ndihmën e tij, pasi është tejet i varur nga kompjuteri si instrumenti kryesor i punës së tij.

As që nuk e vuri re se si kishte kaluar koha dhe se ishte duke punuar përsëri jashtë orarit. Mirënjohja e klientit të kënaqur e bëri ta harronte lodhjen.


**Një projekt i Agjencisë Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim SDC**

Schweizerische Eidgenossenschaft
Confédération suisse
Confederazione Svizzera
Confederaziun svizra

Agjencia Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim SDC

**Në partneritet me:**

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E FINANCAVE DHE EKONOMISË

**Zbatuar nga:**

swisscontact

# Mbështetje për përdoruesit e Teknologjisë së Informacioni dhe Komunikimi

# Kërkesat e shkollës

| Kërkesa | e ulët ◂ RËNDËSI ▸ e lartë | Komente |
| --- | --- | --- |
| Matematikë: Puna me numra, forma gjeometrike dhe algjebër. | | |
| Gjuhë e shkruar (shqip): Përdorimi i gjuhës së shkruar si mjet komunikimi në aktivitetet profesionale. | | Shkrimi i biletave (problemeve) në mënyrë të qartë. |
| Gjuhë e folur (shqip): Përdorimi i gjuhës së folur si mjet komunikimi në aktivitetet profesionale. | | Komunikimi me klientët. |
| Gjuhë e huaj e shkruar: Përdorimi i gjuhës së huaj të shkruar si mjet komunikimi në aktivitetet profesionale. | | Shkrimi i biletave për partnerët e jashtëm. |
| Gjuhë e huaj e folur: Përdorimi i gjuhës së huaj të folur si mjet komunikimi në aktivitetet profesionale. | | Komunikimi me klientët ndërkombëtarë. |
| Shkencat Natyrore: Aftësitë dhe njohuritë shkencore të nevojshme për të hetuar, zgjidhur problemet, për të marrë vendime, për të mësuar gjatë gjithë jetës, për të drejtuar pyetje dhe për të shuar kuriozitetin e tyre. | | |
| Shoqëria dhe Mjedisi: Kuptimi i proceseve ligjore, politike, ekonomike, sociale, historike, kulturore dhe i çështjeve të ndërlidhura me to. | | |
| Arte: Mësimi, komunikimi, interpretimi dhe zhvillimi i aftësive të tyre artistike për të shprehur veten dhe për të asistuar në ndryshimin artistik dhe kulturore të vetvetes dhe të tjerëve. | | |
| Teknologjia & TIK: Përdorimi i TIK-ut për të kërkuar dhe marrë informacion nga burimet on-line; menaxhimi i projekteve në grupe pune; diskutimi dhe ndarja me të tjerët e gjetjeve të tyre gjatë kërkimit. | | |



# Mbështetje për përdoruesit e Teknologjisë së Informacioni dhe Komunikimi

## Kërkesat fizike

| Kërkesa | e ulët ◂ RËNDËSI ▸ e lartë | Komente |
|---|---|---|
| Aftësitë e forta motorike: Përdorimi në shkallë të gjerë dhe të koordinuar i duarve dhe krahëve. | | |
| Aftësitë e buta motorike: Kryerja në masë të vogël e lëvizjeve të koordinuara dhe të kontrolluara të duarve dhe gishtërinjve. | | |
| Forca: Përdorimi i fuqisë muskulore, si afatshkurtër dhe impulsive (p.sh. për ngritjen e një arke të rëndë) ose afatgjatë dhe e vazhdueshme (p.sh. puna me trapan në një sipërfaqe mbi kokë). Përdorimi i zgjatur i fuqisë së muskujve gjatë ngritjes së objekteve, përdorimi i mjeteve/veglave ose ecja, vrapimi. | | |
| Aftësi normale për dallimin e ngjyrave: Aftësia për të dalluar të gjitha ngjyrat saktë | | |
| Shqisa e shijes, aromës: Nuhatja dhe/ ose shijimi, p.sh. kur gatuhet, prodhohen aroma; njohja e rreziqeve (p.sh. rrjedhje gazi, ushqime të prishura). | | |
| Asnjë lloj alergjie / intolerance: Nuk ka alergji / intolerancë ndaj substancave, si ushqime, pëlhura, etj. | | |
| Puna në temperatura dhe kushte të ndryshme atmosferike: Puna në ambiente jashtë, pavarësisht nga kushtet e motit dhe temperatura. | | |



# Mbështetje për përdoruesit e Teknologjisë së Informacioni dhe Komunikimi

# Kompetencat personale dhe sociale

| Kërkesa | e ulët ◂ RËNDËSI ▸ e lartë | Komente |
|---|---|---|
| Qëndrueshmëria emocionale: Menaxhimi i situatave stresuese dhe marrja e masave për të reduktuar stresin në përgjegjësinë e vet. Veprimi i koordinuar dhe i synuar edhe nën presion kohor. | | Respektimi i afateve, komunikimi me klientët, detyrat që kërkojnë përgatitje mendore. |
| Ritmi i shpejtë ose i pandikueshëm i punës: Puna (ritmi) mund të ndryshojë nga një çast në tjetrin, për shkak të kërkesës spontane dhe urgjente të klientit ose për shkak të ndryshimit dinamik të kushteve të punës. | | Klientët presin zgjidhje të shpejtë të problemeve. |
| Përqendrim dhe qëndresë e lartë: Përqendrim i lartë në një detyrë që kërkon rezistencë të lartë ndaj shpërqendrimit për një periudhë të zgjatur kohore . | | Të gjitha punët duhet të kryhen me saktësi dhe korrektësi. |
| Aftësi të forta krijuese dhe aftësi për zgjidhjen e problemeve: Të menduarit për arritjet me qëllim transferimin e një faze aktuale në një fazë të synuar pavarësisht rezistencës e kundërshtive. | | |
| Fleksibiliteti në lidhje me vendndodhjen e punës: Aftësia për t'u përshtatur shpejt në vende të ndryshme pune në ambiente brenda ose jashtë. | | |
| Fleksibiliteti në lidhje me orarin e punës: Aftësia për t'u përshtatur me orare të ndryshme pune, të cilat mund të ndryshojnë nga orët standarde të punës, si puna gjatë natës ose herët në mëngjes. | | Puna e shpeshtë nën presionin e kohës |
| Qasje e hapur ndaj personave të tjerë me të cilët kontakton shpesh: Vendosja dhe ruajtja e marrëdhënieve formale, ruajtja e formave të kontaktimit me autoritetet, klientët, partnerët e biznesit, etj. | | Kontakti me klientët. |
| Kënaqësi nga kontakti i vazhdueshëm, ndjeshmëri, empati: Qasja empatike tek njerëzit e tjerë me qëllim krijimin dhe ruajtjen e marrëdhënieve. Kjo kërkesë është e rëndësishme në shumë shërbime ku kërkohet kontakt i vazhdueshëm me klientët, si shitja, kujdesi estetik, konsultimi, terapia. | | |
| Aftësi e spikatur për të punuar në ekip për shkak të bashkëpunimit të ngushtë: Bashkëpunimi brenda ekipit, përkatësisht koordinimi ndërmjet anëtarëve të ekipit, supozimi i besueshëm i nëndetyrave, përgjegjësi e përbashkët për arritjen e qëllimeve. | | Puna në mënyrë të kuptueshme dhe të gjurmueshme (për kolegët, nëse dikush është i sëmurë), puna në ekip për projekte. |
| Kompetencat ndërkulturore: Aftësitë njohëse, emocionale dhe të sjelljes që çojnë në komunikim efektiv dhe të përshtatshëm me njerëzit e kulturave të tjera. Ato përfshijnë sjelljet që i përshtaten pritshmërive të një kulture të caktuar, karakteristikat e situatës dhe nivelin e marrëdhënieve midis palëve të përfshira në këtë situatë. Ato gjithashtu marrin parasysh normat e veta kulturore dhe kompromisin më të përshtatshëm dhe më të qetë ndërmjet normave të ndryshme kulturore. | | Kontakti i shpeshtë me klientë shumë të ndryshëm. |
| Integritet i lartë: Aftësia për të qenë të ndershëm dhe për të patur parime të forta morale, ose ndershmëri morale. Është një zgjedhje personale për të ruajtur standarde të qëndrueshme në sjelljen personale. Në etikë, integriteti konsiderohet si ndershmëria dhe vërtetësia ose saktësia e veprimeve të dikujt. | | Ndershmëria dhe integriteti ndaj klientëve. Puna me të dhëna të ndjeshme. |



# Rrjete të dhënash

Aftësi për Punë / Skills for Jobs



Lori punon në një kompani Teknologjie Informacioni dhe Komunikimi (TIK) në rolin e teknikes për rrjetet e të dhënave. Detyra e saj sot është të instalojë një rrjet të ri lokal (LAN) në një zyrë bashkiake. Prandaj, së pari i duhet të përgatisë një plan urbanistik të dhomave të ndryshme në ndërtesë. Mbikqyrësi i saj më pas i tregon se në cilën dhomë punon gjithsecili prej punonjësve të zyrës bashkiake dhe çfarë leje aksesi ka ai ose ajo. Bazuar në këtë, ata vendosin së bashku se ku do të vendosin serverat e rinj dhe pajisjet e tjera elektronike. Mbikqyrësi i saj i kërkon të llogarisë koston përfundimtare të konfigurimit dhe zbatimit të rrjetit dhe të përgatisë faturën për klientin.

Pas kësaj, ajo do të punojë në një projekt tjetër, të cilin e ka filluar disa ditë më parë. Një klient ka hapur një zyrë të dytë të së njëjtës degë në një qytet tjetër që Lori duhet ta lidhë me zyrën qendrore. Ajo duhet të konfigurojë kompjuterat dhe programet e tyre. Ajo duhet të konfigurojë edhe masat e nevojshme të sigurisë, si një firewall dhe një program antivirus. Meqenëse nuk e ka bërë këtë punë asnjëherë e vetme më parë, ajo ka kontrolluar me kujdes çdo hap që bën. Gjatë javës së fundit ka lexuar edhe dokumentacionin e një projekti të vjetër dhe të ngjashëm. Përveç kësaj, ajo ka parë edhe një video në internet në gjuhën angleze që shpjegon masat specifike të sigurisë.

Tani kanë përfunduar punimet në zyrën e re të klientit. Gjithsesi, ato zgjatën më shumë se sa ishin planifikuar, prandaj hardëare dhe softueri/programi duhet të konfigurohen dhe të testohen në kohën më të shkurtër të mundshme, pasi klienti dëshiron të fillojë punën gjatë ditëve të ardhshme. Dhe natyrisht deri atëherë gjithçka duhet të funksionojë siç duhet që nga minuti i parë.

Një gjë e rëndësishme që Lori e ka përvetësuar tashmë është dokumentimi i gjithçkaje me kujdes. Udhëzimet për proceset më të rëndësishme, siç është hyrja/log in, transferimi i të dhënave në zyrën qendrore, ruajtja e të dhënave, duhet të shkruhen në gjuhën angleze, pasi selia e kompanisë ndodhet në Angli.

Lori është krenare që mbikqyrësi i beson asaj dhe që e lejon të punojë në mënyrë të pavarur, por ajo është edhe e kënaqur që ka se çfarë t'i tregojë nga puna e saj dhe të marrë vlerësime të mira e këshilla të dobishme për hapat e mëtejshëm.

**Një projekt i Agjencisë Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim SDC**

Schweizerische Eidgenossenschaft
Confédération suisse
Confederazione Svizzera
Confederaziun svizra

Agjencia Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim SDC

**Në partneritet me:**

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E FINANCAVE DHE EKONOMISË

**Zbatuar nga:**

swisscontact

# Rrjete të dhënash

# Kërkesat e shkollës

| Kërkesa | e ulët ◂ RËNDËSI ▸ e lartë | Komente |
| --- | --- | --- |
| Matematikë: Puna me numra, forma gjeometrike dhe algjebër. | | Konvertimet binare, vlerësimet e kostos. |
| Gjuhë e shkruar (shqip): Përdorimi i gjuhës së shkruar si mjet komunikimi në aktivitetet profesionale. | | Shkruan dhe kupton përmbajtjen, komunikimi. |
| Gjuhë e folur (shqip): Përdorimi i gjuhës së folur si mjet komunikimi në aktivitetet profesionale. | | Komunikimi me klientët; komunikimi në hapësirat e të nxënit. |
| Gjuhë e huaj e shkruar: Përdorimi i gjuhës së huaj të shkruar si mjet komunikimi në aktivitetet profesionale. | | Leximi i udhëzimeve për konfigurimin e ruterit ose të harduerit, leximi i dokumenteve. |
| Gjuhë e huaj e folur: Përdorimi i gjuhës së huaj të folur si mjet komunikimi në aktivitetet profesionale. | | Të nxënit në internet; anglisht, mësime në youtube, klientët |
| Shkencat Natyrore: Aftësitë dhe njohuritë shkencore të nevojshme për të hetuar, zgjidhur problemet, për të marrë vendime, për të mësuar gjatë gjithë jetës, për të drejtuar pyetje dhe për të shuar kuriozitetin e tyre. | | Kuptimi i koncepteve abstrakte; aftësia për të menduar jashtë kornizave, durimi. |
| Shoqëria dhe Mjedisi: Kuptimi i proceseve ligjore, politike, ekonomike, sociale, historike, kulturore dhe i çështjeve të ndërlidhura me to. | | |
| Arte: Mësimi, komunikimi, interpretimi dhe zhvillimi i aftësive të tyre artistike për të shprehur veten dhe për të asistuar në ndryshimin artistik dhe kulturore të vetvetes dhe të tjerëve. | | |
| Teknologjia & TIK: Përdorimi i TIK-ut për të kërkuar dhe marrë informacion nga burimet on-line; menaxhimi i projekteve në grupe pune; diskutimi dhe ndarja me të tjerët e gjetjeve të tyre gjatë kërkimit. | | Të nxënit për harduer të ri, teknologji të reja. |



# Rrjete të dhënash

# Kërkesat fizike

| **Kërkesa** | **e ulët ◂ RËNDËSI ▸ e lartë** | **Komente** |
|---|---|---|
| Aftësitë e forta motorike: Përdorimi në shkallë të gjerë dhe të koordinuar i duarve dhe krahëve. | | |
| Aftësitë e buta motorike: Kryerja në masë të vogël e lëvizjeve të koordinuara dhe të kontrolluara të duarve dhe gishtërinjve. | | Instalimi i pajisjeve; shkrimi në tastierë rrit produktivitetin. |
| Forca: Përdorimi i fuqisë muskulore, si afatshkurtër dhe impulsive (p.sh. për ngritjen e një arke të rëndë) ose afatgjatë dhe e vazhdueshme (p.sh. puna me trapan në një sipërfaqe mbi kokë). Përdorimi i zgjatur i fuqisë së muskujve gjatë ngritjes së objekteve, përdorimi i mjeteve/veglave ose ecja, vrapimi. | | |
| Aftësi normale për dallimin e ngjyrave: Aftësia për të dalluar të gjitha ngjyrat saktë | | |
| Shqisa e shijes, aromës: Nuhatja dhe/ ose shijimi, p.sh. kur gatuhet, prodhohen aroma; njohja e rreziqeve (p.sh. rrjedhje gazi, ushqime të prishura). | | |
| Asnjë lloj alergjie / intolerance: Nuk ka alergji / intolerancë ndaj substancave, si ushqime, pëlhura, etj. | | |
| Puna në temperatura dhe kushte të ndryshme atmosferike: Puna në ambiente jashtë, pavarësisht nga kushtet e motit dhe temperatura. | | |



# Rrjete të dhënash

# Kompetencat personale dhe sociale

| **Kërkesa** | **e ulët ◂ RËNDËSI ▸ e lartë** | **Komente** |
|---|---|---|
| Qëndrueshmëria emocionale: Menaxhimi i situatave stresuese dhe marrja e masave për të reduktuar stresin në përgjegjësinë e vet. Veprimi i koordinuar dhe i synuar edhe nën presion kohor. |  | Respektimi i afateve, komunikimi me klientët, detyra sfiduese që kërkojnë përgatitje mendore. |
| Ritmi i shpejtë ose i pandikueshëm i punës: Puna (ritmi) mund të ndryshojë nga një çast në tjetrin, për shkak të kërkesës spontane dhe urgjente të klientit ose për shkak të ndryshimit dinamik të kushteve të punës. |  | Kur duhet të përmbushen afatet. |
| Përqendrim dhe qëndresë e lartë: Përqendrim i lartë në një detyrë që kërkon rezistencë të lartë ndaj shpërqendrimit për një periudhë të zgjatur kohore . |  | Puna për orë të gjata, përqendrimi, zgjidhja e problemeve, zbatimi kompleks i algoritmeve. |
| Aftësi të forta krijuese dhe aftësi për zgjidhjen e problemeve: Të menduarit për arritjet me qëllim transferimin e një faze aktuale në një fazë të synuar pavarësisht rezistencës e kundërshtive. |  | Të menduarit jashtë kornizave, konteksti tejet inovativ i punës, përdorimi i teknikave të ndryshme për zgjidhjen e problemeve. |
| Fleksibiliteti në lidhje me vendndodhjen e punës: Aftësia për t'u përshtatur shpejt në vende të ndryshme pune në ambiente brenda ose jashtë. |  | Puna në zyrë dhe tek klienti. |
| Fleksibiliteti në lidhje me orarin e punës: Aftësia për t'u përshtatur me orare të ndryshme pune, të cilat mund të ndryshojnë nga orët standarde të punës, si puna gjatë natës ose herët në mëngjes. |  | Respektimi i afateve kohore |
| Qasje e hapur ndaj personave të tjerë me të cilët kontakton shpesh: Vendosja dhe ruajtja e marrëdhënieve formale, ruajtja e formave të kontaktimit me autoritetet, klientët, partnerët e biznesit, etj. |  | Diskutimi i kërkesave të projekteve me klientët. |
| Kënaqësi nga kontakti i vazhdueshëm, ndjeshmëri, empati: Qasja empatike tek njerëzit e tjerë me qëllim krijimin dhe ruajtjen e marrëdhënieve. Kjo kërkesë është e rëndësishme në shumë shërbime ku kërkohet kontakt i vazhdueshëm me klientët, si shitja, kujdesi estetik, konsultimi, terapia. |  | Puna në ekip, të kuptosh kolegët. |
| Aftësi e spikatur për të punuar në ekip për shkak të bashkëpunimit të ngushtë: Bashkëpunimi brenda ekipit, përkatësisht koordinimi ndërmjet anëtarëve të ekipit, supozimi i besueshëm i nëndetyrave, përgjegjësi e përbashkët për arritjen e qëllimeve. |  | Zbatimet bëhen në ekip. |
| Kompetencat ndërkulturore: Aftësitë njohëse, emocionale dhe të sjelljes që çojnë në komunikim efektiv dhe të përshtatshëm me njerëzit e kulturave të tjera. Ato përfshijnë sjelljet që i përshtaten pritshmërive të një kulture të caktuar, karakteristikat e situatës dhe nivelin e marrëdhënieve midis palëve të përfshira në këtë situatë. Ato gjithashtu marrin parasysh normat e veta kulturore dhe kompromisin më të përshtatshëm dhe më të qetë ndërmjet normave të ndryshme kulturore. |  | Puna për kompani të ndryshme, edhe ndërkombëtare. |
| Integritet i lartë: Aftësia për të qenë të ndershëm dhe për të patur parime të forta morale, ose ndershmëri morale. Është një zgjedhje personale për të ruajtur standarde të qëndrueshme në sjelljen personale. Në etikë, integriteti konsiderohet si ndershmëria dhe vërtetësia ose saktësia e veprimeve të dikujt. |  | Ndershmëria dhe integriteti ndaj klientëve; puna me të dhëna të ndjeshme. |



# Programim



Sidorelës i është kërkuar që të krijojë një modul të ri për një program kontabiliteti të një klienti të rëndësishëm. Për këtë qëllim, ajo dhe mbikqyrësi i saj së pari e diskutojnë projektin me klientin dhe e pyesin me saktësi në lidhje me nevojat e tij. Mbikqyrësi i shpjegon se sa e rëndësishme është që të kuptohen siç duhet proceset e kontabilitetit të klientit në mënyrë që të gjejnë zgjidhjen dhe programin më të mirë për t'iu përshtatur kërkesave të tij. Më pas, mbikqyrësi i jep Sidorelës detyrën për të analizuar programin ekzistues të klientit dhe për të përcaktuar ndërfaqen me modulin e ri.

Sidorela e di nga përvojat e saj të mëparshme se i duhet të programojë me shumë kujdes, përndryshe moduli i ri mund të shkaktojë dëme.

Ajo e dokumenton saktë si intervistën e saj me klientin ashtu dhe analizën e programit kompjuterik ekzistues. Meqenëse anëtarët e ekipit në kompaninë e Sidorelës punojnë gjithmonë së bashku dhe shpesh e ndihmojnë njëri-tjetrin kur ngarkesa e punës është e lartë dhe kur janë në kufi të afateve kohore, ndoshta do të nevojitet ndihma e nje kolegu tjetër nga ekipi. Prandaj, gjithçka duhet të jetë e kuptueshme edhe për kolegët e ekipit të saj.

Së pari, Sidorela krijon konceptin e programit kompjuterik. Pastaj fillon programimin, duke dokumentuar qartë funksionin e secilës pjesë të programit. Nëse ky modul do të rishikohet më vonë nga një programues tjetër, ai do të varet pikërisht nga kjo.

Nëse Sidorela nuk është e sigurt se si të vazhdojë, ajo kërkon së pari vetë në internet për të gjetur ndonjë zgjidhje në forumet në gjuhën angleze ose shikon video shpjeguese. Nëse ende vazhdon të mos jetë e sigurtë se si të vazhdojë, ajo kërkon këshilla nga kolegët ose mbikëqyrësit e saj.

Pastaj ajo teston çdo pjesë të programit në detaje. Në veçanti, Sidorela teston ndërveprimin e modulit të ri me mjedisin ekzistues të programit. Për këtë ajo punon me kopjet e programit dhe të dhënave të kontabilitetit.

Pasi e perfundon, ajo e prezanton modulin te mbikqyrësi i saj. Meqenëse çdo gjë funksionon në mënyrë të përkryer, ajo lejohet që ta instalojë programin në kompjuterat e klientit.

**Një projekt i Agjencisë Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim SDC**

Schweizerische Eidgenossenschaft
Confédération suisse
Confederazione Svizzera
Confederaziun svizra

Agjencia Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim SDC

**Në partneritet me:**

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E FINANCAVE DHE EKONOMISË

**Zbatuar nga:**

swisscontact

# Programim

# Kërkesat e shkollës

| Kërkesa | e ulët ◂ RËNDËSI ▸ e lartë | Komente |
|---|---|---|
| Matematikë: Puna me numra, forma gjeometrike dhe algjebër. | | Algoritmi, zgjidhja e problemeve, të menduarit logjik. |
| Gjuhë e shkruar (shqip): Përdorimi i gjuhës së shkruar si mjet komunikimi në aktivitetet profesionale. | | |
| Gjuhë e folur (shqip): Përdorimi i gjuhës së folur si mjet komunikimi në aktivitetet profesionale. | | |
| Gjuhë e huaj e shkruar: Përdorimi i gjuhës së huaj të shkruar si mjet komunikimi në aktivitetet profesionale. | | Anglishtja si gjuhë universale e kompjuterit, leximi i gjërave online, puna me programet në gjuhën angleze, komunikimi me ekipet e huaja, dokumentacioni. |
| Gjuhë e huaj e folur: Përdorimi i gjuhës së huaj të folur si mjet komunikimi në aktivitetet profesionale. | | Anglishtja, mësimet në youtube, klientët. |
| Shkencat Natyrore: Aftësitë dhe njohuritë shkencore të nevojshme për të hetuar, zgjidhur problemet, për të marrë vendime, për të mësuar gjatë gjithë jetës, për të drejtuar pyetje dhe për të shuar kuriozitetin e tyre. | | |
| Shoqëria dhe Mjedisi: Kuptimi i proceseve ligjore, politike, ekonomike, sociale, historike, kulturore dhe i çështjeve të ndërlidhura me to. | | |
| Arte: Mësimi, komunikimi, interpretimi dhe zhvillimi i aftësive të tyre artistike për të shprehur veten dhe për të asistuar në ndryshimin artistik dhe kulturore të vetvetes dhe të tjerëve. | | |
| Teknologjia & TIK: Përdorimi i TIK-ut për të kërkuar dhe marrë informacion nga burimet on-line; menaxhimi i projekteve në grupe pune; diskutimi dhe ndarja me të tjerët e gjetjeve të tyre gjatë kërkimit. | | Kërkimi i informacionit, mësimi i teknologjive të reja. |



# Programim

## Kërkesat fizike

| Kërkesa | e ulët ◂ RËNDËSI ▸ e lartë | Komente |
|---|---|---|
| Aftësitë e forta motorike: Përdorimi në shkallë të gjerë dhe të koordinuar i duarve dhe krahëve. | | |
| Aftësitë e buta motorike: Kryerja në masë të vogël e lëvizjeve të koordinuara dhe të kontrolluara të duarve dhe gishtërinjve. | | |
| Forca: Përdorimi i fuqisë muskulore, si afatshkurtër dhe impulsive (p.sh. për ngritjen e një arke të rëndë) ose afatgjatë dhe e vazhdueshme (p.sh. puna me trapan në një sipërfaqe mbi kokë). Përdorimi i zgjatur i fuqisë së muskujve gjatë ngritjes së objekteve, përdorimi i mjeteve/veglave ose ecja, vrapimi. | | |
| Aftësi normale për dallimin e ngjyrave: Aftësia për të dalluar të gjitha ngjyrat saktë | | |
| Shqisa e shijes, aromës: Nuhatja dhe/ ose shijimi, p.sh. kur gatuhet, prodhohen aroma; njohja e rreziqeve (p.sh. rrjedhje gazi, ushqime të prishura). | | |
| Asnjë lloj alergjie / intolerance: Nuk ka alergji / intolerancë ndaj substancave, si ushqime, pëlhura, etj. | | |
| Puna në temperatura dhe kushte të ndryshme atmosferike: Puna në ambiente jashtë, pavarësisht nga kushtet e motit dhe temperatura. | | |



# Programim

# Kompetencat personale dhe sociale

| Kërkesa | e ulët ◂ RËNDËSI ▸ e lartë | Komente |
|---|---|---|
| Qëndrueshmëria emocionale: Menaxhimi i situatave stresuese dhe marrja e masave për të reduktuar stresin në përgjegjësinë e vet. Veprimi i koordinuar dhe i synuar edhe nën presion kohor. |  | Të qenit i stresuar shkakton aksidente. |
| Ritmi i shpejtë ose i pandikueshëm i punës: Puna (ritmi) mund të ndryshojë nga një çast në tjetrin, për shkak të kërkesës spontane dhe urgjente të klientit ose për shkak të ndryshimit dinamik të kushteve të punës. |  | |
| Përqendrim dhe qëndresë e lartë: Përqendrim i lartë në një detyrë që kërkon rezistencë të lartë ndaj shpërqendrimit për një periudhë të zgjatur kohore . |  | |
| Aftësi të forta krijuese dhe aftësi për zgjidhjen e problemeve: Të menduarit për arritjet me qëllim transferimin e një faze aktuale në një fazë të synuar pavarësisht rezistencës e kundërshtive. |  | |
| Fleksibiliteti në lidhje me vendndodhjen e punës: Aftësia për t'u përshtatur shpejt në vende të ndryshme pune në ambiente brenda ose jashtë. |  | |
| Fleksibiliteti në lidhje me orarin e punës: Aftësia për t'u përshtatur me orare të ndryshme pune, të cilat mund të ndryshojnë nga orët standarde të punës, si puna gjatë natës ose herët në mëngjes. |  | |
| Qasje e hapur ndaj personave të tjerë me të cilët kontakton shpesh: Vendosja dhe ruajtja e marrëdhënieve formale, ruajtja e formave të kontaktimit me autoritetet, klientët, partnerët e biznesit, etj. |  | Marrëdhëniet korrekte me mbikëqyrësit dhe kolegët. |
| Kënaqësi nga kontakti i vazhdueshëm, ndjeshmëri, empati: Qasja empatike tek njerëzit e tjerë me qëllim krijimin dhe ruajtjen e marrëdhënieve. Kjo kërkesë është e rëndësishme në shumë shërbime ku kërkohet kontakt i vazhdueshëm me klientët, si shitja, kujdesi estetik, konsultimi, terapia. |  | |
| Aftësi e spikatur për të punuar në ekip për shkak të bashkëpunimit të ngushtë: Bashkëpunimi brenda ekipit, përkatësisht koordinimi ndërmjet anëtarëve të ekipit, supozimi i besueshëm i nëndetyrave, përgjegjësi e përbashkët për arritjen e qëllimeve. |  | Shkëmbimi i ideve brenda ekipit sjell zhvillim. |
| Kompetencat ndërkulturore: Aftësitë njohëse, emocionale dhe të sjelljes që çojnë në komunikim efektiv dhe të përshtatshëm me njerëzit e kulturave të tjera. Ato përfshijnë sjelljet që i përshtaten pritshmërive të një kulture të caktuar, karakteristikat e situatës dhe nivelin e marrëdhënieve midis palëve të përfshira në këtë situatë. Ato gjithashtu marrin parasysh normat e veta kulturore dhe kompromisin më të përshtatshëm dhe më të qetë ndërmjet normave të ndryshme kulturore. |  | |
| Integritet i lartë: Aftësia për të qenë të ndershëm dhe për të patur parime të forta morale, ose ndershmëri morale. Është një zgjedhje personale për të ruajtur standarde të qëndrueshme në sjelljen personale. Në etikë, integriteti konsiderohet si ndershmëria dhe vërtetësia ose saktësia e veprimeve të dikujt. |  | Ndershmëria. |


class="sidebar-toggle">
ss="fa fa-bars"></i>
vbar-collapse collapse" id=
="nav navbar-nav navbar-right">
<button class="navbar-btn">
<div class="btn-alert fa
<div class="alert-top">20
</button>
/li>
<li class="dropdown">
<button class="navbar-btn tab-cm-top"
<img src="images/cm.jpg" class=
<em class="cm-name-top">Nutik
<i class="fa fa-angle-down"></i>
</button>
<ul class="dropdown-menu">
<li>
<a href="patient-01-info-
<i class="fa fa-address-card"
</a>
</li>
<li>
<a href="#">
<i class="fa fa-sign-out"
</a>
</li>
</ul>
</li>

# Zhvillim Faqesh Interneti

Aftësi për Punë / Skills for Jobs



Sot Lorna mori një detyrë të re nga eprori i saj. Një klient ka nevojë për një faqe të re në internet për një platformë sociale. Lorna duhet të krijojë pjesën hyrëse, ku përdoruesit e rinj të platformës mund të krijojnë një llogari të re dhe përdoruesit ekzistues të mund të hyjnë në të. Para se të fillojë programimin ajo duhet të kuptojë logjikën që e shoqëron këtë faqe interneti. Për këtë, ajo e fillon punën me një takim me eprorin e saj dhe një koleg që është përgjegjës për ndërfaqen e përdoruesit. Eprori i shpjegoi se në mënyrë që të regjistrohen në platformë, përdoruesit e rinj duhet së pari të shkruajnë adresën e tyre të postës elektronike. Ata më pas do të marrin një email konfirmimi, përndryshe nuk mund të kenë sukses me regjistrimin dhe përcaktimin e një fjalëkalimi dhe një emri të përdoruesit. Për të kontrolluar gabimet në shkrim përdoruesit duhet të shkruajnë dy herë adresën e tyre elektronike dhe Lorna duhet ta programojë faqen në atë mënyrë që email-i i konfirmimit do të dërgohet vetëm nëse të dyja shënimet janë tërësisht të barabarta. Një mekanizëm i ngjashëm kërkohet edhe për procesin e identifikimit të përdoruesve tashmë ekzistues. Faqja kryesore do të shfaqet, vetëm nëse fjalëkalimi përputhet me emrin e përdoruesit.

Pas takimit, një koleg i tregon për një video të shkurtër por të dobishme në internet në gjuhën angleze, e cila e shpjegon këtë logjikë. Ai ia dërgon lidhjen dhe Lorna e sheh atë video. Si gjithmonë, mendon ajo, është mirë që të merret informacion nga anë të ndryshme sepse të ndihmojnë për të gjetur zgjidhje për probleme të tilla.

Tani ajo ulet në kompjuterin e saj në zyrën e hapur dhe fillon me futjen e kodit të programit. Sot është një ditë e ngarkuar në zyrë për shkak të një afati përfundimtar të një projekti tjetër dhe të gjithë po nxitojnë nëpër zyrë dhe rreth tavolinës së saj. Megjithatë, Lorna është mësuar me këtë dhe është në gjendje të përqëndrohet tek detyra e saj. Kjo është e nevojshme, pasi ajo duhet të jetë shumë e përqendruar. Një gabim i vetëm në shkrim do të bënte që faqja e internetit të mos funksiononte si duhet.

Pak pa e përfunduar, eprori i saj vjen përsëri. Një praktikant tjetër është i sëmurë sot dhe ajo duhet të përfundojë punën e tij të lënë përgjysëm. Klienti i tyre dëshiron një faqe interneti e cila mund të japë vlerësime në lidhje me vlerat tatimore. Në varësi të nivelit të pagave, klientët do të drejtohen drejt faqeve të ndryshme, në varësi të klasës tatimore ku bën pjesë paga e tyre. Kolegu i Lornës gati e ka përfunduar kodin e programimit, kështu që ajo duhet ta kontrollojë me kujdes për gabime dhe të përfundojë rreshtat e fundit që mungojnë. Kolegu i saj ka përdorur një kornizë të re për zhvillimin e kësaj faqeje interneti, kështu që Lorna duhet të shikojë dokumentacionin e kornizës për të kuptuar mekanizmat e brendshme. Korniza përdor disa koncepte të reja abstrakte për të cilat ajo duhet të bëjë kërkime të mëtejshme. Eprori i saj e kujton atë, se afati është sot dhe se ajo duhet të përfundojë programimin sa më shpejt që të jetë e mundur. Lorna ndalon kërkimin e saj, pa gjetur ende ndonjë zgjidhje të fortë. Lorna përqendrohet për 10 minuta për ta rishikuar problemin në një këndvështrim tjetër. Përmes kësaj, ajo e kupton se mund të ofrojë një zgjidhje të mirë në një mënyrë tjetër, që mund të funksionojë po aq mirë. Lorna zbaton zgjidhjen dhe zhvillon programin.


**Një projekt i Agjencisë Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim SDC**

Schweizerische Eidgenossenschaft
Confédération suisse
Confederazione Svizzera
Confederaziun svizra

Agjencia Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim SDC

**Në partneritet me:**

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E FINANCAVE DHE EKONOMISË

**Zbatuar nga:**

swisscontact

# Zhvillim Faqesh Interneti

# Kërkesat e shkollës

| **Kërkesa** | **e ulët – RËNDËSI – e lartë** | **Komente** |
|---|---|---|
| Matematikë: Puna me numra, forma gjeometrike dhe algjebër. | | Algoritmi, zgjidhja e problemeve. |
| Gjuhë e shkruar (shqip): Përdorimi i gjuhës së shkruar si mjet komunikimi në aktivitetet profesionale. | | Shkrimi dhe të kuptuarit e përmbajtjes, komunikimi. |
| Gjuhë e folur (shqip): Përdorimi i gjuhës së folur si mjet komunikimi në aktivitetet profesionale. | | Komunikimi me klientët; komunikimi në hapësirat e të nxënit. |
| Gjuhë e huaj e shkruar: Përdorimi i gjuhës së huaj të shkruar si mjet komunikimi në aktivitetet profesionale. | | Anglishtja si gjuhë universale e kompjuterit, leximi i gjërave online, puna me programet në gjuhën angleze, komunikimi me ekipet e huaja, dokumentacioni. |
| Gjuhë e huaj e folur: Përdorimi i gjuhës së huaj të folur si mjet komunikimi në aktivitetet profesionale. | | Gjuha angleze, mësime në youtube, klientët. |
| Shkencat Natyrore: Aftësitë dhe njohuritë shkencore të nevojshme për të hetuar, zgjidhur problemet, për të marrë vendime, për të mësuar gjatë gjithë jetës, për të drejtuar pyetje dhe për të shuar kuriozitetin e tyre. | | Kuptimi i koncepteve abstrakte; aftësia për të menduar jashtë kornizave, durimi. |
| Shoqëria dhe Mjedisi: Kuptimi i proceseve ligjore, politike, ekonomike, sociale, historike, kulturore dhe i çështjeve të ndërlidhura me to. | | |
| Arte: Mësimi, komunikimi, interpretimi dhe zhvillimi i aftësive të tyre artistike për të shprehur veten dhe për të asistuar në ndryshimin artistik dhe kulturore të vetvetes dhe të tjerëve. | | Si frymëzim për kreativitetin. |
| Teknologjia & TIK: Përdorimi i TIK-ut për të kërkuar dhe marrë informacion nga burimet on-line; menaxhimi i projekteve në grupe pune; diskutimi dhe ndarja me të tjerët e gjetjeve të tyre gjatë kërkimit. | | Kërkimi i informacionit, mësimi i teknologjive të reja. |



# Zhvillim Faqesh Interneti

# Kërkesat fizike

| Kërkesa | e ulët ◂ RËNDËSI ▸ e lartë | Komente |
|---|---|---|
| Aftësitë e forta motorike: Përdorimi në shkallë të gjerë dhe të koordinuar i duarve dhe krahëve. | | |
| Aftësitë e buta motorike: Kryerja në masë të vogël e lëvizjeve të koordinuara dhe të kontrolluara të duarve dhe gishtërinjve. | | Shkrimi në tastierë rrit produktivitetin. |
| Forca: Përdorimi i fuqisë muskulore, si afatshkurtër dhe impulsive (p.sh. për ngritjen e një arke të rëndë) ose afatgjatë dhe e vazhdueshme (p.sh. puna me trapan në një sipërfaqe mbi kokë). Përdorimi i zgjatur i fuqisë së muskujve gjatë ngritjes së objekteve, përdorimi i mjeteve/veglave ose ecja, vrapimi. | | |
| Aftësi normale për dallimin e ngjyrave: Aftësia për të dalluar të gjitha ngjyrat saktë | | Aftësia normale për të dalluar ngjyrat, për dizajn ka ekspertë të UI,organizimi i faqes së internetit, kombinimi i ngjyrave. |
| Shqisa e shijes, aromës: Nuhatja dhe/ ose shijimi, p.sh. kur gatuhet, prodhohen aroma; njohja e rreziqeve (p.sh. rrjedhje gazi, ushqime të prishura). | | |
| Asnjë lloj alergjie / intolerance: Nuk ka alergji / intolerancë ndaj substancave, si ushqime, pëlhura, etj. | | |
| Puna në temperatura dhe kushte të ndryshme atmosferike: Puna në ambiente jashtë, pavarësisht nga kushtet e motit dhe temperatura. | | |



# Kompetencat personale dhe sociale

| Kërkesa | e ulët ◂ RËNDËSI ▸ e lartë | Komente |
|---|---|---|
| Qëndrueshmëria emocionale: Menaxhimi i situatave stresuese dhe marrja e masave për të reduktuar stresin në përgjegjësinë e vet. Veprimi i koordinuar dhe i synuar edhe nën presion kohor. |  | Respektimi i afateve, komunikimi me klientët, detyrat që kërkojnë përgatitje mendore. |
| Ritmi i shpejtë ose i pandikueshëm i punës: Puna (ritmi) mund të ndryshojë nga një çast në tjetrin, për shkak të kërkesës spontane dhe urgjente të klientit ose për shkak të ndryshimit dinamik të kushteve të punës. |  | Projektet kërkojnë ndryshime, mësimi i teknologjive të reja. |
| Përqendrim dhe qëndresë e lartë: Përqendrim i lartë në një detyrë që kërkon rezistencë të lartë ndaj shpërqendrimit për një periudhë të zgjatur kohore . |  | Puna për orë të gjata, përqendrimi, zgjidhja e problemeve, zbatimi kompleks i algoritmeve. |
| Aftësi të forta krijuese dhe aftësi për zgjidhjen e problemeve: Të menduarit për arritjet me qëllim transferimin e një faze aktuale në një fazë të synuar pavarësisht rezistencës e kundërshtive. |  | Të menduarit jashtë kornizave, kontekste pune tejet inovative, përdorimi i teknikave të ndryshme për zgjidhjen e problemeve. |
| Fleksibiliteti në lidhje me vendndodhjen e punës: Aftësia për t'u përshtatur shpejt në vende të ndryshme pune në ambiente brenda ose jashtë. |  | Puna në zyrë dhe puna në shtëpi. |
| Fleksibiliteti në lidhje me orarin e punës: Aftësia për t'u përshtatur me orare të ndryshme pune, të cilat mund të ndryshojnë nga orët standarde të punës, si puna gjatë natës ose herët në mëngjes. |  | Afatet, puna natën. |
| Qasje e hapur ndaj personave të tjerë me të cilët kontakton shpesh: Vendosja dhe ruajtja e marrëdhënieve formale, ruajtja e formave të kontaktimit me autoritetet, klientët, partnerët e biznesit, etj. |  | Diskutimi i kërkesave të projekteve me klientët. |
| Kënaqësi nga kontakti i vazhdueshëm, ndjeshmëri, empati: Qasja empatike tek njerëzit e tjerë me qëllim krijimin dhe ruajtjen e marrëdhënieve. Kjo kërkesë është e rëndësishme në shumë shërbime ku kërkohet kontakt i vazhdueshëm me klientët, si shitja, kujdesi estetik, konsultimi, terapia. |  | Të punosh në ekip, të kuptosh kolegët. |
| Aftësi e spikatur për të punuar në ekip për shkak të bashkëpunimit të ngushtë: Bashkëpunimi brenda ekipit, përkatësisht koordinimi ndërmjet anëtarëve të ekipit, supozimi i besueshëm i nëndetyrave, përgjegjësi e përbashkët për arritjen e qëllimeve. |  | Puna në mënyrë të kuptueshme dhe të gjurmueshme (për kolegët, nëse dikush është i sëmurë), puna në ekip për projekte. |
| Kompetencat ndërkulturore: Aftësitë njohëse, emocionale dhe të sjelljes që çojnë në komunikim efektiv dhe të përshtatshëm me njerëzit e kulturave të tjera. Ato përfshijnë sjelljet që i përshtaten pritshmërive të një kulture të caktuar, karakteristikat e situatës dhe nivelin e marrëdhënieve midis palëve të përfshira në këtë situatë. Ato gjithashtu marrin parasysh normat e veta kulturore dhe kompromisin më të përshtatshëm dhe më të qetë ndërmjet normave të ndryshme kulturore. |  | Puna për kompani të ndryshme, edhe ndërkombëtare. |
| Integritet i lartë: Aftësia për të qenë të ndershëm dhe për të patur parime të forta morale, ose ndershmëri morale. Është një zgjedhje personale për të ruajtur standarde të qëndrueshme në sjelljen personale. Në etikë, integriteti konsiderohet si ndershmëria dhe vërtetësia ose saktësia e veprimeve të dikujt. |  | Ndershmëria dhe integriteti ndaj klientëve. |



# Tregti

Aftësi për Punë / Skills for Jobs



Ana punon në departamentin e veshjeve të femrave në një dyqan të madh mode. Çdo mëngjes ajo së pari sigurohet që të gjitha rrobat të jenë të palosura mirë dhe të renditura sipas masave. Ana njoftohet me telefon se furnizimi i fundit ka disa veshje edhe për departamentin e saj. Kur mbrrijnë mallrat, ajo i kontrollon ato duke përdorur formularin e porosisë. Ajo i hedh mallrat në sistem dhe i ruan në depo. Ana e njofton mbikqyrësin e saj se, ndër të tjera, ka ardhur edhe furnizimi me mallra të koleksionit të ri. Mbikqyrësi i thotë Anës që është e nevojshme të krijohet hapësirë edhe për veshjet e koleksionit të ri, ndaj Ana heq nga rafti disa veshje të koleksionit të vjetër dhe i zëvendëson me veshjet e koleksionit të ri.

Përveç kësaj, Ana dhe mbikqyrësi i saj vendosin se për cilat veshje nga koleksioni i vjetër do të reduktohet çmimi dhe në çfarë përqindje. Ndërsa Ana është duke hequr nga raftet disa veshje nga koleksioni i vjetër, asaj i afrohet një kliente anglisht-folëse. Ajo po kërkon një palë pantallona dhe nuk po arrin të gjejë masën e duhur. Ana bën një vlerësim me sy të gjatësisë së këmbëve të klientes dhe të perimetrit të belit dhe rekomandon në gjuhën angleze ato modele që mund t'i përshtaten më mirë. Klientja gjen shumë shpejt një palë panatallona që janë masa e saj, te cilat i rrinë mirë. Ajo paguan tek arka, përshëndet dhe largohet e lumtur.

Më pas Anës i afrohet një kliente tjetër që kërkon një veshje të përshtatshme për një festë ditëlindje. Ana e pyet atë rreth ngjyrës dhe modelit të dëshiruar por klientja nuk është e qartë në preferencat e saj. Sidoqoftë, Ana kupton që klientja dëshiron që veshjet të jenë cilësore dhe të punuara me kujdes. Prandaj ajo i ofron klientes fustane të ndryshme cilësore dhe i shpjegon edhe deri në ç'masë i përmbushin kërkesat e saj. Klientja provon disa nga prej veshjeve dhe Ana e këshillon në lidhje me ngjyrat dhe prerjet që i përshtaten më mirë. Klientja vendos të marrë një fustan ngjyrë jeshile që i pëlqen shumë. Meqë në dyqan për momentin nuk e kanë atë fustan në masën e dëshiruar, Ana e porosit fustanin në një dyqan tjetër. Klientja e pyet edhe për mënyrën e kujdesjes për fustanin. Ana shikon etiketën dhe i shpjegon klientes mënyrën e larjes së fustanit. Ajo i thotë mirupafshim klientes dhe i vendos në vendin e duhur rrobat që merr nga dhoma e zhveshjes.

Më pas, Ana kontrollon faturat e mallrave në sistem. Ajo sheh që ka një porosi nga një tjetër pikë shitje. Janë porositur një palë pantallona elegante. Ana zgjedh pantallonat dhe i përgatit ato për t'u dërguar në pikën tjetër të shitjes. Ajo vendos emrin dhe adresën e vendit të shitjes dhe emrin e dërguesit dhe i përgatit mallrat për dërgesë. Pastaj ajo kthehet në zonën e shitjeve dhe fillon të rregullojë dhe të sistemojë veshjet.


**Një projekt i Agjencisë Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim SDC**

Schweizerische Eidgenossenschaft
Confédération suisse
Confederazione Svizzera
Confederaziun svizra

Agjencia Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim SDC

**Në partneritet me:**

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E FINANCAVE DHE EKONOMISË

**Zbatuar nga:**

swisscontact

# Tregti

# Kërkesat e shkollës

| Kërkesa | e ulët ◂ RËNDËSI ▸ e lartë | Komente |
|---|---|---|
| Matematikë: Puna me numra, forma gjeometrike dhe algjebër. |  | Llogaritjet e shpejta. |
| Gjuhë e shkruar (shqip): Përdorimi i gjuhës së shkruar si mjet komunikimi në aktivitetet profesionale. |  | Kontakti me klientin; rishikimi i raportit të shitjes. |
| Gjuhë e folur (shqip): Përdorimi i gjuhës së folur si mjet komunikimi në aktivitetet profesionale. |  | Kontakti me klientin. Aftësitë e mira verbale janë gjysma e punës. |
| Gjuhë e huaj e shkruar: Përdorimi i gjuhës së huaj të shkruar si mjet komunikimi në aktivitetet profesionale. |  | Leximi i informacionit për produktet. |
| Gjuhë e huaj e folur: Përdorimi i gjuhës së huaj të folur si mjet komunikimi në aktivitetet profesionale. |  | Klientët e huaj. |
| Shkencat Natyrore: Aftësitë dhe njohuritë shkencore të nevojshme për të hetuar, zgjidhur problemet, për të marrë vendime, për të mësuar gjatë gjithë jetës, për të drejtuar pyetje dhe për të shuar kuriozitetin e tyre. |  | |
| Shoqëria dhe Mjedisi: Kuptimi i proceseve ligjore, politike, ekonomike, sociale, historike, kulturore dhe i çështjeve të ndërlidhura me to. |  | Perceptimi i kulturës së një vendi dhe i mjedisit rrethues. |
| Arte: Mësimi, komunikimi, interpretimi dhe zhvillimi i aftësive të tyre artistike për të shprehur veten dhe për të asistuar në ndryshimin artistik dhe kulturore të vetvetes dhe të tjerëve. |  | Stendat e afishimit, organizimi në rafte. |
| Teknologjia & TIK: Përdorimi i TIK-ut për të kërkuar dhe marrë informacion nga burimet on-line; menaxhimi i projekteve në grupe pune; diskutimi dhe ndarja me të tjerët e gjetjeve të tyre gjatë kërkimit. |  | Arka, PC. |



# Tregti

# Kërkesat fizike

| Kërkesa | e ulët ◂ RËNDËSI ▸ e lartë | Komente |
|---|---|---|
| Aftësitë e forta motorike: Përdorimi në shkallë të gjerë dhe të koordinuar i duarve dhe krahëve. | | |
| Aftësitë e buta motorike: Kryerja në masë të vogël e lëvizjeve të koordinuara dhe të kontrolluara të duarve dhe gishtërinjve. | | |
| Forca: Përdorimi i fuqisë muskulore, si afatshkurtër dhe impulsive (p.sh. për ngritjen e një arke të rëndë) ose afatgjatë dhe e vazhdueshme (p.sh. puna me trapan në një sipërfaqe mbi kokë). Përdorimi i zgjatur i fuqisë së muskujve gjatë ngritjes së objekteve, përdorimi i mjeteve/veglave ose ecja, vrapimi. | | Qëndrimi në këmbë për periudha të gjata. |
| Aftësi normale për dallimin e ngjyrave: Aftësia për të dalluar të gjitha ngjyrat saktë | | Kur shesin p.sh. rroba. |
| Shqisa e shijes, aromës: Nuhatja dhe/ ose shijimi, p.sh. kur gatuhet, prodhohen aroma; njohja e rreziqeve (p.sh. rrjedhje gazi, ushqime të prishura). | | Kur shesin parfume, ushqime dhe pije, etj. |
| Asnjë lloj alergjie / intolerance: Nuk ka alergji / intolerancë ndaj substancave, si ushqime, pëlhura, etj. | | |
| Puna në temperatura dhe kushte të ndryshme atmosferike: Puna në ambiente jashtë, pavarësisht nga kushtet e motit dhe temperatura. | | Gjendja e pikave të shitjes. |



# Tregti

# Kompetencat personale dhe sociale

| Kërkesa | e ulët ◂ RËNDËSI ▸ e lartë | Komente |
|---|---|---|
| Qëndrueshmëria emocionale: Menaxhimi i situatave stresuese dhe marrja e masave për të reduktuar stresin në përgjegjësinë e vet. Veprimi i koordinuar dhe i synuar edhe nën presion kohor. |  | Menaxhimi i situatave tejet stresuese. |
| Ritmi i shpejtë ose i pandikueshëm i punës: Puna (ritmi) mund të ndryshojë nga një çast në tjetrin, për shkak të kërkesës spontane dhe urgjente të klientit ose për shkak të ndryshimit dinamik të kushteve të punës. |  | |
| Përqendrim dhe qëndresë e lartë: Përqendrim i lartë në një detyrë që kërkon rezistencë të lartë ndaj shpërqendrimit për një periudhë të zgjatur kohore . |  | Ndjekja e çdo artikulli dhe lëvizjes së tij. |
| Aftësi të forta krijuese dhe aftësi për zgjidhjen e problemeve: Të menduarit për arritjet me qëllim transferimin e një faze aktuale në një fazë të synuar pavarësisht rezistencës e kundërshtive. |  | |
| Fleksibiliteti në lidhje me vendndodhjen e punës: Aftësia për t'u përshtatur shpejt në vende të ndryshme pune në ambiente brenda ose jashtë. |  | Lëvizja e artikujve mund të çojë në ndryshime në profilin e shitjeve. |
| Fleksibiliteti në lidhje me orarin e punës: Aftësia për t'u përshtatur me orare të ndryshme pune, të cilat mund të ndryshojnë nga orët standarde të punës, si puna gjatë natës ose herët në mëngjes. |  | Orari i hapjes. |
| Qasje e hapur ndaj personave të tjerë me të cilët kontakton shpesh: Vendosja dhe ruajtja e marrëdhënieve formale, ruajtja e formave të kontaktimit me autoritetet, klientët, partnerët e biznesit, etj. |  | Kuptimi i klientit dhe nevojave të tij / saj. |
| Kënaqësi nga kontakti i vazhdueshëm, ndjeshmëri, empati: Qasja empatike tek njerëzit e tjerë me qëllim krijimin dhe ruajtjen e marrëdhënieve. Kjo kërkesë është e rëndësishme në shumë shërbime ku kërkohet kontakt i vazhdueshëm me klientët, si shitja, kujdesi estetik, konsultimi, terapia. |  | Kuptimi i klientit dhe nevojave të tij / saj. |
| Aftësi e spikatur për të punuar në ekip për shkak të bashkëpunimit të ngushtë: Bashkëpunimi brenda ekipit, përkatësisht koordinimi ndërmjet anëtarëve të ekipit, supozimi i besueshëm i nëndetyrave, përgjegjësi e përbashkët për arritjen e qëllimeve. |  | Një nga detyrat kryesore në shitje. |
| Kompetencat ndërkulturore: Aftësitë njohëse, emocionale dhe të sjelljes që çojnë në komunikim efektiv dhe të përshtatshëm me njerëzit e kulturave të tjera. Ato përfshijnë sjelljet që i përshtaten pritshmërive të një kulture të caktuar, karakteristikat e situatës dhe nivelin e marrëdhënieve midis palëve të përfshira në këtë situatë. Ato gjithashtu marrin parasysh normat e veta kulturore dhe kompromisin më të përshtatshëm dhe më të qetë ndërmjet normave të ndryshme kulturore. |  | Klientët me prejardhje të ndryshme dhe nga vende të tjera. |
| Integritet i lartë: Aftësia për të qenë të ndershëm dhe për të patur parime të forta morale, ose ndershmëri morale. Është një zgjedhje personale për të ruajtur standarde të qëndrueshme në sjelljen personale. Në etikë, integriteti konsiderohet si ndershmëria dhe vërtetësia ose saktësia e veprimeve të dikujt. |  | Ndershmëria dhe integriteti ndaj klientëve dhe punëdhënësit. |



# Konstruksione Metalike

Aftësi për Punë / Skills for Jobs



Denisi bëhet gati të punojë mbi porosinë e fundit. Para pak orësh, ai ishte bashkë me përgjegjësin e tij në një vilë të porsa ndërtuar. Klienti, pronari i vilës, dëshironte të vendoste dritare me material duralumini dhe një derë të jashtme metalike. Përgjegjësi i shpjegoi Denisit se cilat materiale dhe profile metalike duhet të përdoren, ndërsa Denisi e dëgjoi me vëmendje dhe shtroi pyetje kur nuk kuptoi diçka. Më pas, ata bënë matjet dhe mbajtën shënim përmasat e dritareve dhe të derës. Gjithashtu, Denisi bëri një skicë të thjeshtë dhe pasi mori aprovimin e klientit, u kthye bashkë me përgjegjësin në punishten ku ata punojnë.

Denisi ka besim që mund t'a mbarojë porosinë me vetëm pak ndihmë nga përgjegjësi i tij. Ai ka bërë gati të gjitha veglat e punës dhe ambjentin e nevojshëm në punishte, nderkohë që ka marrë të gjitha masat e sigurisë. Duke u bazuar te skica, ai përcakton llojet e materialeve që nevojiten dhe sasinë e tyre. Më pas, Denisi planifikon procesin teknologjik dhe makinat dhe pajisjet ndihmëse për realizimin e dritareve dhe të derës së jashtme. Pasi merr në magazinë materialet e nevojshme, ai është gati të fillojë punën.

Denisi e di që klienti dhe përgjegjësi i tij kërkojnë punë cilësore, ndaj ai tregon kujdes të veçantë kur bën matjet dhe vendos shënimet, përpara se të realizojë prerjen dhe shpimin e metaleve. Ai diskuton për punën që ka bërë deri më tani me përgjegjësin e tij, i cili është i kënaqur me rezultatin e arritur. Denisi vijon të realizojë sipas planit, prerjet, shpimet, saldimet dhe montimet e konstruksioneve metalike. Denisi ka mësuar mirë si të përdorë makinat metal punuese dhe pajisjet e tjera ndihmëse. Për këtë arsye ai nuk lodhet shumë për të ndërtuar dritaret e duraluminit. Përgjegjësi i vjen në ndihmë për ndërtimin e derës së jashtme. Së bashku ata punojnë për të salduar dhe për të montuar pjesët përbërëse të derës.

Po afrohet orari i mbylljes së punishtes. Denisi e ka mbaruar punën më shpejt nga ç'kishte parashikuar. Ai bën një kontroll të fundit, për t'u siguruar që gjithçka është bërë siç duhet. Pastaj, ai paketon të gjitha dritaret e duraluminit, që ato të mos pësojnë dëmtime gjatë transportit. Në fund, ai bën përllogaritjen e kostos dhe bën gati faturën për klientin. Nesër, Denisi do të dërgojë porosinë të klienti dhe do të ndihmojë për montimin e dritareve dhe të derës metalike.

**Një projekt i Agjencisë Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim SDC**

Schweizerische Eidgenossenschaft
Confédération suisse
Confederazione Svizzera
Confederaziun svizra

Agjencia Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim SDC

**Në partneritet me:**

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E FINANCAVE DHE EKONOMISË

**Zbatuar nga:**

swisscontact

# Konstruksione Metalike

# Njohuri në lëndët mësimore

| **Kërkesa** | **e ulët ◂ RËNDËSI ▸ e lartë** | **Komente** |
|---|---|---|
| Matematikë: Puna me numra, forma gjeometrike dhe algjebër. | | Kryesisht në gjeometri, për llogaritjen e sipërfaqeve, volumeve etj dhe për vizatimin teknik. |
| Gjuhë e shkruar (shqip): Përdorimi i gjuhës së shkruar si mjet komunikimi në aktivitetet profesionale. | | Për plotësimin dhe përgatitjen e raporteve të inspektimit |
| Gjuhë e folur (shqip): Përdorimi i gjuhës së folur si mjet komunikimi në aktivitetet profesionale. | | Përdorimi i gjuhës dhe fjalorit teknik |
| Gjuhë e huaj e shkruar: Përdorimi i gjuhës së huaj të shkruar si mjet komunikimi në aktivitetet profesionale. | | |
| Gjuhë e huaj e folur: Përdorimi i gjuhës së huaj të folur si mjet komunikimi në aktivitetet profesionale. | | |
| Shkencat Natyrore: Aftësitë dhe njohuritë shkencore të nevojshme për të hetuar, zgjidhur problemet, për të marrë vendime, për të mësuar gjatë gjithë jetës, për të drejtuar pyetje dhe për të shuar kuriozitetin e tyre. | | |
| Shoqëria dhe Mjedisi: Kuptimi i proceseve ligjore, politike, ekonomike, sociale, historike, kulturore dhe i çështjeve të ndërlidhura me to. | | |
| Arte: Mësimi, komunikimi, interpretimi dhe zhvillimi i aftësive të tyre artistike për të shprehur veten dhe për të asistuar në ndryshimin artistik dhe kulturore të vetvetes dhe të tjerëve. | | |
| Teknologjia & TIK: Përdorimi i TIK-ut për të kërkuar dhe marrë informacion nga burimet on-line; menaxhimi i projekteve në grupe pune; diskutimi dhe ndarja me të tjerët e gjetjeve të tyre gjatë kërkimit. | | Përdorimi i aplikacioneve të thjeshta për plotësimin e raporteve teknike dhe skicimin e produktit. |



# Konstruksione Metalike

# Kërkesat fizike

| Kërkesa | e ulët ◂ RËNDËSI ▸ e lartë | Komente |
|---|---|---|
| Aftësitë e forta motorike: Përdorimi në shkallë të gjerë dhe të koordinuar i duarve dhe krahëve. | | |
| Aftësitë e buta motorike: Kryerja në masë të vogël e lëvizjeve të koordinuara dhe të kontrolluara të duarve dhe gishtërinjve. | | |
| Forca: Përdorimi i fuqisë muskulore, si afatshkurtër dhe impulsive (p.sh. për ngritjen e një arke të rëndë) ose afatgjatë dhe e vazhdueshme (p.sh. puna me trapan në një sipërfaqe mbi kokë). Përdorimi i zgjatur i fuqisë së muskujve gjatë ngritjes së objekteve, përdorimi i mjeteve/veglave ose ecja, vrapimi. | | |
| Aftësi normale për dallimin e ngjyrave: Aftësia për të dalluar të gjitha ngjyrat saktë | | Përdorimi i ngjyrave për përcaktimin e elementeve në strukturë. |
| Shqisa e shijes, aromës: Nuhatja dhe/ ose shijimi, p.sh. kur gatuhet, prodhohen aroma; njohja e rreziqeve (p.sh. rrjedhje gazi, ushqime të prishura). | | Identifikimi i rrjedhjes së gazit, në rast përdorimi për përpunimin e metaleve. |
| Asnjë lloj alergjie / intolerance: Nuk ka alergji / intolerancë ndaj substancave, si ushqime, pëlhura, etj. | | |
| Puna në temperatura dhe kushte të ndryshme atmosferike: Puna në ambiente jashtë, pavarësisht nga kushtet e motit dhe temperatura. | | |



# Kompetencat personale dhe sociale

| Kërkesa | e ulët ◂ RËNDËSI ▸ e lartë | Komente |
|---|---|---|
| Qëndrueshmëria emocionale: Menaxhimi i situatave stresuese dhe marrja e masave për të reduktuar stresin në përgjegjësinë e vet. Veprimi i koordinuar dhe i synuar edhe nën presion kohor. | | E rëndësishme për realizimin e produktit të kërkuar sipas kërkesave. |
| Ritmi i shpejtë ose i pandikueshëm i punës: Puna (ritmi) mund të ndryshojë nga një çast në tjetrin, për shkak të kërkesës spontane dhe urgjente të klientit ose për shkak të ndryshimit dinamik të kushteve të punës. | | Realizimi në kohë i produktit sipas grafikut dhe përshtatja e shpejtë nëse ka ndryshime ose gabime gjatë procesit të punës. |
| Përqendrim dhe qëndresë e lartë: Përqendrim i lartë në një detyrë që kërkon rezistencë të lartë ndaj shpërqendrimit për një periudhë të zgjatur kohore . | | |
| Aftësi të forta krijuese dhe aftësi për zgjidhjen e problemeve: Të menduarit për arritjet me qëllim transferimin e një faze aktuale në një fazë të synuar pavarësisht rezistencës e kundërshtive. | | Gjatë implementimit të projektit ka nevojë për përshtatje apo zgjidhje alternative, por pa ndryshuar anën funksionale të produktit. |
| Fleksibiliteti në lidhje me vendndodhjen e punës: Aftësia për t'u përshtatur shpejt në vende të ndryshme pune në ambiente brenda ose jashtë. | | |
| Fleksibiliteti në lidhje me orarin e punës: Aftësia për t'u përshtatur me orare të ndryshme pune, të cilat mund të ndryshojnë nga orët standarde të punës, si puna gjatë natës ose herët në mëngjes. | | |
| Qasje e hapur ndaj personave të tjerë me të cilët kontakton shpesh: Vendosja dhe ruajtja e marrëdhënieve formale, ruajtja e formave të kontaktimit me autoritetet, klientët, partnerët e biznesit, etj. | | |
| Kënaqësi nga kontakti i vazhdueshëm, ndjeshmëri/empati: Qasja empatike tek njerëzit e tjerë me qëllim krijimin dhe ruajtjen e marrëdhënieve. Kjo kërkesë është e rëndësishme në shumë shërbime ku kërkohet kontakt i vazhdueshëm me klientët, si shitja, kujdesi estetik, konsultimi, terapia. | | |
| Aftësi e spikatur për të punuar në ekip për shkak të bashkëpunimit të ngushtë: Bashkëpunimi brenda ekipit, përkatësisht koordinimi ndërmjet anëtarëve të ekipit, supozimi i besueshëm i nëndetyrave, përgjegjësi e përbashkët për arritjen e qëllimeve. | | Realizimi i produkteve bëhet në grupe pune të strukturuara, ndaj të punuarit në grup është shumë i rëndësishëm. |
| Kompetencat ndërkulturore: Aftësitë njohëse, emocionale dhe të sjelljes që çojnë në komunikim efektiv dhe të përshtatshëm me njerëzit e kulturave të tjera. Ato përfshijnë sjelljet që i përshtaten pritshmërive të një kulture të caktuar, karakteristikat e situatës dhe nivelin e marrëdhënieve midis palëve të përfshira në këtë situatë. Ato gjithashtu marrin parasysh normat e veta kulturore dhe kompromisin më të përshtatshëm dhe më të qetë ndërmjet normave të ndryshme kulturore. | | |
| Integritet i lartë: Aftësia për të qenë të ndershëm dhe për të patur parime të forta morale, ose ndershmëri morale. Është një zgjedhje personale për të ruajtur standarde të qëndrueshme në sjelljen personale. Në etikë, integriteti konsiderohet si ndershmëria dhe vërtetësia ose saktësia e veprimeve të dikujt. | | |



# Makina Metalpunuese



Kledi është tornitor në një repart metalpunues, ku realizohet i gjithë procesi i prodhimit të një detali. Reparti është i organizuar me të gjitha makinat e nevojshme metalpunuese dhe pajisje të tjera ndihmëse. Kledi përkujdeset dhe mirëmban veglat e punës, pajisjet dhe makinat metalpunuese, ashtu sikurse edhe ambjentin e punës. Ai tregohet gjithmonë i vemendshëm në zbatimin e rregullave të punës, standarteve të sigurisë dhe rregullave të mbrojtjes së mjedisit.

Mbikqyrësi i tij, i cili është inxhinier mekanik, i dorëzon porosinë e rradhës, e cila duhet të jetë gati brenda katër orëve. Kledi duhet të ndërtojë një detal të njëjtë me detalin e dëmtuar, që i dorëzoi inxhinieri. Nderkohë që bën matje të detalit, ai skicon detalin me kujdes duke përdorur përmasat e duhura. Skicimi i saktë i detalit është proces shumë i rëndësishëm, ndaj Kledi i kushton shumë vemendje dhe nuk nxitohet. Pasi mbaron skicën, ai konsultohet me inxhinierin, i cili e udhëzon për hapat e rradhës.

Kledi përzgjedh materialin metalik dhe mjetet e punës dhe fillon procesin sipas skicës. Hapi i parë realizohet me ndihmën e makinës tornuese. Punimi i metalit në makinën tornuese kërkon kohë të konsiderueshme, ndaj Kledi duhet të tregohet i duruar dhe të bëjë kujdes që prerjet të realizohen mirë. Herë pas here, ai e ndërpren procesin për të bërë kontrollin e përmasave, rrjedhimisht për t'i qëndruar korrekt zbatimit me përpikmëri të skicës. Hap pas hapi, detali merr formën e duhur, njëlloj me detalin e dëmtuar që kishte sjellë inxhinieri. Kledi është i kënaqur me punën e tij, që është pothuajse e përfunduar.

Për të përmbyllur procesin e punimit të detalit, Kledi duhet të përdorë makinën retifikuese. Nëpërmjet retifikimit, ai ka mundësi të punojë detajet e vështira që s'mund të arrihen gjatë përdorimit të makinës tornuese. Në këtë mënyrë, Kledi e përfundon detalin me cilësi të lartë dhe është gati t'ia dorëzojë inxhinierit. Inxhinieri surprizohet me punën e shkëlqyer të Kledit dhe që ai arriti të përfundojë detalin më shpejt se afati i caktuar. Ai ka besim se Kledi do të fitojë titullin "Punonjësi i muajit" këtë herë.

**Një projekt i Agjencisë Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim SDC**

Schweizerische Eidgenossenschaft
Confédération suisse
Confederazione Svizzera
Confederaziun svizra

Agjencia Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim SDC

**Në partneritet me:**

Republika e Shqipërisë
Ministria e Financave dhe Ekonomisë

**Zbatuar nga:**

swisscontact

# Makina Metalpunuese

# Njohuri në lëndët mësimore

| Kërkesa | e ulët ◂ RËNDËSI ▸ e lartë | Komente |
|---|---|---|
| Matematikë: Puna me numra, forma gjeometrike dhe algjebër. | | E rëndësishme për skicimin e detaleve që do të prodhohen. Ndaj, matematika dhe gjeometria kanë rëndësi për arritjen e një skice me përmasat e sakta. |
| Gjuhë e shkruar (shqip): Përdorimi i gjuhës së shkruar si mjet komunikimi në aktivitetet profesionale. | | |
| Gjuhë e folur (shqip): Përdorimi i gjuhës së folur si mjet komunikimi në aktivitetet profesionale. | | |
| Gjuhë e huaj e shkruar: Përdorimi i gjuhës së huaj të shkruar si mjet komunikimi në aktivitetet profesionale. | | |
| Gjuhë e huaj e folur: Përdorimi i gjuhës së huaj të folur si mjet komunikimi në aktivitetet profesionale. | | |
| Shkencat Natyrore: Aftësitë dhe njohuritë shkencore të nevojshme për të hetuar, zgjidhur problemet, për të marrë vendime, për të mësuar gjatë gjithë jetës, për të drejtuar pyetje dhe për të shuar kuriozitetin e tyre. | | |
| Shoqëria dhe Mjedisi: Kuptimi i proceseve ligjore, politike, ekonomike, sociale, historike, kulturore dhe i çështjeve të ndërlidhura me to. | | |
| Arte: Mësimi, komunikimi, interpretimi dhe zhvillimi i aftësive të tyre artistike për të shprehur veten dhe për të asistuar në ndryshimin artistik dhe kulturore të vetvetes dhe të tjerëve. | | |
| Teknologjia & TIK: Përdorimi i TIK-ut për të kërkuar dhe marrë informacion nga burimet on-line; menaxhimi i projekteve në grupe pune; diskutimi dhe ndarja me të tjerët e gjetjeve të tyre gjatë kërkimit. | | Për kërkim në internet të informacionit të nevojshem për të përfunduar një projekt sipas specifikimeve të kërkuara. |



# Makina Metalpunuese

# Kërkesat fizike

| Kërkesa | e ulët ◂ RËNDËSI ▸ e lartë | Komente |
|---|---|---|
| Aftësitë e forta motorike: Përdorimi në shkallë të gjerë dhe të koordinuar i duarve dhe krahëve. | | Përdorimi i makinave metal punuese kërkon ushtrimin e forcës nga duart dhe krahët. |
| Aftësitë e buta motorike: Kryerja në masë të vogël e lëvizjeve të koordinuara dhe të kontrolluara të duarve dhe gishtërinjve. | | |
| Forca: Përdorimi i fuqisë muskulore, si afatshkurtër dhe impulsive (p.sh. për ngritjen e një arke të rëndë) ose afatgjatë dhe e vazhdueshme (p.sh. puna me trapan në një sipërfaqe mbi kokë). Përdorimi i zgjatur i fuqisë së muskujve gjatë ngritjes së objekteve, përdorimi i mjeteve/veglave ose ecja, vrapimi. | | Forca kërkohet për të arritur proceset e ndryshme si:. Tornim, shpim, kthim i faqeve metalike etj. Në disa raste, forca e nevojshme është më e vogël, pasi përdoren makina metal punuese automatike. |
| Aftësi normale për dallimin e ngjyrave: Aftësia për të dalluar të gjitha ngjyrat saktë | | |
| Shqisa e shijes, aromës: Nuhatja dhe/ ose shijimi, p.sh. kur gatuhet, prodhohen aroma; njohja e rreziqeve (p.sh. rrjedhje gazi, ushqime të prishura). | | |
| Asnjë lloj alergjie / intolerance: Nuk ka alergji / intolerancë ndaj substancave, si ushqime, pëlhura, etj. | | |
| Puna në temperatura dhe kushte të ndryshme atmosferike: Puna në ambiente jashtë, pavarësisht nga kushtet e motit dhe temperatura. | | |



# Makina Metalpunuese

# Kompetencat personale dhe sociale

| Kërkesa | e ulët ◂ RËNDËSI ▸ e lartë | Komente |
|---|---|---|
| Qëndrueshmëria emocionale: Menaxhimi i situatave stresuese dhe marrja e masave për të reduktuar stresin në përgjegjësinë e vet. Veprimi i koordinuar dhe i synuar edhe nën presion kohor. |  | Makinat metal punuese ushtrojnë fuqi të madhe, ndaj të punuarit në stres apo me veprime të pa koordinuara mund të jetë shkak për demtime deri në rrezik për jetën. |
| Ritmi i shpejtë ose i pandikueshëm i punës: Puna (ritmi) mund të ndryshojë nga një çast në tjetrin, për shkak të kërkesës spontane dhe urgjente të klientit ose për shkak të ndryshimit dinamik të kushteve të punës. |  | Në varësi të kërkesës, për t'iu përgjigjur llojeve dhe sasive të ndryshme të prodhimit, nevojitet një ritëm i shpejtë dhe i pa ndikueshëm. |
| Përqendrim dhe qëndresë e lartë: Përqendrim i lartë në një detyrë që kërkon rezistencë të lartë ndaj shpërqendrimit për një periudhë të zgjatur kohore . |  | Duke qenë se kërkohet një zbatim rigoroz i skicës ose I projektit për të krijuar produktin e saktë, nevojitet nje përqëndrim i lartë. Gabimet mund të jenë të kushtueshme financiarisht. |
| Aftësi të forta krijuese dhe aftësi për zgjidhjen e problemeve: Të menduarit për arritjet me qëllim transferimin e një faze aktuale në një fazë të synuar pavarësisht rezistencës e kundërshtive. |  | |
| Fleksibiliteti në lidhje me vendndodhjen e punës: Aftësia për t'u përshtatur shpejt në vende të ndryshme pune në ambiente brenda ose jashtë. |  | Makinat metal punuese janë të llojeve dhe të përmasave të ndryshme dhe vendosen në ambjente të ndryshme pune. |
| Fleksibiliteti në lidhje me orarin e punës: Aftësia për t'u përshtatur me orare të ndryshme pune, të cilat mund të ndryshojnë nga orët standarde të punës, si puna gjatë natës ose herët në mëngjes. |  | Në shumë raste, nevojitet shumë kohë për të prodhuar një produkt të caktuar. Ndërkohë, mund të ketë urgjenca për prodhimin e produkteve të shumëllojshme. |
| Qasje e hapur ndaj personave të tjerë me të cilët kontakton shpesh: Vendosja dhe ruajtja e marrëdhënieve formale, ruajtja e formave të kontaktimit me autoritetet, klientët, partnerët e biznesit, etj. |  | |
| Kënaqësi nga kontakti i vazhdueshëm, ndjeshmëri/ empati: Qasja empatike tek njerëzit e tjerë me qëllim krijimin dhe ruajtjen e marrëdhënieve. Kjo kërkesë është e rëndësishme në shumë shërbime ku kërkohet kontakt i vazhdueshëm me klientët, si shitja, kujdesi estetik, konsultimi, terapia. |  | |
| Aftësi e spikatur për të punuar në ekip për shkak të bashkëpunimit të ngushtë: Bashkëpunimi brenda ekipit, përkatësisht koordinimi ndërmjet anëtarëve të ekipit, supozimi i besueshëm i nëndetyrave, përgjegjësi e përbashkët për arritjen e qëllimeve. |  | Sepse produkti i kërkuar mund të jetë produkt i cili krijohet nga disa pjesë përbërëse ose nga përdorimi i disa llojeve të makinave metal punuese, për të cilat nevojitet ndihma dhe puna e kolegëve të tjerë. Në këtë mënyrë bashkërendohen veprimet dhe formohet një ekip pune. |
| Kompetencat ndërkulturore: Aftësitë njohëse, emocionale dhe të sjelljes që çojnë në komunikim efektiv dhe të përshtatshëm me njerëzit e kulturave të tjera. Ato përfshijnë sjelljet që i përshtaten pritshmërive të një kulture të caktuar, karakteristikat e situatës dhe nivelin e marrëdhënieve midis palëve të përfshira në këtë situatë. Ato gjithashtu marrin parasysh normat e veta kulturore dhe kompromisin më të përshtatshëm dhe më të qetë ndërmjet normave të ndryshme kulturore. |  | |
| Integritet i lartë: Aftësia për të qenë të ndershëm dhe për të patur parime të forta morale, ose ndershmëri morale. Është një zgjedhje personale për të ruajtur standarde të qëndrueshme në sjelljen personale. Në etikë, integriteti konsiderohet si ndershmëria dhe vërtetësia ose saktësia e veprimeve të dikujt. |  | E nevojshme për të pasur një bashkëpunim të denjë me profesionistë të tjerë, kolegë dhe klientë. |



# Teknologjia e Përpunimit të Metaleve



Martini punon në një punishte ku prodhohen produkte të shumëllojshme nga metale të ndryshëm. Më parë, Martini kryente praktikën profesionale te kjo punishte, gjatë kohës që ndiqte shkollën profesionale. Atij i pëlqente shumë ambjenti i punës dhe komunikimi me supervizorin e tij, ndaj, pasi mbaroi shkollën, u punësua menjëherë në punishte.

Gjatë një dite pune, supervizori e njofton Martinin që sëbashku do të vizitojnë ambjentin e një vile. Martini merr me vete disa vegla të nevojshme, siç janë veglat matëse, tabakët e letrës për skicim, shënuesit dhe të tjera vegla të nevojshme. Sapo arrijnë, takojnë klientin (pronarin e vilës), i cili dëshiron të ndërtojë kangjella për shkallët kryesore dhe një gardh për kopështin rreth vilës. Vila është shumë moderne, ndaj kangjella dhe gardhi duhet të përshtaten mirë me arkitekturën e vilës.

Martini bën matjet e nevojshme të shkallës dhe të perimetrit të kopështit dhe mban shënime në bllokun e tij. Ai fillon të vizatojë dhe të skicojë modelin e kangjellës dhe të gardhit, ndërsa supervizori e ndjek dhe e ndihmon. Pasi mbarojnë skicën me përmasat e duhura, ata pyesin klientin nëse është siç ai e dëshiron. Klienti është shumë i kënaqur me vizatimin e Martinit dhe kërkon të dijë koston totale. Martini diskuton me supervizorin dhe përllogarit koston, e më pas ia komunikon klientit. Klienti pranon dhe Martini kthehet në punishte bashkë me supervizorin.

Në punishte, Martini vesh uniformën e tij, dorezat dhe maskën mbrojtëse. Ai përgatit veglat dhe mjetet e punës, e më pas planifikon të gjithë procesin teknologjik që do të ndiqet për ndërtimin e kangjellës dhe të gardhit metalik. Pasi përzgjedh metalin e duhur, ai realizon prerjen, shpimin dhe kthimin e shufrave metalike, duke përdorur pajisjet dhe makinat metalpunuese. Ai i jep formën e duhur metalit, duke u bazuar në skicën e vizatuar dhe më pas saldon pjesët metalike dhe i monton për të krijuar produktin e kërkuar.

Martini njofton supervizorin që kangjella dhe gardhi janë ndërtuar. Supervizori e përgëzon për punën e mirë dhe i kërkon Martinit që ai t'a ndihmojë për të lyer kangjellën dhe gardhin me bojë me ngjyrë të bardhë.

Një projekt i Agjencisë Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim SDC

Schweizerische Eidgenossenschaft
Confédération suisse
Confederazione Svizzera
Confederaziun svizra

Agjencia Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim SDC

Në partneritet me:

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E FINANCAVE DHE EKONOMISË

Zbatuar nga:

swisscontact

# Teknologjia e Përpunimit të Metaleve

# Njohuri në lëndët mësimore

| Kërkesa | e ulët ◂ RËNDËSI ▸ e lartë | Komente |
|---|---|---|
| Matematikë: Puna me numra, forma gjeometrike dhe algjebër. | | Për kryerjen e vizatimeve dhe skicave të punës për përgatitjen e konstruksioneve metalike |
| Gjuhë e shkruar (shqip): Përdorimi i gjuhës së shkruar si mjet komunikimi në aktivitetet profesionale. | | |
| Gjuhë e folur (shqip): Përdorimi i gjuhës së folur si mjet komunikimi në aktivitetet profesionale. | | |
| Gjuhë e huaj e shkruar: Përdorimi i gjuhës së huaj të shkruar si mjet komunikimi në aktivitetet profesionale. | | |
| Gjuhë e huaj e folur: Përdorimi i gjuhës së huaj të folur si mjet komunikimi në aktivitetet profesionale. | | |
| Shkencat Natyrore: Aftësitë dhe njohuritë shkencore të nevojshme për të hetuar, zgjidhur problemet, për të marrë vendime, për të mësuar gjatë gjithë jetës, për të drejtuar pyetje dhe për të shuar kuriozitetin e tyre. | | |
| Shoqëria dhe Mjedisi: Kuptimi i proceseve ligjore, politike, ekonomike, sociale, historike, kulturore dhe i çështjeve të ndërlidhura me to. | | |
| Arte: Mësimi, komunikimi, interpretimi dhe zhvillimi i aftësive të tyre artistike për të shprehur veten dhe për të asistuar në ndryshimin artistik dhe kulturore të vetvetes dhe të tjerëve. | | |
| Teknologjia & TIK: Përdorimi i TIK-ut për të kërkuar dhe marrë informacion nga burimet on-line; menaxhimi i projekteve në grupe pune; diskutimi dhe ndarja me të tjerët e gjetjeve të tyre gjatë kërkimit. | | Për kërkim në internet të informacionit të nevojshem për të përfunduar një projekt sipas specifikimeve të kërkuara. |



# Teknologjia e Përpunimit të Metaleve

# Kërkesat fizike

| Kërkesa | e ulët ◂ RËNDËSI ▸ e lartë | Komente |
|---|---|---|
| Aftësitë e forta motorike: Përdorimi në shkallë të gjerë dhe të koordinuar i duarve dhe krahëve. | | Për kryerjen e punimeve të prerjes, shpimit, kthimit, saldimit, montimit etj |
| Aftësitë e buta motorike: Kryerja në masë të vogël e lëvizjeve të koordinuara dhe të kontrolluara të duarve dhe gishtërinjve. | | |
| Forca: Përdorimi i fuqisë muskulore, si afatshkurtër dhe impulsive (p.sh. për ngritjen e një arke të rëndë) ose afatgjatë dhe e vazhdueshme (p.sh. puna me trapan në një sipërfaqe mbi kokë). Përdorimi i zgjatur i fuqisë së muskujve gjatë ngritjes së objekteve, përdorimi i mjeteve/veglave ose ecja, vrapimi. | | Gjatë kryerjes së punimeve të prerjes, shpimit, kthimit, saldimit, montimit etj |
| Aftësi normale për dallimin e ngjyrave: Aftësia për të dalluar të gjitha ngjyrat saktë | | |
| Shqisa e shijes, aromës: Nuhatja dhe/ ose shijimi, p.sh. kur gatuhet, prodhohen aroma; njohja e rreziqeve (p.sh. rrjedhje gazi, ushqime të prishura). | | |
| Asnjë lloj alergjie / intolerance: Nuk ka alergji / intolerancë ndaj substancave, si ushqime, pëlhura, etj. | | |
| Puna në temperatura dhe kushte të ndryshme atmosferike: Puna në ambiente jashtë, pavarësisht nga kushtet e motit dhe temperatura. | | |



# Teknologjia e Përpunimit të Metaleve

# Kompetencat personale dhe sociale

| **Kërkesa** | **e ulët ◂ RËNDËSI ▸ e lartë** | **Komente** |
|---|---|---|
| Qëndrueshmëria emocionale: Menaxhimi i situatave stresuese dhe marrja e masave për të reduktuar stresin në përgjegjësinë e vet. Veprimi i koordinuar dhe i synuar edhe nën presion kohor. |  | Për të mos u ndikuar gjatë përdorimit të makinave dhe pajisjeve dhe për të përfunduar procesin me sukses. Në rast gabimesh mund të jetë e nevojshme të rifillohet puna dhe kjo rezulton në vonesa të konsiderueshme. |
| Ritmi i shpejtë ose i pandikueshëm i punës: Puna (ritmi) mund të ndryshojë nga një çast në tjetrin, për shkak të kërkesës spontane dhe urgjente të klientit ose për shkak të ndryshimit dinamik të kushteve të punës. |  | |
| Përqendrim dhe qëndresë e lartë: Përqendrim i lartë në një detyrë që kërkon rezistencë të lartë ndaj shpërqendrimit për një periudhë të zgjatur kohore . |  | Për realizimin e produktit sipas planit dhe skicës |
| Aftësi të forta krijuese dhe aftësi për zgjidhjen e problemeve: Të menduarit për arritjet me qëllim transferimin e një faze aktuale në një fazë të synuar pavarësisht rezistencës e kundërshtive. |  | |
| Fleksibiliteti në lidhje me vendndodhjen e punës: Aftësia për t'u përshtatur shpejt në vende të ndryshme pune në ambiente brenda ose jashtë. |  | |
| Fleksibiliteti në lidhje me orarin e punës: Aftësia për t'u përshtatur me orare të ndryshme pune, të cilat mund të ndryshojnë nga orët standarde të punës, si puna gjatë natës ose herët në mëngjes. |  | Në shumë raste, nevojitet shumë kohë për të prodhuar një produkt të caktuar. Ndërkohë, mund të ketë urgjenca për prodhimin e produkteve të shumëllojshme. |
| Qasje e hapur ndaj personave të tjerë me të cilët kontakton shpesh: Vendosja dhe ruajtja e marrëdhënieve formale, ruajtja e formave të kontaktimit me autoritetet, klientët, partnerët e biznesit, etj. |  | |
| Kënaqësi nga kontakti i vazhdueshëm, ndjeshmëri/ empati: Qasja empatike tek njerëzit e tjerë me qëllim krijimin dhe ruajtjen e marrëdhënieve. Kjo kërkesë është e rëndësishme në shumë shërbime ku kërkohet kontakt i vazhdueshëm me klientët, si shitja, kujdesi estetik, konsultimi, terapia. |  | |
| Aftësi e spikatur për të punuar në ekip për shkak të bashkëpunimit të ngushtë: Bashkëpunimi brenda ekipit, përkatësisht koordinimi ndërmjet anëtarëve të ekipit, supozimi i besueshëm i nëndetyrave, përgjegjësi e përbashkët për arritjen e qëllimeve. |  | Sepse produkti i kërkuar mund të jetë produkt i cili krijohet nga disa pjesë përbërëse ose nga përdorimi i disa llojeve të makinave metal punuese, për të cilat nevojitet ndihma dhe puna e kolegëve të tjerë. Në këtë mënyrë bashkërendohen veprimet dhe formohet një ekip pune. |
| Kompetencat ndërkulturore: Aftësitë njohëse, emocionale dhe të sjelljes që çojnë në komunikim efektiv dhe të përshtatshëm me njerëzit e kulturave të tjera. Ato përfshijnë sjelljet që i përshtaten pritshmërive të një kulture të caktuar, karakteristikat e situatës dhe nivelin e marrëdhënieve midis palëve të përfshira në këtë situatë. Ato gjithashtu marrin parasysh normat e veta kulturore dhe kompromisin më të përshtatshëm dhe më të qetë ndërmjet normave të ndryshme kulturore. |  | |
| Integritet i lartë: Aftësia për të qenë të ndershëm dhe për të patur parime të forta morale, ose ndershmëri morale. Është një zgjedhje personale për të ruajtur standarde të qëndrueshme në sjelljen personale. Në etikë, integriteti konsiderohet si ndershmëria dhe vërtetësia ose saktësia e veprimeve të dikujt. |  | |



# Mirëmbajtje dhe Riparime Mekanike

S4J
Aftësi për Punë / Skills for Jobs



Sapo mbaroi me sukses shkollën profesionale, Alberti u punësua në një fabrikë ku prodhohen materiale hidraulike dhe mekanike. Ç'do mëngjes, ai kontrollon dhe vë në funksionim makinat e prodhimit dhe të paketimit. Ai sigurohet që të gjitha makineritë të punojnë në mënyrën e duhur, sepse në të kundërt, prodhimi është jo cilësor ose difektoz. Për këtë arsye, ai diagnostifikon me rradhë makineritë dhe bën një provë paraprake. Më pas ai mban shënime dhe plotëson raportin teknik.

Alberti ka lexuar me kujdes dokumentacionin teknik, instruksionet e përdorimit dhe manualet teknike të makinerive dhe ka mësuar të gjitha veçoritë e tyre. Ai është i aftë të identifikojë pjesët e konsumueshëm, elementet fikse dhe të lëvizshëm të makinerive në fabrikë. Gjithashtu, ai njeh dhe përdor me thjeshtësi veglat dhe pajisjet përkatëse për të kryer punimet e mirëmbajtjes dhe të riparimit. Alberti kujdeset për veglat e punës dhe për ambjentin ku ai punon dhe nuk harron të zbatojë rregullat e mbrojtjes dhe të ruajtjes së mjedisit.

Sot, ai po riparon një makineri paketimi. Makineria bën një zhurmë shqetësuese, ndërsa forma e materialit të paketimit nuk është prerë saktë. Alberti diagnostifikon makinerinë dhe kupton që një nga pllakat metalike të makinerisë është shtrembëruar dhe krisur, ndërsa thika prerëse ka nevojë të mprehet. Ai njofton përgjegjësin e prodhimit që të ndalojë paketimin e produkteve, derisa të rregullohet problemi.

Me kujdes, hap pas hapi, Alberti ç'monton pjesët e makinerisë. Më pas, ai merr pllakën metalike të krisur dhe, duke përdorur mjetet e duhura të punës, ai drejton pllakën metalike, deri sa ajo merr formën e saj të mëparshme. Më pas, ai saldon pjesën e krisur dhe pastaj e lëmon, në mënyrë që të krijohet një sipërfaqe e njëtrajtshme. Ai e ka pak më të thjeshtë të riparojë thikën prerëse, pasi ajo ka nevojë vetëm për t'u mprehur; veprim që Alberti e bën më shpesh. Disa pjesë të makinerive, ashtu sikurse edhe thika prerëse, pasi përdoren për një kohë të gjatë, kanë nevojë të mirëmbahen ose të riparohen, pasi humbasin vetitë e tyre. Ndaj, Alberti merr thikën prerëse dhe e mpreh, duke përdorur pajisjet e duhura ndihmëse.

Sërish me kujdes, ai monton pjesët e makinerisë dhe bën një provë funksionimi. Makineria punon siç duhet, ndaj ai lajmëron përgjegjësin e prodhimit që të vazhdojë procesin e paketimit.

**Një projekt i Agjencisë Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim SDC**

Schweizerische Eidgenossenschaft
Confédération suisse
Confederazione Svizzera
Confederaziun svizra

Agjencia Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim SDC

**Në partneritet me:**

Republika e Shqipërisë
Ministria e Financave dhe Ekonomisë

**Zbatuar nga:**

swisscontact

# Mirëmbajtje dhe Riparime Mekanike

# Njohuri në lëndët mësimore

| Kërkesa | e ulët ◂ RËNDËSI ▸ e lartë | Komente |
|---|---|---|
| Matematikë: Puna me numra, forma gjeometrike dhe algjebër. | | Të kryejë llogaritje të thjeshta ekonomike. Të realizojë matjet e nevojshme dhe të hartojë skicat e nevojshme të punimit të detaleve. |
| Gjuhë e shkruar (shqip): Përdorimi i gjuhës së shkruar si mjet komunikimi në aktivitetet profesionale. | | Të plotësojë dokumentacionin teknik. |
| Gjuhë e folur (shqip): Përdorimi i gjuhës së folur si mjet komunikimi në aktivitetet profesionale. | | Të përshkruajë të dhënat e nevojshme dhe dokumentacionin përkatës në planet e montimit. |
| Gjuhë e huaj e shkruar: Përdorimi i gjuhës së huaj të shkruar si mjet komunikimi në aktivitetet profesionale. | | Të lexojë dhe të kuptojë instruksionet e përdorimit dhe manualet e makinerive të ndryshme. |
| Gjuhë e huaj e folur: Përdorimi i gjuhës së huaj të folur si mjet komunikimi në aktivitetet profesionale. | | |
| Shkencat Natyrore: Aftësitë dhe njohuritë shkencore të nevojshme për të hetuar, zgjidhur problemet, për të marrë vendime, për të mësuar gjatë gjithë jetës, për të drejtuar pyetje dhe për të shuar kuriozitetin e tyre. | | |
| Shoqëria dhe Mjedisi: Kuptimi i proceseve ligjore, politike, ekonomike, sociale, historike, kulturore dhe i çështjeve të ndërlidhura me to. | | |
| Arte: Mësimi, komunikimi, interpretimi dhe zhvillimi i aftësive të tyre artistike për të shprehur veten dhe për të asistuar në ndryshimin artistik dhe kulturore të vetvetes dhe të tjerëve. | | |
| Teknologjia & TIK: Përdorimi i TIK-ut për të kërkuar dhe marrë informacion nga burimet on-line; menaxhimi i projekteve në grupe pune; diskutimi dhe ndarja me të tjerët e gjetjeve të tyre gjatë kërkimit. | | Të bëjë kërkime në internet, për të kuptuar më mire pjesët përbërëse dhe skemën teknike të makinerive komplekse |



# Mirëmbajtje dhe Riparime Mekanike

# Kërkesat fizike

| Kërkesa | e ulët ◂ RËNDËSI ▸ e lartë | Komente |
|---|---|---|
| Aftësitë e forta motorike: Përdorimi në shkallë të gjerë dhe të koordinuar i duarve dhe krahëve. | | Gjatë riparimit të pjesëve difektoze |
| Aftësitë e buta motorike: Kryerja në masë të vogël e lëvizjeve të koordinuara dhe të kontrolluara të duarve dhe gishtërinjve. | | |
| Forca: Përdorimi i fuqisë muskulore, si afatshkurtër dhe impulsive (p.sh. për ngritjen e një arke të rëndë) ose afatgjatë dhe e vazhdueshme (p.sh. puna me trapan në një sipërfaqe mbi kokë). Përdorimi i zgjatur i fuqisë së muskujve gjatë ngritjes së objekteve, përdorimi i mjeteve/veglave ose ecja, vrapimi. | | |
| Aftësi normale për dallimin e ngjyrave: Aftësia për të dalluar të gjitha ngjyrat saktë | | |
| Shqisa e shijes, aromës: Nuhatja dhe/ ose shijimi, p.sh. kur gatuhet, prodhohen aroma; njohja e rreziqeve (p.sh. rrjedhje gazi, ushqime të prishura). | | Per te dalluar rrjedhjen e gazit apo lendeve te tjera perberese te nje makine |
| Asnjë lloj alergjie / intolerance: Nuk ka alergji / intolerancë ndaj substancave, si ushqime, pëlhura, etj. | | |
| Puna në temperatura dhe kushte të ndryshme atmosferike: Puna në ambiente jashtë, pavarësisht nga kushtet e motit dhe temperatura. | | |



# Mirëmbajtje dhe Riparime Mekanike

# Kompetencat personale dhe sociale

| Kërkesa | e ulët ◂ RËNDËSI ▸ e lartë | Komente |
|---|---|---|
| Qëndrueshmëria emocionale: Menaxhimi i situatave stresuese dhe marrja e masave për të reduktuar stresin në përgjegjësinë e vet. Veprimi i koordinuar dhe i synuar edhe nën presion kohor. |  | |
| Ritmi i shpejtë ose i pandikueshëm i punës: Puna (ritmi) mund të ndryshojë nga një çast në tjetrin, për shkak të kërkesës spontane dhe urgjente të klientit ose për shkak të ndryshimit dinamik të kushteve të punës. |  | |
| Përqendrim dhe qëndresë e lartë: Përqendrim i lartë në një detyrë që kërkon rezistencë të lartë ndaj shpërqendrimit për një periudhë të zgjatur kohore . |  | Per te arritur rezultatin e duhur gjate montimit dhe çmontimit te pjeseve te makinave dhe per te zbatuar me perpikmeri zgjidhjen e problemit sipas udhezuesve. |
| Aftësi të forta krijuese dhe aftësi për zgjidhjen e problemeve: Të menduarit për arritjet me qëllim transferimin e një faze aktuale në një fazë të synuar pavarësisht rezistencës e kundërshtive. |  | Për të arritur zgjidhjen e problemeve të ndryshme në makineritë e shumëllojshme |
| Fleksibiliteti në lidhje me vendndodhjen e punës: Aftësia për t'u përshtatur shpejt në vende të ndryshme pune në ambiente brenda ose jashtë. |  | Të mund të punojë aty ku ndodhen makineritë që duhen mirëmbajtur ose riparuar |
| Fleksibiliteti në lidhje me orarin e punës: Aftësia për t'u përshtatur me orare të ndryshme pune, të cilat mund të ndryshojnë nga orët standarde të punës, si puna gjatë natës ose herët në mëngjes. |  | |
| Qasje e hapur ndaj personave të tjerë me të cilët kontakton shpesh: Vendosja dhe ruajtja e marrëdhënieve formale, ruajtja e formave të kontaktimit me autoritetet, klientët, partnerët e biznesit, etj. |  | |
| Kënaqësi nga kontakti i vazhdueshëm, ndjeshmëri/ empati: Qasja empatike tek njerëzit e tjerë me qëllim krijimin dhe ruajtjen e marrëdhënieve. Kjo kërkesë është e rëndësishme në shumë shërbime ku kërkohet kontakt i vazhdueshëm me klientët, si shitja, kujdesi estetik, konsultimi, terapia. |  | |
| Aftësi e spikatur për të punuar në ekip për shkak të bashkëpunimit të ngushtë: Bashkëpunimi brenda ekipit, përkatësisht koordinimi ndërmjet anëtarëve të ekipit, supozimi i besueshëm i nëndetyrave, përgjegjësi e përbashkët për arritjen e qëllimeve. |  | Për të arritur koordinimin e duhur dhe ndarjen e detyrave, me qëllim zgjidhjen me sukses të problematikave. |
| Kompetencat ndërkulturore: Aftësitë njohëse, emocionale dhe të sjelljes që çojnë në komunikim efektiv dhe të përshtatshëm me njerëzit e kulturave të tjera. Ato përfshijnë sjelljet që i përshtaten pritshmërive të një kulture të caktuar, karakteristikat e situatës dhe nivelin e marrëdhënieve midis palëve të përfshira në këtë situatë. Ato gjithashtu marrin parasysh normat e veta kulturore dhe kompromisin më të përshtatshëm dhe më të qetë ndërmjet normave të ndryshme kulturore. |  | |
| Integritet i lartë: Aftësia për të qenë të ndershëm dhe për të patur parime të forta morale, ose ndershmëri morale. Është një zgjedhje personale për të ruajtur standarde të qëndrueshme në sjelljen personale. Në etikë, integriteti konsiderohet si ndershmëria dhe vërtetësia ose saktësia e veprimeve të dikujt. |  | |



# Metalurgji dhe Fonderi

S4J
Aftësi për Punë / Skills for Jobs



Gjoni punon në uzinën metalurgjike, në repartin e fonderisë. Në këtë repart shkrihen materiale metalike, për të krijuar modele dhe forma të madhësive të ndryshme.

Bashkë me Gjonin, punojnë edhe tre kolegë të tjerë, ndër të cilët edhe mbikqyrësi i prodhimit. Puna në repartin e fonderisë kërkon zbatimin e përpiktë të standarteve dhe rregullave të sigurisë. Ndaj, Gjoni dhe kolegët e tij pajisen me veshjet e posatshme, të cilat ruajnë shëndetin nga temperaturat e larta apo dëmtime të ndryshme. Gjithashtu, ata tregojnë kujdesin e duhur dhe mirëmbajnë vendin, mjetet dhe materialet e punës që përdoren në repartin e tyre, duke i pastruar nga pluhurat, nga mbetjet pas mbarimit të prodhimit dhe nga lëndët vajore.

Kur inxhinieri drejtues i teknologjisë njofton për porosinë e rradhës, Gjoni dëgjon me kujdes dhe mban shënime. Për ç'do paqartësi, ai pyet inxhinierin ose mbikqyrësin e tij. Në fillim, ai duhet të përdorë furrën për të shkrirë metalin që nevojitet. Për këtë, Gjoni mbush furrën me material skrapi dhe sheh si ai shkrihet ngadalë në temperaturë shumë të lartë dhe kthehet në gjendje të lëngshme. Nga furra, nëpërmjet një kanali të posatshëm, metali i shkrirë depozitohet në kallëpa. Gjatë këtij procesi, Gjoni sigurohet që ç'do papastërti është eliminuar dhe mbetjet e ndryshme janë veçuar me kujdes. Pasi metali i lëngshëm ftohet dhe ngurtësohet, ai sistemon kallëpat një e nga një, në mënyrë që të transportohen lehtësisht.

Pak orë më vonë, inxhinieri i kërkon ndihmë Gjonit për krijimin e një kallëpi apo modeli të ri, i cili do të përdoret për realizimin e një detali me derdhje. Gjoni tregohet i gatshëm dhe menjëherë fillon punën. Ai realizon skicën me kujdes, duke përdorur përmasat e duhura. Pasi e konsulton me mbikqyrësin e tij, ai bën sistemimet përfundimtare të skicës. Më pas, ai organizon vendin e punës dhe përzgjedh veglat e punës, mjetet ndihmëse dhe llojin e materialeve që do të përdorë. Me durim dhe duke u bazuar te skica, ai arrin të krijojë modelin me sukses.

Gjoni ia dorëzon inxhinierit modelin e përfunduar. Inxhinieri e kontrollon me vëmendje modelin, përgëzon Gjonin për punën e mirë që ai ka bërë dhe e lajmëron që ka ardhur momenti për të bërë pushimin e drekës.

**Një projekt i Agjencisë Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim SDC**

Schweizerische Eidgenossenschaft
Confédération suisse
Confederazione Svizzera
Confederaziun svizra

Agjencia Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim SDC

**Në partneritet me:**

Republika e Shqipërisë
Ministria e Financave dhe Ekonomisë

**Zbatuar nga:**

swisscontact

# Metalurgji dhe Fonderi

# Njohuri në lëndët mësimore

| Kërkesa | e ulët ◂ RËNDËSI ▸ e lartë | Komente |
|---|---|---|
| Matematikë: Puna me numra, forma gjeometrike dhe algjebër. | | Të përgatisë vizatimet dhe skicat e punës së modeleve, arkave të zemrave, formave dhe zemrave, që përdoren në prodhimin e detaleve me derdhje. |
| Gjuhë e shkruar (shqip): Përdorimi i gjuhës së shkruar si mjet komunikimi në aktivitetet profesionale. | | |
| Gjuhë e folur (shqip): Përdorimi i gjuhës së folur si mjet komunikimi në aktivitetet profesionale. | | |
| Gjuhë e huaj e shkruar: Përdorimi i gjuhës së huaj të shkruar si mjet komunikimi në aktivitetet profesionale. | | |
| Gjuhë e huaj e folur: Përdorimi i gjuhës së huaj të folur si mjet komunikimi në aktivitetet profesionale. | | |
| Shkencat Natyrore: Aftësitë dhe njohuritë shkencore të nevojshme për të hetuar, zgjidhur problemet, për të marrë vendime, për të mësuar gjatë gjithë jetës, për të drejtuar pyetje dhe për të shuar kuriozitetin e tyre. | | |
| Shoqëria dhe Mjedisi: Kuptimi i proceseve ligjore, politike, ekonomike, sociale, historike, kulturore dhe i çështjeve të ndërlidhura me to. | | |
| Arte: Mësimi, komunikimi, interpretimi dhe zhvillimi i aftësive të tyre artistike për të shprehur veten dhe për të asistuar në ndryshimin artistik dhe kulturore të vetvetes dhe të tjerëve. | | |
| Teknologjia & TIK: Përdorimi i TIK-ut për të kërkuar dhe marrë informacion nga burimet on-line; menaxhimi i projekteve në grupe pune; diskutimi dhe ndarja me të tjerët e gjetjeve të tyre gjatë kërkimit. | | |



# Metalurgji dhe Fonderi

# Kërkesat fizike

| **Kërkesa** | **e ulët ‹ RËNDËSI › e lartë** | **Komente** |
|---|---|---|
| Aftësitë e forta motorike: Përdorimi në shkallë të gjerë dhe të koordinuar i duarve dhe krahëve. | | Për përdorimin e mjeteve, makinave dhe pajisjeve ndihmëse gjatë punës |
| Aftësitë e buta motorike: Kryerja në masë të vogël e lëvizjeve të koordinuara dhe të kontrolluara të duarve dhe gishtërinjve. | | |
| Forca: Përdorimi i fuqisë muskulore, si afatshkurtër dhe impulsive (p.sh. për ngritjen e një arke të rëndë) ose afatgjatë dhe e vazhdueshme (p.sh. puna me trapan në një sipërfaqe mbi kokë). Përdorimi i zgjatur i fuqisë së muskujve gjatë ngritjes së objekteve, përdorimi i mjeteve/veglave ose ecja, vrapimi. | | Për lëvizjen e materialeve të rënda. |
| Aftësi normale për dallimin e ngjyrave: Aftësia për të dalluar të gjitha ngjyrat saktë | | Gjatë përpunimit të metaleve dhe përdorimit të lëndëve të ndryshme. |
| Shqisa e shijes, aromës: Nuhatja dhe/ ose shijimi, p.sh. kur gatuhet, prodhohen aroma; njohja e rreziqeve (p.sh. rrjedhje gazi, ushqime të prishura). | | |
| Asnjë lloj alergjie / intolerance: Nuk ka alergji / intolerancë ndaj substancave, si ushqime, pëlhura, etj. | | |
| Puna në temperatura dhe kushte të ndryshme atmosferike: Puna në ambiente jashtë, pavarësisht nga kushtet e motit dhe temperatura. | | Gjatë shkrirjes së metaleve, në procesin e fonderisë. |



# Metalurgji dhe Fonderi

# Kompetencat personale dhe sociale

| Kërkesa | e ulët ◂ RËNDËSI ▸ e lartë | Komente |
|---|---|---|
| Qëndrueshmëria emocionale: Menaxhimi i situatave stresuese dhe marrja e masave për të reduktuar stresin në përgjegjësinë e vet. Veprimi i koordinuar dhe i synuar edhe nën presion kohor. | | Për të ndjekur standartet e sigurisë, për të mbrojtur veten dhe kolegët |
| Ritmi i shpejtë ose i pandikueshëm i punës: Puna (ritmi) mund të ndryshojë nga një çast në tjetrin, për shkak të kërkesës spontane dhe urgjente të klientit ose për shkak të ndryshimit dinamik të kushteve të punës. | | |
| Përqendrim dhe qëndresë e lartë: Përqendrim i lartë në një detyrë që kërkon rezistencë të lartë ndaj shpërqendrimit për një periudhë të zgjatur kohore . | | Për të realizuar me sukses sipas planit ose skicës të gjithë procesin e punës. |
| Aftësi të forta krijuese dhe aftësi për zgjidhjen e problemeve: Të menduarit për arritjet me qëllim transferimin e një faze aktuale në një fazë të synuar pavarësisht rezistencës e kundërshtive. | | |
| Fleksibiliteti në lidhje me vendndodhjen e punës: Aftësia për t'u përshtatur shpejt në vende të ndryshme pune në ambiente brenda ose jashtë. | | |
| Fleksibiliteti në lidhje me orarin e punës: Aftësia për t'u përshtatur me orare të ndryshme pune, të cilat mund të ndryshojnë nga orët standarde të punës, si puna gjatë natës ose herët në mëngjes. | | |
| Qasje e hapur ndaj personave të tjerë me të cilët kontakton shpesh: Vendosja dhe ruajtja e marrëdhënieve formale, ruajtja e formave të kontaktimit me autoritetet, klientët, partnerët e biznesit, etj. | | |
| Kënaqësi nga kontakti i vazhdueshëm, ndjeshmëri/ empati: Qasja empatike tek njerëzit e tjerë me qëllim krijimin dhe ruajtjen e marrëdhënieve. Kjo kërkesë është e rëndësishme në shumë shërbime ku kërkohet kontakt i vazhdueshëm me klientët, si shitja, kujdesi estetik, konsultimi, terapia. | | |
| Aftësi e spikatur për të punuar në ekip për shkak të bashkëpunimit të ngushtë: Bashkëpunimi brenda ekipit, përkatësisht koordinimi ndërmjet anëtarëve të ekipit, supozimi i besueshëm i nëndetyrave, përgjegjësi e përbashkët për arritjen e qëllimeve. | | Për të bashkërenduar proceset me kolegët dhe pjesëtarët e tjerë. |
| Kompetencat ndërkulturore: Aftësitë njohëse, emocionale dhe të sjelljes që çojnë në komunikim efektiv dhe të përshtatshëm me njerëzit e kulturave të tjera. Ato përfshijnë sjelljet që i përshtaten pritshmërive të një kulture të caktuar, karakteristikat e situatës dhe nivelin e marrëdhënieve midis palëve të përfshira në këtë situatë. Ato gjithashtu marrin parasysh normat e veta kulturore dhe kompromisin më të përshtatshëm dhe më të qetë ndërmjet normave të ndryshme kulturore. | | |
| Integritet i lartë: Aftësia për të qenë të ndershëm dhe për të patur parime të forta morale, ose ndershmëri morale. Është një zgjedhje personale për të ruajtur standarde të qëndrueshme në sjelljen personale. Në etikë, integriteti konsiderohet si ndershmëria dhe vërtetësia ose saktësia e veprimeve të dikujt. | | |



# Shërbime Elektro-Auto

Aftësi për Punë / Skills for Jobs




Doriani punon në një kompani të mesme për riparimin e automjeteve. Në mëngjes ai merr një porosi me shkrim nga përgjegjësi i tij për të riparuar një automjet. Nga dokumentet e shkruara ai mëson se motori i mjetit në fjalë gulçon dhe se drita treguese e motorit është e ndezur. Para se të testojë makinën, Doriani vendos mbrojtëset e sediljes, të hapësirës ku vendosen këmbët si edhe të timonit për të mos i ndotur. Gjatë testit pasues, ai e kupton arsyen e ankesës së klientit dhe nxjerr konkluzionet e para per diagnostikimin e mëtejshëm. Ai e fut automjetin në ofiçinë dhe lidh pajisjen diagnostikuese për të lexuar dhe kuptuar defektin e motorit. Kodi i gabimit kërkon rregullimin sistematik të problemit. Me ndihmën e diagrameve të qarkut elektrik dhe të pajisjeve matëse, Doriani mat lidhjet elektrike dhe kontrollon komponentët. Ai i krahason vlerat e përftuara me vlerat e synuara sipas literaturës përkatëse. Prandaj, Doriani duhet të jetë në gjendje të trajtojë vlerat e matura dhe të edhe kuptojë lidhjet elektronike.

Në fund, Doriani arrin ta kufizojë gabimin tek valvula flutur. Ai kërkon të gjejë informacion për defekte të ngjashme në sistemet e informacionit të prodhuesit për produktet teknike. Bazuar në këtë informacion dhe në përvojën e tij, Doriani arrin në përfundimin se riparimi mund të kryhet në dy mënyra: e para duke e pastruar valvulën e ose duke e zëvendësuar atë. Ai i diskuton këto dy mundësi me përgjegjësin dhe së bashku diskutojnë në lidhje me hapat e mëtejshëm me qëllim riparimin e defektit. Ia paraqet gjetjet e tij mbikëqyrësit dhe diskuton hapat e ardhshëm me të. Ata diskutojnë avantazhet dhe disavantazhet e të dy opsioneve dhe vendosin të zëvendësojnë valvulën flutur.

Doriani përgatit ofertën për klientin dhe e telefonon për të marrë pëlqimin e tij. Klienti reagon i mërzitur kur e sheh faturën. Doriani mbetet i qetë dhe i sjellshëm dhe i tregon klientit pjesët e këmbimit që ka përdorur për riparimin e defektit si dhe çmimet e tyre. Konsumatori qetësohet, pasi tani e kupton arsyen e shumës së faturuar. Ai e falenderon Dorianin për shpjegimin.

Doriani i merr pjesët e nevojshme rezervë nga magazina dhe i zëvendëson ato sipas literaturës përkatëse. Më pas, ai bën një përditësim të softuerit në njësinë e kontrollit të motorit, programon valvulën e re flutur dhe pastron memorien e defekteve. Pas një testimi të suksesshëm, ai e pastron automjetin dhe e përgatit për t'ia dorëzuar klientit. Tani ai mban shënim të gjithë hapat e ndjekur gjatë punës në formularin e porosisë së ofiçinës dhe e kalon për faturim. Kur automjeti i kthehet klientit, Doriani i shpjegon atij problemin dhe riparimin e kryer.

Pa largimit të klientit, Doriani merr porosinë tjetër nga përgjegjësi i tij. Ai duhet të përgatisë një automjet që do t'i nënshtrohet kontrollit teknik.

Schweizerische Eidgenossenschaft
Confédération suisse
Confederazione Svizzera
Confederaziun svizra

Agjencia Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim SDC

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E FINANCAVE DHE EKONOMISË

swisscontact

# Shërbime Elektro-Auto

# Kërkesat e shkollës

| Kërkesa | e ulët ◂ RËNDËSI ▸ e lartë | Komente |
|---|---|---|
| Matematikë: Puna me numra, forma gjeometrike dhe algjebër. | | Zbulimi sistematik i gabimeve. |
| Gjuhë e shkruar (shqip): Përdorimi i gjuhës së shkruar si mjet komunikimi në aktivitetet profesionale. | | |
| Gjuhë e folur (shqip): Përdorimi i gjuhës së folur si mjet komunikimi në aktivitetet profesionale. | | |
| Gjuhë e huaj e shkruar: Përdorimi i gjuhës së huaj të shkruar si mjet komunikimi në aktivitetet profesionale. | | |
| Gjuhë e huaj e folur: Përdorimi i gjuhës së huaj të folur si mjet komunikimi në aktivitetet profesionale. | | |
| Shkencat Natyrore: Aftësitë dhe njohuritë shkencore të nevojshme për të hetuar, zgjidhur problemet, për të marrë vendime, për të mësuar gjatë gjithë jetës, për të drejtuar pyetje dhe për të shuar kuriozitetin e tyre. | | Trajtimi i vlerave të matura dhe kuptimi i lidhjeve elektronike. Kuptimi i rregullave të sigurisë gjatë kryerjes së punëve me elektricitet. |
| Shoqëria dhe Mjedisi: Kuptimi i proceseve ligjore, politike, ekonomike, sociale, historike, kulturore dhe i çështjeve të ndërlidhura me to. | | Kuptimi i masave për eliminimin e risqeve që vijnë nga ndotja. |
| Arte: Mësimi, komunikimi, interpretimi dhe zhvillimi i aftësive të tyre artistike për të shprehur veten dhe për të asistuar në ndryshimin artistik dhe kulturore të vetvetes dhe të tjerëve. | | |
| Teknologjia & TIK: Përdorimi i TIK-ut për të kërkuar dhe marrë informacion nga burimet on-line; menaxhimi i projekteve në grupe pune; diskutimi dhe ndarja me të tjerët e gjetjeve të tyre gjatë kërkimit. | | Vënia në punë e paisjeve diagnostikuese. Përditësimi i softuerit. |



# Shërbime Elektro-Auto

# Kërkesat fizike

| Kërkesa | e ulët ◂ RËNDËSI ▸ e lartë | Komente |
|---|---|---|
| Aftësitë e forta motorike: Përdorimi në shkallë të gjerë dhe të koordinuar i duarve dhe krahëve. | | P.sh. gjatë kryerjes së testeve ose kryerjes së punëve për zëvendësimin e pjesëve. |
| Aftësitë e buta motorike: Kryerja në masë të vogël e lëvizjeve të koordinuara dhe të kontrolluara të duarve dhe gishtërinjve. | | |
| Forca: Përdorimi i fuqisë muskulore, si afatshkurtër dhe impulsive (p.sh. për ngritjen e një arke të rëndë) ose afatgjatë dhe e vazhdueshme (p.sh. puna me trapan në një sipërfaqe mbi kokë). Përdorimi i zgjatur i fuqisë së muskujve gjatë ngritjes së objekteve, përdorimi i mjeteve/veglave ose ecja, vrapimi. | | |
| Aftësi normale për dallimin e ngjyrave: Aftësia për të dalluar të gjitha ngjyrat saktë | | Leximi i diagrameve të qarkut. |
| Shqisa e shijes, aromës: Nuhatja dhe/ ose shijimi, p.sh. kur gatuhet, prodhohen aroma; njohja e rreziqeve (p.sh. rrjedhje gazi, ushqime të prishura). | | |
| Asnjë lloj alergjie / intolerance: Nuk ka alergji / intolerancë ndaj substancave, si ushqime, pëlhura, etj. | | |
| Puna në temperatura dhe kushte të ndryshme atmosferike: Puna në ambiente jashtë, pavarësisht nga kushtet e motit dhe temperatura. | | |



# Shërbime Elektro-Auto

# Kompetencat personale dhe sociale

| Kërkesa | e ulët ◂ RËNDËSI ▸ e lartë | Komente |
|---|---|---|
| Qëndrueshmëria emocionale: Menaxhimi i situatave stresuese dhe marrja e masave për të reduktuar stresin në përgjegjësinë e vet. Veprimi i koordinuar dhe i synuar edhe nën presion kohor. |  | |
| Ritmi i shpejtë ose i pandikueshëm i punës: Puna (ritmi) mund të ndryshojë nga një çast në tjetrin, për shkak të kërkesës spontane dhe urgjente të klientit ose për shkak të ndryshimit dinamik të kushteve të punës. |  | Ndonjëherë ngarkesa e paparashikuar e punës, p.sh. riparimet urgjente dhe të paplanifikuara. |
| Përqendrim dhe qëndresë e lartë: Përqendrim i lartë në një detyrë që kërkon rezistencë të lartë ndaj shpërqendrimit për një periudhë të zgjatur kohore . |  | Zgjidhja e problemeve. |
| Aftësi të forta krijuese dhe aftësi për zgjidhjen e problemeve: Të menduarit për arritjet me qëllim transferimin e një faze aktuale në një fazë të synuar pavarësisht rezistencës e kundërshtive. |  | Zgjidhja e problemeve, zgjidhjet e propozuara. |
| Fleksibiliteti në lidhje me vendndodhjen e punës: Aftësia për t'u përshtatur shpejt në vende të ndryshme pune në ambiente brenda ose jashtë. |  | P.sh. ndihma në rrugë. |
| Fleksibiliteti në lidhje me orarin e punës: Aftësia për t'u përshtatur me orare të ndryshme pune, të cilat mund të ndryshojnë nga orët standarde të punës, si puna gjatë natës ose herët në mëngjes. |  | Ndonjëherë ngarkesa e paparashikuar e punës, p.sh. riparimet urgjente dhe të paplanifikuara. |
| Qasje e hapur ndaj personave të tjerë me të cilët kontakton shpesh: Vendosja dhe ruajtja e marrëdhënieve formale, ruajtja e formave të kontaktimit me autoritetet, klientët, partnerët e biznesit, etj. |  | Kontakti me klientët. |
| Kënaqësi nga kontakti i vazhdueshëm, ndjeshmëri, empati: Qasja empatike tek njerëzit e tjerë me qëllim krijimin dhe ruajtjen e marrëdhënieve. Kjo kërkesë është e rëndësishme në shumë shërbime ku kërkohet kontakt i vazhdueshëm me klientët, si shitja, kujdesi estetik, konsultimi, terapia. |  | |
| Aftësi e spikatur për të punuar në ekip për shkak të bashkëpunimit të ngushtë: Bashkëpunimi brenda ekipit, përkatësisht koordinimi ndërmjet anëtarëve të ekipit, supozimi i besueshëm i nëndetyrave, përgjegjësi e përbashkët për arritjen e qëllimeve. |  | Puna në ekip është një domosdoshmëri në këtë profesion. |
| Kompetencat ndërkulturore: Aftësitë njohëse, emocionale dhe të sjelljes që çojnë në komunikim efektiv dhe të përshtatshëm me njerëzit e kulturave të tjera. Ato përfshijnë sjelljet që i përshtaten pritshmërive të një kulture të caktuar, karakteristikat e situatës dhe nivelin e marrëdhënieve midis palëve të përfshira në këtë situatë. Ato gjithashtu marrin parasysh normat e veta kulturore dhe kompromisin më të përshtatshëm dhe më të qetë ndërmjet normave të ndryshme kulturore. |  | |
| Integritet i lartë: Aftësia për të qenë të ndershëm dhe për të patur parime të forta morale, ose ndershmëri morale. Është një zgjedhje personale për të ruajtur standarde të qëndrueshme në sjelljen personale. Në etikë, integriteti konsiderohet si ndershmëria dhe vërtetësia ose saktësia e veprimeve të dikujt. |  | Ndershmëria, integriteti ndaj klientit, kryerja e punëve që kanë të bëjnë me sigurinë. |



# Shërbime Motorike

Aftësi për Punë / Skills for Jobs



Është një ditë normale pune, e Mërkurë, ora 16:30. Berti sapo ka mbaruar riparimin e motorit të një automjeti, i cili punon me benzinë. Autoservisi ku ai punon mbyllet zakonisht në orën 18:00, ndaj ai shkon të pyesë administratorin (inxhinierin) e servisit nëse mund t'a ndihmojë me diçka tjetër, para se të sistemojë veglat e punës dhe të largohet. Administratori i tregon një automjet, i përdorur si taksi, që sapo kishte mbërritur në servis. Motori i taksisë ndalonte së punuari pak sekonda pasi ndizej. Administratori udhëzon Bertin, që ai të lexojë instruksionet lidhur me motorin përkatës të taksisë dhe më pas të kontrollojë motorin për të gjetur arsyen e mosfunksionimit.

Berti menjëherë fillon punën. Servisi mbyllet për rreth një orë, ndaj ai duhet të jetë i përqëndruar dhe të gjejë problemin sa më shpejt. Pasi lexon me kujdes instruksionet përkatëse, ai fillimisht kryen një inspektim vizual të motorit, për probleme të dukshme. Më pas, ai mundohet të kuptojë më shumë mbi funksionimin e motorit, duke dëgjuar zhurmën që motori bën kur ndizet. Berti fillon të diagnostifikojë automjetin sipas instruksioneve dhe ndërkohë mban shënime pas ç'do kontrolli që kryen. Ai diagnostifikon sistemin e vajisjes së motorit, sistemin elektrik të motorit, mekanizmin e shpërndarjes së gazeve, sistemin e ftohjes dhe sistemin e ushqimit dhe shkarkimit të motorit.

Berti është pothuajse i bindur që problemi vjen nga mosfunksionimi i sistemit të ushqimit të motorit. Ai i shpreh administratorit dyshimin e tij dhe i kërkon ndihmë për të verifikuar shkakun e problemit. Administratori, pasi diagnostifikon sistemin e ushqimit të motorit, e përgëzon Bertin dhe i thotë që ai e ka gjetur shkakun e vërtetë të problemit. Pasi diskuton me administratorin, Berti i thotë shoferit të taksisë që makina do të jetë gati ditën e nesërme, pasi kërkon më shumë se tre orë për t'u rregulluar, ndërkohë që ka ardhur orari i mbylljes së servisit. Gjithashtu, ai i tregon klientit kostot për sistemimin e problemit. Klienti pranon dhe i thotë Bertit që do të vijë të nesërmen, në orën 12:00, për të marrë taksinë.

Të nesërmen në mëngjes, Berti përgatit mjetet e punës dhe merr nga magazina pjesët e motorit që do të ndërrojë. Ai zbaton me përpikmëri instruksionet rreth mënyrës së ç'montimit dhe montimit të pjesëve të motorit. Ai tregon kujdes, pasi disa pjesë të motorit janë delikate dhe mund të dëmtohen gjatë punës. Pasi përfundon montimin e të gjithë pjesëve, Berti ndez makinën. Ç'do gjë duket mirë, motori punon dhe nuk ndalon së punuari si më parë. Berti lajmëron administratorin, i cili bën një diagnostifikim të fundit.

Ndërkohë që Berti plotëson raportin teknik, hyn klienti (shoferi i taksisë), i cili e falenderon Bertin për punën e mirë.

Schweizerische Eidgenossenschaft
Confédération suisse
Confederazione Svizzera
Confederaziun svizra

Agjencia Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim SDC

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E FINANCAVE DHE EKONOMISË

swisscontact

# Shërbime Motorike

# Njohuri në lëndët mësimore

| Kërkesa | e ulët ◂ RËNDËSI ▸ e lartë | Komente |
|---|---|---|
| Matematikë: Puna me numra, forma gjeometrike dhe algjebër. | | Në përdorimin e numrave, veprimeve matematikore dhe funksioneve gjeometrike. Përllogaritje të thjeshta ekonomike. |
| Gjuhë e shkruar (shqip): Përdorimi i gjuhës së shkruar si mjet komunikimi në aktivitetet profesionale. | | |
| Gjuhë e folur (shqip): Përdorimi i gjuhës së folur si mjet komunikimi në aktivitetet profesionale. | | |
| Gjuhë e huaj e shkruar: Përdorimi i gjuhës së huaj të shkruar si mjet komunikimi në aktivitetet profesionale. | | Vetëm për leximin dhe kuptimin e udhëzuesve dhe manualeve, të cilët janë kryesisht në gjuhë të huaj. |
| Gjuhë e huaj e folur: Përdorimi i gjuhës së huaj të folur si mjet komunikimi në aktivitetet profesionale. | | |
| Shkencat Natyrore: Aftësitë dhe njohuritë shkencore të nevojshme për të hetuar, zgjidhur problemet, për të marrë vendime, për të mësuar gjatë gjithë jetës, për të drejtuar pyetje dhe për të shuar kuriozitetin e tyre. | | |
| Shoqëria dhe Mjedisi: Kuptimi i proceseve ligjore, politike, ekonomike, sociale, historike, kulturore dhe i çështjeve të ndërlidhura me to. | | |
| Arte: Mësimi, komunikimi, interpretimi dhe zhvillimi i aftësive të tyre artistike për të shprehur veten dhe për të asistuar në ndryshimin artistik dhe kulturore të vetvetes dhe të tjerëve. | | |
| Teknologjia & TIK: Përdorimi i TIK-ut për të kërkuar dhe marrë informacion nga burimet on-line; menaxhimi i projekteve në grupe pune; diskutimi dhe ndarja me të tjerët e gjetjeve të tyre gjatë kërkimit. | | Për përdorimin e aplikacioneve diagnostifikuese. |



# Shërbime Motorike

# Kërkesat fizike

| Kërkesa | e ulët RËNDËSI e lartë | Komente |
|---|---|---|
| Aftësitë e forta motorike: Përdorimi në shkallë të gjerë dhe të koordinuar i duarve dhe krahëve. | | Për mirëmbajtjen dhe riparimin e sistemeve përbërëse të motorit. |
| Aftësitë e buta motorike: Kryerja në masë të vogël e lëvizjeve të koordinuara dhe të kontrolluara të duarve dhe gishtërinjve. | | |
| Forca: Përdorimi i fuqisë muskulore, si afatshkurtër dhe impulsive (p.sh. për ngritjen e një arke të rëndë) ose afatgjatë dhe e vazhdueshme (p.sh. puna me trapan në një sipërfaqe mbi kokë). Përdorimi i zgjatur i fuqisë së muskujve gjatë ngritjes së objekteve, përdorimi i mjeteve/veglave ose ecja, vrapimi. | | |
| Aftësi normale për dallimin e ngjyrave: Aftësia për të dalluar të gjitha ngjyrat saktë | | |
| Shqisa e shijes, aromës: Nuhatja dhe/ ose shijimi, p.sh. kur gatuhet, prodhohen aroma; njohja e rreziqeve (p.sh. rrjedhje gazi, ushqime të prishura). | | Kërkohet një dëgjim i mprehtë, pasi shpesh avaritë gjenden me anë të zhurmës që përçon motori gjatë funksionimit. |
| Asnjë lloj alergjie / intolerance: Nuk ka alergji / intolerancë ndaj substancave, si ushqime, pëlhura, etj. | | |
| Puna në temperatura dhe kushte të ndryshme atmosferike: Puna në ambiente jashtë, pavarësisht nga kushtet e motit dhe temperatura. | | |



# Shërbime Motorike

# Kompetencat personale dhe sociale

| Kërkesa | e ulët ◂ RËNDËSI ▸ e lartë | Komente |
|---|---|---|
| Qëndrueshmëria emocionale: Menaxhimi i situatave stresuese dhe marrja e masave për të reduktuar stresin në përgjegjësinë e vet. Veprimi i koordinuar dhe i synuar edhe nën presion kohor. |  | |
| Ritmi i shpejtë ose i pandikueshëm i punës: Puna (ritmi) mund të ndryshojë nga një çast në tjetrin, për shkak të kërkesës spontane dhe urgjente të klientit ose për shkak të ndryshimit dinamik të kushteve të punës. |  | |
| Përqendrim dhe qëndresë e lartë: Përqendrim i lartë në një detyrë që kërkon rezistencë të lartë ndaj shpërqendrimit për një periudhë të zgjatur kohore . |  | |
| Aftësi të forta krijuese dhe aftësi për zgjidhjen e problemeve: Të menduarit për arritjet me qëllim transferimin e një faze aktuale në një fazë të synuar pavarësisht rezistencës e kundërshtive. |  | |
| Fleksibiliteti në lidhje me vendndodhjen e punës: Aftësia për t'u përshtatur shpejt në vende të ndryshme pune në ambiente brenda ose jashtë. |  | |
| Fleksibiliteti në lidhje me orarin e punës: Aftësia për t'u përshtatur me orare të ndryshme pune, të cilat mund të ndryshojnë nga orët standarde të punës, si puna gjatë natës ose herët në mëngjes. |  | Në disa raste, orare të zgjatura që vijnë si pasojë e proceseve të gjata të matjes dhe diagnostifikimit dhe gjetjes së zgjidhjes ideale. |
| Qasje e hapur ndaj personave të tjerë me të cilët kontakton shpesh: Vendosja dhe ruajtja e marrëdhënieve formale, ruajtja e formave të kontaktimit me autoritetet, klientët, partnerët e biznesit, etj. |  | Shkëmbimi i informacioneve me kolegë të tjerë, marrëdhënje të mira me furnitorët, klientët dhe të tjerë. |
| Kënaqësi nga kontakti i vazhdueshëm, ndjeshmëri/ empati: Qasja empatike tek njerëzit e tjerë me qëllim krijimin dhe ruajtjen e marrëdhënieve. Kjo kërkesë është e rëndësishme në shumë shërbime ku kërkohet kontakt i vazhdueshëm me klientët, si shitja, kujdesi estetik, konsultimi, terapia. |  | |
| Aftësi e spikatur për të punuar në ekip për shkak të bashkëpunimit të ngushtë: Bashkëpunimi brenda ekipit, përkatësisht koordinimi ndërmjet anëtarëve të ekipit, supozimi i besueshëm i nëndetyrave, përgjegjësi e përbashkët për arritjen e qëllimeve. |  | |
| Kompetencat ndërkulturore: Aftësitë njohëse, emocionale dhe të sjelljes që çojnë në komunikim efektiv dhe të përshtatshëm me njerëzit e kulturave të tjera. Ato përfshijnë sjelljet që i përshtaten pritshmërive të një kulture të caktuar, karakteristikat e situatës dhe nivelin e marrëdhënieve midis palëve të përfshira në këtë situatë. Ato gjithashtu marrin parasysh normat e veta kulturore dhe kompromisin më të përshtatshëm dhe më të qetë ndërmjet normave të ndryshme kulturore. |  | |
| Integritet i lartë: Aftësia për të qenë të ndershëm dhe për të patur parime të forta morale, ose ndershmëri morale. Është një zgjedhje personale për të ruajtur standarde të qëndrueshme në sjelljen personale. Në etikë, integriteti konsiderohet si ndershmëria dhe vërtetësia ose saktësia e veprimeve të dikujt. |  | |



# Shërbime Xhenerike

S4J Aftësi për Punë / Skills for Jobs



Arbri punon në një autoservis. Në mëngjes ai komunikon me administratorin e autoservisit për problematikat e një autoveture të ardhur për t'u riparuar nga një zonjë. Administratori e udhëzon Arbrin si të veprojë për të identifikuar shkakun e problemit.

Drejtuesja e mjetit ndjen një tronditje në volantin e timonit kur frenon, sidomos në një shpejtësi mbi 80 Km/orë. Arbri përcakton dy fusha të mundshme për diagnostifikimin dhe riparimin e automjetit:

1- Hidroelektrike
2- Mekanike

Arbri përgatit automjetin për punë duke vendosur elementët mbrojtës në ndenjëse, në timon, tek këmbët e drejtuesit dhe mbulesat mbrojtëse tek parafangat e automjetit dhe e vendos automjetin në Autolift (ashensorin për ngritjen e makinës). Më pas, ai përzgjedh pajisjen testuese sipas programit dhe sondës që i përket tipit të mjetit.

Arbri kryen matjet dhe kontrollet e nevojshme në sensorët elektrikë, përcjellësa dhe pompën elektrohidraulike të sistemit të frenimit. Pasi realizon kontrollin e nevojshëm me pajisjet testuese ai përcakton që problemi duhet të jetë patjetër tek pjesët mekanike (xhenerike) të automjetit. Ai nis kontrollin pamor të gjithë elementeve të sistemit të frenimit dhe më pas mat me instrumenta matës disa nga këto elemente. Nga matjet e kryera ai përcakton pjesën e dëmtuar në sistemin e frenimit. (Disqet e para frenuese të automjetit janë të deformuara si pasojë e ndryshimit të temperaturave gjatë frenimit të kryer nga automjeti.)

Arbri diskuton me administratorin për të vazhduar procesin për riparimin dhe zëvendësimin e pjesëve të dëmtuara dhe pasi merr miratimin nga administratori përgatit listën e materialeve të nevojshme, për t'u zëvendësuar sipas të dhënave teknike të automjetit që ai po riparon dhe e dorëzon atë në magazinë për të marrë pjesët që i duhen. Gjithashtu, ai bën një përllogaritje paraprake të faturës që duhet të paguajë klienti, për të cilën vë në dijeni administratorin dhe zonjën. Pasi ka lexuar instruksionet për mënyrën që duhet të ndjekë për zëvendësimit të pjesëve të automjetit, Arbri zëvendëson pjesët e dëmtuara dhe në fund ai kryen provën e funksionimit përfundimtar për gjendjen teknike të automjetit.

Pas këtij procesi Arbri plotëson dokumentacionin teknik (librin e shërbimeve të automjetit) dhe komunikon me administratorin për përgatitjen e faturës së plotë financiare dhe dorëzimin e automjetit tek klienti.

Në fund të ditës Arbri ndihet i kënaqur për punën e kryer dhe më i motivuar nga administratori për ditën e nesërme të punës.


**Një projekt i Agjencisë Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim SDC**

Schweizerische Eidgenossenschaft
Confédération suisse
Confederazione Svizzera
Confederaziun svizra

Agjencia Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim SDC

**Në partneritet me:**

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E FINANCAVE DHE EKONOMISË

**Zbatuar nga:**

swisscontact

# Shërbime Xhenerike

# Njohuri në lëndët mësimore

| Kërkesa | e ulët ◂ RËNDËSI ▸ e lartë | Komente |
|---|---|---|
| Matematikë: Puna me numra, forma gjeometrike dhe algjebër. | | Njohuri normale në veprimet matematikore dhe në gjeometri. Kryesisht për të kuptuar përmasat dhe për të kryer matjet e nevojshme. |
| Gjuhë e shkruar (shqip): Përdorimi i gjuhës së shkruar si mjet komunikimi në aktivitetet profesionale. | | |
| Gjuhë e folur (shqip): Përdorimi i gjuhës së folur si mjet komunikimi në aktivitetet profesionale. | | |
| Gjuhë e huaj e shkruar: Përdorimi i gjuhës së huaj të shkruar si mjet komunikimi në aktivitetet profesionale. | | Për leximin dhe kuptimin e materialeve udhëzuese dhe informuese. |
| Gjuhë e huaj e folur: Përdorimi i gjuhës së huaj të folur si mjet komunikimi në aktivitetet profesionale. | | |
| Shkencat Natyrore: Aftësitë dhe njohuritë shkencore të nevojshme për të hetuar, zgjidhur problemet, për të marrë vendime, për të mësuar gjatë gjithë jetës, për të drejtuar pyetje dhe për të shuar kuriozitetin e tyre. | | |
| Shoqëria dhe Mjedisi: Kuptimi i proceseve ligjore, politike, ekonomike, sociale, historike, kulturore dhe i çështjeve të ndërlidhura me to. | | |
| Arte: Mësimi, komunikimi, interpretimi dhe zhvillimi i aftësive të tyre artistike për të shprehur veten dhe për të asistuar në ndryshimin artistik dhe kulturore të vetvetes dhe të tjerëve. | | |
| Teknologjia & TIK: Përdorimi i TIK-ut për të kërkuar dhe marrë informacion nga burimet on-line; menaxhimi i projekteve në grupe pune; diskutimi dhe ndarja me të tjerët e gjetjeve të tyre gjatë kërkimit. | | |



# Shërbime Xhenerike

# Kërkesat fizike

| Kërkesa | e ulët ◂ RËNDËSI ▸ e lartë | Komente |
|---|---|---|
| Aftësitë e forta motorike: Përdorimi në shkallë të gjerë dhe të koordinuar i duarve dhe krahëve. | | |
| Aftësitë e buta motorike: Kryerja në masë të vogël e lëvizjeve të koordinuara dhe të kontrolluara të duarve dhe gishtërinjve. | | Për procesin e sistemimit/rregullimit, pas zëvendësimit të pjesëve të makinës. |
| Forca: Përdorimi i fuqisë muskulore, si afatshkurtër dhe impulsive (p.sh. për ngritjen e një arke të rëndë) ose afatgjatë dhe e vazhdueshme (p.sh. puna me trapan në një sipërfaqe mbi kokë). Përdorimi i zgjatur i fuqisë së muskujve gjatë ngritjes së objekteve, përdorimi i mjeteve/veglave ose ecja, vrapimi. | | |
| Aftësi normale për dallimin e ngjyrave: Aftësia për të dalluar të gjitha ngjyrat saktë | | Për leximin e cirkuiteve të thjeshtë, |
| Shqisa e shijes, aromës: Nuhatja dhe/ ose shijimi, p.sh. kur gatuhet, prodhohen aroma; njohja e rreziqeve (p.sh. rrjedhje gazi, ushqime të prishura). | | Nuhatje për njohjen e lëngjeve në automjet. |
| Asnjë lloj alergjie / intolerance: Nuk ka alergji / intolerancë ndaj substancave, si ushqime, pëlhura, etj. | | Të mos ketë alergji nga lëngjet e ndryshme (vaj ose solvent) |
| Puna në temperatura dhe kushte të ndryshme atmosferike: Puna në ambiente jashtë, pavarësisht nga kushtet e motit dhe temperatura. | | |



# Shërbime Xhenerike

# Kompetencat personale dhe sociale

| Kërkesa | e ulët ◂ RËNDËSI ▸ e lartë | Komente |
|---|---|---|
| Qëndrueshmëria emocionale: Menaxhimi i situatave stresuese dhe marrja e masave për të reduktuar stresin në përgjegjësinë e vet. Veprimi i koordinuar dhe i synuar edhe nën presion kohor. |  | Të jetë tip i qetë, që të jetë i përqendruar në zgjidhjen e problemit të shfaqur në automjet. |
| Ritmi i shpejtë ose i pandikueshëm i punës: Puna (ritmi) mund të ndryshojë nga një çast në tjetrin, për shkak të kërkesës spontane dhe urgjente të klientit ose për shkak të ndryshimit dinamik të kushteve të punës. |  | |
| Përqendrim dhe qëndresë e lartë: Përqendrim i lartë në një detyrë që kërkon rezistencë të lartë ndaj shpërqendrimit për një periudhë të zgjatur kohore . |  | |
| Aftësi të forta krijuese dhe aftësi për zgjidhjen e problemeve: Të menduarit për arritjet me qëllim transferimin e një faze aktuale në një fazë të synuar pavarësisht rezistencës e kundërshtive. |  | Të zgjedhë materialet dhe pjesët e duhura për të zgjidhur problemet. |
| Fleksibiliteti në lidhje me vendndodhjen e punës: Aftësia për t'u përshtatur shpejt në vende të ndryshme pune në ambiente brenda ose jashtë. |  | Shpesh kërkohet që shërbimi të ofrohet në ambjente të jashtme ose në ambjente të tjera jashtë ambjentit normal të punës. |
| Fleksibiliteti në lidhje me orarin e punës: Aftësia për t'u përshtatur me orare të ndryshme pune, të cilat mund të ndryshojnë nga orët standarde të punës, si puna gjatë natës ose herët në mëngjes. |  | Për t'u përshtatur me oraret e individëve ose bizneseve të cilat kanë nevojë për shërbimet xhenerike, zakonisht në ambjentet e tyre të punës. |
| Qasje e hapur ndaj personave të tjerë me të cilët kontakton shpesh: Vendosja dhe ruajtja e marrëdhënieve formale, ruajtja e formave të kontaktimit me autoritetet, klientët, partnerët e biznesit, etj. |  | Për të marrë informacion për procese të ndryshme, si prsh: blerje-shitje, metodikat dhe aparaturat e reja etj |
| Kënaqësi nga kontakti i vazhdueshëm, ndjeshmëri/ empati: Qasja empatike tek njerëzit e tjerë me qëllim krijimin dhe ruajtjen e marrëdhënieve. Kjo kërkesë është e rëndësishme në shumë shërbime ku kërkohet kontakt i vazhdueshëm me klientët, si shitja, kujdesi estetik, konsultimi, terapia. |  | Për të arritur rezultate sa më të mira në disa aspekte, si: aspekti teknik, financiar etj |
| Aftësi e spikatur për të punuar në ekip për shkak të bashkëpunimit të ngushtë: Bashkëpunimi brenda ekipit, përkatësisht koordinimi ndërmjet anëtarëve të ekipit, supozimi i besueshëm i nëndetyrave, përgjegjësi e përbashkët për arritjen e qëllimeve. |  | |
| Kompetencat ndërkulturore: Aftësitë njohëse, emocionale dhe të sjelljes që çojnë në komunikim efektiv dhe të përshtatshëm me njerëzit e kulturave të tjera. Ato përfshijnë sjelljet që i përshtaten pritshmërive të një kulture të caktuar, karakteristikat e situatës dhe nivelin e marrëdhënieve midis palëve të përfshira në këtë situatë. Ato gjithashtu marrin parasysh normat e veta kulturore dhe kompromisin më të përshtatshëm dhe më të qetë ndërmjet normave të ndryshme kulturore. |  | |
| Integritet i lartë: Aftësia për të qenë të ndershëm dhe për të patur parime të forta morale, ose ndershmëri morale. Është një zgjedhje personale për të ruajtur standarde të qëndrueshme në sjelljen personale. Në etikë, integriteti konsiderohet si ndershmëria dhe vërtetësia ose saktësia e veprimeve të dikujt. |  | |



# Shërbime Karrocerie



Oltjoni dhe Rubini punojnë në një servis automjetesh, prej rreth 6 muajsh. Në këtë servis, ata ofrojnë kryesisht shërbime karrocerie për automjete të ndryshme. Në rastet më të shumta, ata ndreqin pjesët e jashtme të dëmtuara të automjetit, për t'i rikthyer automjetit pamjen fillestare para dëmtimit.

Oltjoni dhe Rubini janë shumë të kujdesshëm gjatë punës. Ata përdorin veshjet e duhura për të mbrojtur shëndetin e tyre dhe për t'u mbrojtur nga dëmtimet. Për këtë arsye, ata përdorin doreza, maskë fytyre dhe veshje të tjera të nevojshme. Gjithashtu, ata i mirëmbajnë veglat e punës dhe e pastrojnë rregullisht ambjentin përreth.

Në servis vjen një automjet i tipit veturë, i cili kishte pësuar një aksident. Pronari i automjetit ishte i shqetësuar për gjendjen e makinës. Oltjoni fillon të inspektojë automjetin, ndërkohë që Rubini diskuton me klientin dhe mban shënime. Oltjoni e qetëson klientin, duke i thënë se automjeti ka pësuar vetëm disa dëmtime të jashtme, të cilat janë të riparueshme.  Për të kthyer automjetin në gjendjen e mëparshme, duhet të bëhen këto riparime:

1. Zëvendësimi i parakolpit
2. Ndreqja e kofanos (derës së motorit)
3. Lyerje e pjesës së përparme të dëmtuar të automjetit

Rubini i tregon klientit se sa kushton riparimi i automjetit dhe i thotë që automjeti do të jetë gati pas dy ditëve. Pasi klienti pranon dhe largohet nga servisi, Oltjoni dhe Rubini përgatiten për riparimin e automjetit. Në fillim, ata ç'montojnë me kujdes pjesët e dëmtuara të veturës. Më pas, Oltjoni shkon të porosisë një parakolp të ri të përshtatshëm me veturën e dëmtuar, te dyqani pranë servisit, ku gjendjen pjesë ndërrimi për automjete. Ndërkohë, Rubini ndreq kofanon, e cila është shtrembëruar. Ai përdor mjetet e duhura të punës për të drejtuar kofanon dhe për të salduar disa pjesë të cilat janë dëmtuar. Më pas, ai e smerilon dhe e pastron kofanon, për t'a bërë gati për t'u lyer.

Të nesërmen, Oltjoni dhe Rubini bëhen gati për të lyer kofanon dhe parakolpin, duke aplikuar ngjyrat origjinale të veturës. Ata përzgjedhin bojën e duhur dhe mbushin pompën e lyerjes. Me shumë kujdes, ata fillojnë të lyejnë kofanon dhe parakolpin. Pasi kanë aplikuar shtresën e parë të bojës, ata presin pak orë derisa ajo të thahet. Më pas, ata aplikojnë një tjetër shtresë bojë, për t'u siguruar që lyerja të bëhet sa më mirë. Pasi boja është tharë, ata montojnë me kujdes parakolpin dhe kofanon.

Makina duket sërish e re dhe klienti është shumë i kënaqur. Oltjoni dhe Rubini kanë bërë një punë të shkëlqyer.

S4J Aftësi për Punë / Skills for Jobs
Schweizerische Eidgenossenschaft
Confédération suisse
Confederazione Svizzera
Confederaziun svizra
Agjencia Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim SDC
Republika e Shqipërisë
Ministria e Financave dhe Ekonomisë
swisscontact

# Shërbime Karrocerie

# Njohuri në lëndët mësimore

| Kërkesa | e ulët ◂ RËNDËSI ▸ e lartë | Komente |
|---|---|---|
| Matematikë: Puna me numra, forma gjeometrike dhe algjebër. | | Të kryejë kontrollet dhe matjet e nevojshme, të kryejë llogaritje të thjeshta ekonomike |
| Gjuhë e shkruar (shqip): Përdorimi i gjuhës së shkruar si mjet komunikimi në aktivitetet profesionale. | | |
| Gjuhë e folur (shqip): Përdorimi i gjuhës së folur si mjet komunikimi në aktivitetet profesionale. | | |
| Gjuhë e huaj e shkruar: Përdorimi i gjuhës së huaj të shkruar si mjet komunikimi në aktivitetet profesionale. | | |
| Gjuhë e huaj e folur: Përdorimi i gjuhës së huaj të folur si mjet komunikimi në aktivitetet profesionale. | | |
| Shkencat Natyrore: Aftësitë dhe njohuritë shkencore të nevojshme për të hetuar, zgjidhur problemet, për të marrë vendime, për të mësuar gjatë gjithë jetës, për të drejtuar pyetje dhe për të shuar kuriozitetin e tyre. | | |
| Shoqëria dhe Mjedisi: Kuptimi i proceseve ligjore, politike, ekonomike, sociale, historike, kulturore dhe i çështjeve të ndërlidhura me to. | | |
| Arte: Mësimi, komunikimi, interpretimi dhe zhvillimi i aftësive të tyre artistike për të shprehur veten dhe për të asistuar në ndryshimin artistik dhe kulturore të vetvetes dhe të tjerëve. | | |
| Teknologjia & TIK: Përdorimi i TIK-ut për të kërkuar dhe marrë informacion nga burimet on-line; menaxhimi i projekteve në grupe pune; diskutimi dhe ndarja me të tjerët e gjetjeve të tyre gjatë kërkimit. | | |



# Shërbime Karrocerie

# Kërkesat fizike

| Kërkesa | e ulët ◂ RËNDËSI ▸ e lartë | Komente |
| --- | --- | --- |
| Aftësitë e forta motorike: Përdorimi në shkallë të gjerë dhe të koordinuar i duarve dhe krahëve. | | Të kryejë punime të riparimit të pjesëve të karrocerive |
| Aftësitë e buta motorike: Kryerja në masë të vogël e lëvizjeve të koordinuara dhe të kontrolluara të duarve dhe gishtërinjve. | | |
| Forca: Përdorimi i fuqisë muskulore, si afatshkurtër dhe impulsive (p.sh. për ngritjen e një arke të rëndë) ose afatgjatë dhe e vazhdueshme (p.sh. puna me trapan në një sipërfaqe mbi kokë). Përdorimi i zgjatur i fuqisë së muskujve gjatë ngritjes së objekteve, përdorimi i mjeteve/veglave ose ecja, vrapimi. | | Gjatë kryerjes së zëvendësimit të pjesëve të dëmtuara të karrocerive të mjeteve të transportit. |
| Aftësi normale për dallimin e ngjyrave: Aftësia për të dalluar të gjitha ngjyrat saktë | | Për njohjen e ngjyrave të bojrave që përdoren për lyerjen e karrocerisë |
| Shqisa e shijes, aromës: Nuhatja dhe/ ose shijimi, p.sh. kur gatuhet, prodhohen aroma; njohja e rreziqeve (p.sh. rrjedhje gazi, ushqime të prishura). | | |
| Asnjë lloj alergjie / intolerance: Nuk ka alergji / intolerancë ndaj substancave, si ushqime, pëlhura, etj. | | Përshembull për bojrat, të cilat janë përbërje kimikatesh. |
| Puna në temperatura dhe kushte të ndryshme atmosferike: Puna në ambiente jashtë, pavarësisht nga kushtet e motit dhe temperatura. | | Punohet në ambjente të mbyllura por edhe në ambjente të hapura. |



# Shërbime Karrocerie

# Kompetencat personale dhe sociale

| **Kërkesa** | **e ulët ◂ RËNDËSI ▸ e lartë** | **Komente** |
|---|---|---|
| Qëndrueshmëria emocionale: Menaxhimi i situatave stresuese dhe marrja e masave për të reduktuar stresin në përgjegjësinë e vet. Veprimi i koordinuar dhe i synuar edhe nën presion kohor. | | |
| Ritmi i shpejtë ose i pandikueshëm i punës: Puna (ritmi) mund të ndryshojë nga një çast në tjetrin, për shkak të kërkesës spontane dhe urgjente të klientit ose për shkak të ndryshimit dinamik të kushteve të punës. | | |
| Përqendrim dhe qëndresë e lartë: Përqendrim i lartë në një detyrë që kërkon rezistencë të lartë ndaj shpërqendrimit për një periudhë të zgjatur kohore . | | Për aplikimin e duhur të bojës gjatë procesit të lyerjes. |
| Aftësi të forta krijuese dhe aftësi për zgjidhjen e problemeve: Të menduarit për arritjet me qëllim transferimin e një faze aktuale në një fazë të synuar pavarësisht rezistencës e kundërshtive. | | |
| Fleksibiliteti në lidhje me vendndodhjen e punës: Aftësia për t'u përshtatur shpejt në vende të ndryshme pune në ambiente brenda ose jashtë. | | |
| Fleksibiliteti në lidhje me orarin e punës: Aftësia për t'u përshtatur me orare të ndryshme pune, të cilat mund të ndryshojnë nga orët standarde të punës, si puna gjatë natës ose herët në mëngjes. | | |
| Qasje e hapur ndaj personave të tjerë me të cilët kontakton shpesh: Vendosja dhe ruajtja e marrëdhënieve formale, ruajtja e formave të kontaktimit me autoritetet, klientët, partnerët e biznesit, etj. | | |
| Kënaqësi nga kontakti i vazhdueshëm, ndjeshmëri/empati: Qasja empatike tek njerëzit e tjerë me qëllim krijimin dhe ruajtjen e marrëdhënieve. Kjo kërkesë është e rëndësishme në shumë shërbime ku kërkohet kontakt i vazhdueshëm me klientët, si shitja, kujdesi estetik, konsultimi, terapia. | | Zakonisht kontakt i drejtpërdrejtë me klientin, për të siguruar kuptueshmërinë e proceseve dhe nevojat specifike të klientit. |
| Aftësi e spikatur për të punuar në ekip për shkak të bashkëpunimit të ngushtë: Bashkëpunimi brenda ekipit, përkatësisht koordinimi ndërmjet anëtarëve të ekipit, supozimi i besueshëm i nëndetyrave, përgjegjësi e përbashkët për arritjen e qëllimeve. | | |
| Kompetencat ndërkulturore: Aftësitë njohëse, emocionale dhe të sjelljes që çojnë në komunikim efektiv dhe të përshtatshëm me njerëzit e kulturave të tjera. Ato përfshijnë sjelljet që i përshtaten pritshmërive të një kulture të caktuar, karakteristikat e situatës dhe nivelin e marrëdhënieve midis palëve të përfshira në këtë situatë. Ato gjithashtu marrin parasysh normat e veta kulturore dhe kompromisin më të përshtatshëm dhe më të qetë ndërmjet normave të ndryshme kulturore. | | |
| Integritet i lartë: Aftësia për të qenë të ndershëm dhe për të patur parime të forta morale, ose ndershmëri morale. Është një zgjedhje personale për të ruajtur standarde të qëndrueshme në sjellјen personale. Në etikë, integriteti konsiderohet si ndershmëria dhe vërtetësia ose saktësia e veprimeve të dikujt. | | |



# Shërbime në Mjetet e Rënda të Transportit

Aftësi për Punë / Skills for Jobs



Marseli punon në një servis të specializuar për riparimin dhe mirëmbajtjen e mjeteve të rënda të transportit. Servisi ka ambjente të mëdha dhe disa punonjës të tjerë, ndër të cilët një inxhinier mekanik. Servisi ka marrëveshje me disa kompani ndërtimi, të cilat sjellin makinat e ndryshme të transportit për diagnostifikim dhe riparim.

Inxhinieri lajmëron Marselin se për pak minuta mbërrin një kamion me ngarkesë të rëndë vetëshkarkues. Ai i thotë Marselit të bëjë gati veglat e punës, instruksionet përkatëse dhe të lexojë raportin teknik për t'u njohur me shërbimet e mëparshme që i janë bërë këtij kamioni në servisin e tyre. Marseli bën gati veglat matëse dhe të kontrollit, kompjuterin, elektrokompresorin dhe disa vegla të tjera pune. Më pas lexon instruksionet përkatëse dhe raportin teknik, që i sugjeroi inxhinieri. Ndërkohë, mbërrin kamioni.

Fillimisht, Marseli kryen një inspektim vizual, e më pas lidh kompjuterin për të diagnostifikuar kamionin me programin përkatës. Më pas, ai përdor veglat e tjera për të kontrolluar disa pjesë xhenerike të kamionit. Gjithashtu, ai kontrollon mekanizmin e ngarkesës vetëshkarkuese. Nga diagnostifikimi, Marseli zbulon tre probleme:

a. Sistemi i frenimit nuk punon sipas parametrave.
b. Një nga fenerët është djegur.
c. Ngarkesa e rëndë ulet dhe ngrihet shumë ngadalë.

Marseli njofton inxhinierin për defektet që ka gjetur dhe së bashku punojnë për të gjetur arsyet e këtyre defekteve. Nga vrojtimet e detajuara, ata kuptojnë se sistemi i frenimit ka nevojë për alkohol dhe se zinxhiri kryesor që mundëson lëvizjen për shkarkimin e ngarkesës, është liruar dhe duhet të shtrëngohet.
Marseli merr në magazinë alkoholin e frenave, një llambë të re për të zëvendësuar atë të djegurën dhe mjetet e punës për të rregulluar zinxhirin.

Pasi bën zëvendësimet dhe montimin e pjesëve të kamionit, Marseli sigurohet që ka bërë punë të mirë duke bërë provat teknike. Më pas, ai plotëson raportin teknik, përgatit faturën dhe sistemon veglat e punës. Ai bëhet gati të diagnostifikojë një tjetër makinë të rëndë transporti që sapo ka mbërritur në servis.

**Një projekt i Agjencisë Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim SDC**

Schweizerische Eidgenossenschaft
Confédération suisse
Confederazione Svizzera
Confederaziun svizra

Agjencia Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim SDC

**Në partneritet me:**

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E FINANCAVE DHE EKONOMISË

**Zbatuar nga:**

swisscontact

# Shërbime në Mjetet e Rënda të Transportit

# Njohuri në lëndët mësimore

| Kërkesa | e ulët ◂ RËNDËSI ▸ e lartë | Komente |
|---|---|---|
| Matematikë: Puna me numra, forma gjeometrike dhe algjebër. |  | Për veprime matematikore dhe për skicimin me përmasat e duhura të detaleve. |
| Gjuhë e shkruar (shqip): Përdorimi i gjuhës së shkruar si mjet komunikimi në aktivitetet profesionale. |  | Të lexojë, interpretojë dhe plotësojë dokumentacionin teknik dhe financiar për shërbimet në mjetet e rënda të transportit. |
| Gjuhë e folur (shqip): Përdorimi i gjuhës së folur si mjet komunikimi në aktivitetet profesionale. |  | |
| Gjuhë e huaj e shkruar: Përdorimi i gjuhës së huaj të shkruar si mjet komunikimi në aktivitetet profesionale. |  | Për leximin dhe kuptimin e udhëzuesve dhe manualeve të ndryshëm. |
| Gjuhë e huaj e folur: Përdorimi i gjuhës së huaj të folur si mjet komunikimi në aktivitetet profesionale. |  | |
| Shkencat Natyrore: Aftësitë dhe njohuritë shkencore të nevojshme për të hetuar, zgjidhur problemet, për të marrë vendime, për të mësuar gjatë gjithë jetës, për të drejtuar pyetje dhe për të shuar kuriozitetin e tyre. |  | |
| Shoqëria dhe Mjedisi: Kuptimi i proceseve ligjore, politike, ekonomike, sociale, historike, kulturore dhe i çështjeve të ndërlidhura me to. |  | |
| Arte: Mësimi, komunikimi, interpretimi dhe zhvillimi i aftësive të tyre artistike për të shprehur veten dhe për të asistuar në ndryshimin artistik dhe kulturore të vetvetes dhe të tjerëve. |  | |
| Teknologjia & TIK: Përdorimi i TIK-ut për të kërkuar dhe marrë informacion nga burimet on-line; menaxhimi i projekteve në grupe pune; diskutimi dhe ndarja me të tjerët e gjetjeve të tyre gjatë kërkimit. |  | |



# Shërbime në Mjetet e Rënda të Transportit

# Kërkesat fizike

| Kërkesa | e ulët ◂ RËNDËSI ▸ e lartë | Komente |
|---|---|---|
| Aftësitë e forta motorike: Përdorimi në shkallë të gjerë dhe të koordinuar i duarve dhe krahëve. | | Për përdorimin e mjeteve, makinave dhe pajisjeve ndihmëse gjatë punës |
| Aftësitë e buta motorike: Kryerja në masë të vogël e lëvizjeve të koordinuara dhe të kontrolluara të duarve dhe gishtërinjve. | | Për procesin e sistemimit/rregullimit, pas zëvendësimit të pjesëve të makinës. |
| Forca: Përdorimi i fuqisë muskulore, si afatshkurtër dhe impulsive (p.sh. për ngritjen e një arke të rëndë) ose afatgjatë dhe e vazhdueshme (p.sh. puna me trapan në një sipërfaqe mbi kokë). Përdorimi i zgjatur i fuqisë së muskujve gjatë ngritjes së objekteve, përdorimi i mjeteve/veglave ose ecja, vrapimi. | | |
| Aftësi normale për dallimin e ngjyrave: Aftësia për të dalluar të gjitha ngjyrat saktë | | |
| Shqisa e shijes, aromës: Nuhatja dhe/ ose shijimi, p.sh. kur gatuhet, prodhohen aroma; njohja e rreziqeve (p.sh. rrjedhje gazi, ushqime të prishura). | | Nëpërmjet zhurmës, mund të dallohet keq-funksionimi i një nga pjesëve të mjetit; ndaj dëgjimi i mirë ndihmon në zbulimin e problematikës. |
| Asnjë lloj alergjie / intolerance: Nuk ka alergji / intolerancë ndaj substancave, si ushqime, pëlhura, etj. | | Të mos ketë alergji nga dorezat apo materialet me përbërje lateks. |
| Puna në temperatura dhe kushte të ndryshme atmosferike: Puna në ambiente jashtë, pavarësisht nga kushtet e motit dhe temperatura. | | |



# Shërbime në Mjetet e Rënda të Transportit

# Kompetencat personale dhe sociale

| **Kërkesa** | **e ulët ◂ RËNDËSI ▸ e lartë** | **Komente** |
|---|---|---|
| Qëndrueshmëria emocionale: Menaxhimi i situatave stresuese dhe marrja e masave për të reduktuar stresin në përgjegjësinë e vet. Veprimi i koordinuar dhe i synuar edhe nën presion kohor. |  | Të jetë tip i qetë, që të jetë i përqendruar në zgjidhjen e problemit të shfaqur në automjet. |
| Ritmi i shpejtë ose i pandikueshëm i punës: Puna (ritmi) mund të ndryshojë nga një çast në tjetrin, për shkak të kërkesës spontane dhe urgjente të klientit ose për shkak të ndryshimit dinamik të kushteve të punës. |  | |
| Përqendrim  dhe qëndresë e lartë: Përqendrim i lartë në një detyrë që kërkon rezistencë të lartë ndaj shpërqendrimit për një periudhë të zgjatur kohore . |  | |
| Aftësi të forta krijuese dhe aftësi për zgjidhjen e problemeve: Të menduarit për arritjet me qëllim transferimin e një faze aktuale në një fazë të synuar pavarësisht rezistencës e kundërshtive. |  | Të zgjedhë materialet dhe pjesët e duhura për të zgjidhur problemet. |
| Fleksibiliteti në lidhje me vendndodhjen e punës: Aftësia për t'u përshtatur shpejt në vende të ndryshme pune në ambiente brenda ose jashtë. |  | |
| Fleksibiliteti në lidhje me orarin e punës: Aftësia për t'u përshtatur me orare të ndryshme pune, të cilat mund të ndryshojnë nga orët standarde të punës, si puna gjatë natës ose herët në mëngjes. |  | Për t'u përshtatur me oraret e individëve ose bizneseve të cilat kanë nevojë për shërbimet xhenerike, zakonisht në ambjentet e tyre të punës. |
| Qasje e hapur ndaj personave të tjerë me të cilët kontaktkon shpesh: Vendosja dhe ruajtja e marrëdhënieve formale, ruajtja e formave të kontaktimit me autoritetet, klientët, partnerët e biznesit, etj. |  | |
| Kënaqësi nga kontakti  i vazhdueshëm, ndjeshmëri/empati: Qasja empatike tek njerëzit e tjerë me qëllim krijimin dhe ruajtjen e marrëdhënieve. Kjo kërkesë është e rëndësishme në shumë shërbime ku kërkohet kontakt i vazhdueshëm me klientët, si shitja, kujdesi estetik, konsultimi, terapia. |  | |
| Aftësi e spikatur për të punuar në ekip për shkak të bashkëpunimit të ngushtë: Bashkëpunimi brenda ekipit, përkatësisht koordinimi ndërmjet anëtarëve të ekipit, supozimi i besueshëm i nëndetyrave, përgjegjësi e përbashkët për arritjen e qëllimeve. |  | Për të arritur rezultate sa më të mira në disa aspekte, si: aspekti teknik, financiar etj |
| Kompetencat ndërkulturore: Aftësitë njohëse, emocionale dhe të sjelljes që çojnë në komunikim efektiv dhe të përshtatshëm me njerëzit e kulturave të tjera. Ato përfshijnë sjelljet që i përshtaten pritshmërive të një kulture të caktuar, karakteristikat e situatës dhe nivelin e marrëdhënieve midis palëve të përfshira në këtë situatë. Ato gjithashtu marrin parasysh normat e veta kulturore dhe kompromisin më të përshtatshëm dhe më të qetë ndërmjet normave të ndryshme kulturore. |  | |
| Integritet i lartë: Aftësia për të qenë të ndershëm dhe për të patur parime të forta morale, ose ndershmëri morale. Është një zgjedhje personale për të ruajtur standarde të qëndrueshme në sjelljen personale. Në etikë, integriteti konsiderohet si ndershmëria dhe vërtetësia ose saktësia e veprimeve të dikujt. |  | |



# Panele Diellore dhe Hidraulike

S4J
Aftësi për Punë / Skills for Jobs



Sot, Sidita duhet të ndihmojë mbikqyrësin e saj për të instaluar një sistem të ri ngrohjeje në një apartament. Ajo shikon dokumentacionin dhe skicën 3D në kompjuter. Bazuar në këtë dokumentacion, Sidita duhet të përgatisë listën e materialeve të nevojshme. Prandaj ajo duhet të zgjedhë tubat dhe armaturat për sistemin e ngrohjes. Sidita nuk është e sigurtë se cili lloj tubi është më i përshtatshëm sipas kushteve specifike, prandaj i kërkon mbikëqyrësit të saj që t'ia shpjegojë. Së bashku ata zgjedhin llojin e tubit që i përshtatet pritshmërive të klientit rreth çmimit por gjithashtu edhe kushteve të dhomave. Pas përfundimit të listës ajo duhet të porosisë materialin e nevojshëm.

Më pas Sidita dhe mbikqyrësi i saj nisen për të shtruar tubacionet për furnizimin me ujë të nxehtë dhe të ftohtë në një kantier ndërtimi. Sidita nuk e ka bërë këtë punë asnjëherë më parë, prandaj ajo dëgjon me vëmendje shpjegimin e mbikqyrësit të saj. I kujtohet që ka mësuar shumë gjëra për ligjet hidroteknike në shkollë, si për shembull ligji i Arkimedit për hidraulikën. Ajo është e kënaqur që tani mund t'i zbatojë këto njohuri edhe në praktikë.

Ai i pret tubat metalikë me gjatësinë e specifikuar, i përkul sipas formës së dëshiruar, pret fijet dhe i bashkon pjesët e ndara të tubave me njëra-tjetrën. Ajo hap vrima në mure me anë të një çekiçi dhe dalte ose me anë të një trapani me goditje. Kjo punë është e lodhshme, por asaj i pëlqen.

Mbikqyrësi i saj i shpjegon se si të punojë me kujdes dhe si të mbrojë veten dhe të tjerët duke ndjekur rregullat e sigurisë, duke marrë masat parandaluese ndaj aksidenteve dhe duke veshur pajisjet mbrojtëse personale. Në fund, ai i demonstron Siditës se si të izolojë sistemin e tubave kundër humbjes së nxehtësisë. Pas kësaj, ajo mund ta vërë sistemin në punë. Ata kontrollojnë së bashku nëse sistemi po punon ashtu si duhet, nëse të gjitha tubacionet janë të shtrënguara mirë dhe nëse cilësimet e temperaturës janë të sakta. Ndërkohë që Sidita pastron pajisjet e punës, ajo vazhdon të dëgjojë mbikqyrësin e saj, i cili po i shpjegon klientit mënyrën e funksionimit të sistemit.

**Një projekt i Agjencisë Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim SDC**

Schweizerische Eidgenossenschaft
Confédération suisse
Confederazione Svizzera
Confederaziun svizra

**Agjencia Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim SDC**

**Në partneritet me:**

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E FINANCAVE DHE EKONOMISË

**Zbatuar nga:**

swisscontact

# Panele Diellore dhe Hidraulike

# Kërkesat e shkollës

| Kërkesa | e ulët ◂ RËNDËSI ▸ e lartë | Komente |
|---|---|---|
| Matematikë: Puna me numra, forma gjeometrike dhe algjebër. | | Llogaritjet hidraulike. |
| Gjuhë e shkruar (shqip): Përdorimi i gjuhës së shkruar si mjet komunikimi në aktivitetet profesionale. | | Artikulimi i fjalëve. |
| Gjuhë e folur (shqip): Përdorimi i gjuhës së folur si mjet komunikimi në aktivitetet profesionale. | | Artikulimi i mirë. |
| Gjuhë e huaj e shkruar: Përdorimi i gjuhës së huaj të shkruar si mjet komunikimi në aktivitetet profesionale. | | Ndihmon në komunikim. |
| Gjuhë e huaj e folur: Përdorimi i gjuhës së huaj të folur si mjet komunikimi në aktivitetet profesionale. | | Komunikimi |
| Shkencat Natyrore: Aftësitë dhe njohuritë shkencore të nevojshme për të hetuar, zgjidhur problemet, për të marrë vendime, për të mësuar gjatë gjithë jetës, për të drejtuar pyetje dhe për të shuar kuriozitetin e tyre. | | Njohuri të përgjithshme. |
| Shoqëria dhe Mjedisi: Kuptimi i proceseve ligjore, politike, ekonomike, sociale, historike, kulturore dhe i çështjeve të ndërlidhura me to. | | |
| Arte: Mësimi, komunikimi, interpretimi dhe zhvillimi i aftësive të tyre artistike për të shprehur veten dhe për të asistuar në ndryshimin artistik dhe kulturore të vetvetes dhe të tjerëve. | | |
| Teknologjia & TIK: Përdorimi i TIK-ut për të kërkuar dhe marrë informacion nga burimet on-line; menaxhimi i projekteve në grupe pune; diskutimi dhe ndarja me të tjerët e gjetjeve të tyre gjatë kërkimit. | | Hedhja e diagrameve të të dhënave. |



# Panele Diellore dhe Hidraulike

# Kërkesat fizike

| Kërkesa | e ulët ◂ RËNDËSI ▸ e lartë | Komente |
|---|---|---|
| Aftësitë e forta motorike: Përdorimi në shkallë të gjerë dhe të koordinuar i duarve dhe krahëve. | | Punë artizanale, instalimi i pajisjeve. |
| Aftësitë e buta motorike: Kryerja në masë të vogël e lëvizjeve të koordinuara dhe të kontrolluara të duarve dhe gishtërinjve. | | Instalimi i pajisjeve. |
| Forca: Përdorimi i fuqisë muskulore, si afatshkurtër dhe impulsive (p.sh. për ngritjen e një arke të rëndë) ose afatgjatë dhe e vazhdueshme (p.sh. puna me trapan në një sipërfaqe mbi kokë). Përdorimi i zgjatur i fuqisë së muskujve gjatë ngritjes së objekteve, përdorimi i mjeteve/veglave ose ecja, vrapimi. | | Pajisje të rënda. |
| Aftësi normale për dallimin e ngjyrave: Aftësia për të dalluar të gjitha ngjyrat saktë | | |
| Shqisa e shijes, aromës: Nuhatja dhe/ ose shijimi, p.sh. kur gatuhet, prodhohen aroma; njohja e rreziqeve (p.sh. rrjedhje gazi, ushqime të prishura). | | |
| Asnjë lloj alergjie / intolerance: Nuk ka alergji / intolerancë ndaj substancave, si ushqime, pëlhura, etj. | | |
| Puna në temperatura dhe kushte të ndryshme atmosferike: Puna në ambiente jashtë, pavarësisht nga kushtet e motit dhe temperatura. | | |



# Panele Diellore dhe Hidraulike

# Kompetencat personale dhe sociale

| Kërkesa | e ulët ◂ RËNDËSI ▸ e lartë | Komente |
|---|---|---|
| Qëndrueshmëria emocionale: Menaxhimi i situatave stresuese dhe marrja e masave për të reduktuar stresin në përgjegjësinë e vet. Veprimi i koordinuar dhe i synuar edhe nën presion kohor. |  | Situatat e pakëndshme duhet të trajtohen me kujdes. |
| Ritmi i shpejtë ose i pandikueshëm i punës: Puna (ritmi) mund të ndryshojë nga një çast në tjetrin, për shkak të kërkesës spontane dhe urgjente të klientit ose për shkak të ndryshimit dinamik të kushteve të punës. |  | |
| Përqendrim dhe qëndresë e lartë: Përqendrim i lartë në një detyrë që kërkon rezistencë të lartë ndaj shpërqendrimit për një periudhë të zgjatur kohore . |  | Përqendrim i lartë në çdo hap të punës për të parandaluar aksidentet. |
| Aftësi të forta krijuese dhe aftësi për zgjidhjen e problemeve: Të menduarit për arritjet me qëllim transferimin e një faze aktuale në një fazë të synuar pavarësisht rezistencës e kundërshtive. |  | Gjetja e zgjidhjeve të përshtatshme brenda një kuadri financiar të caktuar. |
| Fleksibiliteti në lidhje me vendndodhjen e punës: Aftësia për t'u përshtatur shpejt në vende të ndryshme pune në ambiente brenda ose jashtë. |  | |
| Fleksibiliteti në lidhje me orarin e punës: Aftësia për t'u përshtatur me orare të ndryshme pune, të cilat mund të ndryshojnë nga orët standarde të punës, si puna gjatë natës ose herët në mëngjes. |  | Sa më i madh fleksibiliteti, aq mëi madh suksesi në profesion. |
| Qasje e hapur ndaj personave të tjerë me të cilët kontakton shpesh: Vendosja dhe ruajtja e marrëdhënieve formale, ruajtja e formave të kontaktimit me autoritetet, klientët, partnerët e biznesit, etj. |  | |
| Kënaqësi nga kontakti i vazhdueshëm, ndjeshmëri, empati: Qasja empatike tek njerëzit e tjerë me qëllim krijimin dhe ruajtjen e marrëdhënieve. Kjo kërkesë është e rëndësishme në shumë shërbime ku kërkohet kontakt i vazhdueshëm me klientët, si shitja, kujdesi estetik, konsultimi, terapia. |  | |
| Aftësi e spikatur për të punuar në ekip për shkak të bashkëpunimit të ngushtë: Bashkëpunimi brenda ekipit, përkatësisht koordinimi ndërmjet anëtarëve të ekipit, supozimi i besueshëm i nëndetyrave, përgjegjësi e përbashkët për arritjen e qëllimeve. |  | Çdo anëtar i ekipit duhet të bëjë punën e tij/saj pa u ankuar. |
| Kompetencat ndërkulturore: Aftësitë njohëse, emocionale dhe të sjelljes që çojnë në komunikim efektiv dhe të përshtatshëm me njerëzit e kulturave të tjera. Ato përfshijnë sjelljet që i përshtaten pritshmërive të një kulture të caktuar, karakteristikat e situatës dhe nivelin e marrëdhënieve midis palëve të përfshira në këtë situatë. Ato gjithashtu marrin parasysh normat e veta kulturore dhe kompromisin më të përshtatshëm dhe më të qetë ndërmjet normave të ndryshme kulturore. |  | |
| Integritet i lartë: Aftësia për të qenë të ndershëm dhe për të patur parime të forta morale, ose ndershmëri morale. Është një zgjedhje personale për të ruajtur standarde të qëndrueshme në sjelljen personale. Në etikë, integriteti konsiderohet si ndershmëria dhe vërtetësia ose saktësia e veprimeve të dikujt. |  | Ndershmëria dhe integriteti ndaj klientëve. |






**Qëllimi dhe objektivat e profileve të kërkesave**

Kërkesat dhe përshkrimet e kërkesave janë përgatitur për t'u dhënë të rinjve një pasqyrë realiste të kërkesave të shkollës në profesionin e dëshiruar dhe për t'i inkurajuar ata që të angazhohen me veten dhe me profesionin. Ato tregojnë kërkesat kryesore në lidhje me kompetencat e fituara në shkollë, kërkesat fizike dhe kompetencat personale dhe sociale dhe çojnë në një reflektim për dy pyetje:

- A mund t'i plotësoj këto kërkesa?
- A dua t'i plotësoj ato?

Sa më mirë që të njihen këto kërkesa paraprakisht, aq më e lehtë do të jetë për të rinjtë për t'i kuptuar ato. Të rinjtë do të kenë nevojë për ndihmën e personave të rëndësishëm mbështetës:

- Prindërit
- Mësuesit
- Këshilluesit e karrierës

Profilet e kërkesave janë një mjet orientimi në procesin e zgjedhjes së karrierës, megjithatë, ato nuk janë një instrument përzgjedhjeje. Ato synojnë të anagazhojnë të rinjtë në zgjedhjen e karrierës që herët si edhe të shqyrtojnë kërkesat dhe aftësitë e të rinjve në mënyrë sistematike dhe të hershme.

Ata duhet:
- t'i ndihmojnë ata të vlerësojnë nëse karriera e zgjedhur është realiste;
- t'i tregojnë atyre se si mund të përdoren ato që kanë mësuar në shkollë në formimin profesional, në mënyrë që t'i motivojnë ata;
- të mbështesin nxënësit në një fazë të hershme në mënyrë që ata të mund të përgatiten në mënyrë optimale për kalimin drejt formimit profesional.

**Një projekt i Agjencisë Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim SDC**

Schweizerische Eidgenossenschaft
Confédération suisse
Confederazione Svizzera
Confederaziun svizra

Agjencia Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim SDC

**Në partneritet me:**

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E FINANCAVE DHE EKONOMISË

**Zbatuar nga:**

swisscontact

## Struktura e përfaqësimit të kërkesave

Një përfaqësim i kërkesës përbëhet nga dy elemente kryesore.







Në profilin e kërkesave, ilustrohen shkolla dhe kërkesat fizike, si dhe kompetencat personale dhe sociale të një formimi profesional. Profili përmban gjithsej 27 elemente për tre fushat e kompetencës.

Tek përshkrimi, paraqitet një situatë tipike pune e cila tregon se ku nevojiten aftësitë e marra në shkollë në jetën e përditshme profesionale. Përveç kësaj, paraqiten informacione specifike për punën (siç janë kushtet e qasjes, shkollat ku ofrohet ky lloj formimi, vendet tipike të punës, pagën, mundësitë për zhvillimin e karrierës).

## Leximi dhe kuptimi i profilit dhe përshkrimit të kërkesave

Nga një profil i kërkesave mund të përftohen informacione të ndryshme:
- Rëndësia e elementit të kërkesave individuale për formimin profesional specifik, të vlerësuar nga jo të rëndësishme në shumë të rëndësishme.
- Kompleksiteti dhe niveli i një elementi të rëndësishëm të kërkesave shpjegohet në rreshtin e komenteve të profilit.
- Një situatë tipike profesionale gjatë praktikës profesionale ku janë përdorur elementet e kërkesave që janë shenjuar si të rëndësishme.

## Përdorime të mundshme gjatë procesit të zgjedhjes së karrierës

Në përgjithësi, profilet mund të përdoren si bazë për diskutim dhe angazhim (dmth. me nxënësit, prindërit, personat përgjegjës për formimin profesional etj.). Vëmendje e madhe i kushtohet atyre elementeve të profilit të kërkesave, të shenjuara si të rëndësishme dhe shumë të rëndësishme. Profilet e kërkesave mund të përdoren për orientimin dhe informimin fillestar në një fazë të hershme të zgjedhjes së karrierës. Nga ana tjetër, në një fazë të avancuar të zgjedhjes së karrierës ato u shërbejnë nxënësve për eksplorimin e kërkesave të profesioneve konkrete të dëshiruara.

Profilet dhe përshkrimet tregojnë edhe mënyrën se si ajo që është mësuar në shkollë do të jetë e rëndësishme në jetën e mëvonshme profesionale. Nxënësit duhet të kuptojnë se cilat kompetenca shkollore iu nevojiten për të qenë të suksesshëm në profesionin e tyre të dëshiruar. Kjo duhet t'i motivojë ata që të përgatiten mirë për hyrjen e tyre në karrierë. Profilet në këtë mënyrë ofrojnë një tabllo të rëndësishme të botës së punës.




Zgjedhja e karrierës është një hap i rëndësishëm për të cilin të rinjtë kanë nevojë për mbështetjen e prindërve, mësuesve të tyre dhe këshilluesve të karrierës. Megjithatë, në fund të ditës, një vendim i tillë në lidhje me karrierën duhet të merret gjithmonë nga vetë të rinjtë.

Faktorët që kontribuojnë në suksesin dhe kënaqësinë e dikujt për një kualifikim të caktuar profesional janë të ndryshëm. Formimi profesional që zgjedh fëmija juaj duhet t'i përshtatet atij ose asaj sa më shumë që të jetë e mundur. Profesionet ndryshojnë sa i takon kërkesave të tyre. Në profesione të caktuara, për shembull, gjeometria është shumë e kërkuar. Në profesione të tjera duhet të lexoni dhe kuptoni tekste shumë të vështira. Edhe të rinjtë ndryshojnë shumë nga njëri-tjetri sa i takon aftësive të tyre. Profilet e kërkesave tregojnë se cilat janë kompetencat minimale arsimore, fizike, personale dhe sociale që të rinjtë duhet të kenë për një kualifikim të caktuar profesional. Profilet e kërkesave janë një mjet orientues për të rinjtë të cilat janë përgatitur në bashkëpunim të ngushtë midis industrisë dhe shkollave. Si të tilla ato pasqyrojnë kërkesat reale të ekonomisë.

Të rinjtë mund të studiojnë kërkesat e shkollës për profesionet e tyre të dëshiruara në bazë të profileve. Është e rëndësishme që ata të kenë kuptuar më parë dëshirat dhe interesat e tyre dhe të kenë krijuar një ide se çfarë munden dhe dëshirojnë të arrijnë. Pas kësaj ata duhet të informohen për atë që kërkohet në profesionet e tyre të dëshiruara. Si prindër ju i shoqëroni ata gjatë këtij procesi. Ju mund ta inkurajoni fëmijën tuaj që të merret me interesat dhe aftësitë e tij / saj. Profilet dhe përshkrimet e kërkesave të profesioneve të dëshiruara mund të jenë baza e diskutimeve të përbashkëta.

**Një projekt i Agjencisë Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim SDC**

Schweizerische Eidgenossenschaft
Confédération suisse
Confederazione Svizzera
Confederaziun svizra

Agjencia Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim SDC

**Në partneritet me:**

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E FINANCAVE DHE EKONOMISË

**Zbatuar nga:**

swisscontact

## Struktura e përfaqësimit të kërkesave

Përfaqësimi i kërkesave përbëhet nga dy elemente kryesore.




Në profilin e kërkesave, ilustrohen shkolla dhe kërkesat fizike, si dhe kompetencat personale dhe sociale të një formimi profesional. Profili përmban gjithsej 27 elemente për tre fushat e kompetencës.




Tek përshkrimi, paraqitet një situatë tipike pune e cila tregon se ku nevojiten aftësitë e marra në shkollë në jetën e përditshme profesionale. Përveç kësaj, paraqiten informacione specifike për punën (siç janë kushtet e qasjes, shkollat ku ofrohet ky lloj formimi, vendet tipike të punës, pagën, mundësitë për zhvillimin e karrierës).

## Propozimi për diskutimin e përbashkët

Bisedoni me fëmijën tuaj në lidhje me profilin dhe përshkrimin.
Përqendrohuni tek elementet e rëndësishme të kërkesave:
- A përputhet profili me pritshmëritë e fëmijës suaj?
- A ka treguar fëmija juaj interes dhe entuziazëm për këto elemente të kërkesave në të shkuarën?
- Si i vlerëson fëmija juaj aftësitë e veta në këto lëndë? Cili është perceptimi juaj në lidhje me këtë?
- Sa i motivuar është fëmija juaj që të vazhdojë të punojë në këtë lëndë/fushë?

Në këtë kontekst, motivimi i të rinjve është i rëndësishëm. Mangësitë jo domosdoshmërisht duhet të jenë pengesa të pakapërcyeshme, por ato iu tregojnë të rinjve ku duhet të punojnë më shumë. Edhe nëse një i ri i tejkalon qartazi kërkesat e një profesioni në disa pika të caktuara, kjo nuk do të thotë që profesioni në fjalë nuk është i duhuri për të. Kërkesat e paraqitura këtu tregojnë se çfarë duhet të paktën të sjellin me vete. Tejkalimi i kërkesave mund të jetë një avantazh i madh në profesion.

Flisni edhe për përshkrimin e kërkesave. Pyeteni fëmijën tuaj se çfarë i duket veçanërisht interesante në lidhje me përshkrimin dhe cilat gjëra janë më pak interesante:
- A mundet fëmija juaj ta imagjinojë zotërimin me sukses të një situate të tillë pune? A mundeni ju si prindër ta imagjinoni një gjë të tillë?
- A mundet fëmija juaj të imagjinojë veten tek vjen në shtëpi i lumtur pas një dite pune të tillë? Po ju si prindër a e imagjinoni një gjë të tillë?
- A njihni ndonjë situatë tjetër tipike nga ky profesion dhe a keni ndonjë të njohur që mund ta njohë më mirë profesionin?